Rruga e Arbërit

ëëë.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 6 (158) / 2019. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO.

FAQE 24

Bigmarket DI ÇFARË ZGJEDH!

në Peshkopi
SUPER OFERTA
nga 26 qershor -
30 korrik 2019

Portret

Osman Miha - Nderi i Bulqizës

Nga **SHAQIR SKARRA**



12

Reportazh

Udhëtim nëpër trojet shqiptare të Maqedonisë së Veriut

Nga **HAKI PËRNEZHA**



9

Profil

Ilir Pilku, dibrani që nuk i harron rrënjët

Nga **OSMAN XHILI**



10

REPORTAZH NGA XHAFER MARTINI

Në Radomirë, mes njerëzve të mirë

FAQE 6-7

Vijnë gazetarë dhe bëjnë fotografi e krijojnë idenë sikur këtu në Radomirë çdo shtëpi është e mbytur në bollëk dhe se çdo shtëpi është në gjendje të presë mysafirë të nderuar nga çdo anë e botës. Por këto janë gënjeshtra, nuk janë realitet. Realiteti është ky që po shikon. Edhe pse ka trokitur vera, nuk shikon asnjë të huaj, se nuk ka rrugë. Nuk ka rrugë as për të ardhur deri këtu, as për t'u ngjitur lart, në male. Rruga është turizmi.

KONFERENCA SHKENCORE / STUDIMI

Lidhja me Rrugën e Arbërit të fshatrave të Grykës së Vogël dhe Gollobordës për zhvillimin e ekonomisë, turizmit historik e malor

Autorë: ZABIT LLESHI, NAZMI KOÇI, SHEHAT CAMI, MEHDI DEMA

- **Ndërtimi i Rrugës së Arbërit do të zgjerojë tregun e prodhimeve bujqësore, misër, grurë, fasule, patate, mollë, arra, gështenja, thana, mjaltë dhe peshk etj.,të cilat do të jenë gati për t'u vënë në shërbim të një tregu më të gjërë.**
- **Një zhvillim të shpejtë pritet të marrë turizmi historik, kulturor e malor, duke krijuar të ardhura për banorët vendas. Po ashtu, pasuritë minerare e ujore të Grykës së Vogël presin investime nga biznesi për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik.**
- **Kemi besim se Rruga e Arbërit do ti japë shumë frymëmarrje Dibrës, ekonomisë, bizneseve, investimeve. Resurset e fjetura deri tani, do të zgjohen, do të gjallërohen. Do të rritet ekonomia dhe të ardhurat e shumë familjeve, bashkë me atë të mbarë shoqërisë.** SPECIALE NË FAQET 4-5



Kulla e Sal Markes

NË BRENDËSI:

- Ç'kemi asaj Dibre: **Punë burrash**...
- **Hide Kaloshi**, profili i një gruaje fisnike
- Kur më merr malli për **gegërishten**
- **Manushaqe Shehu**, e vetmja grua shqiptare Gjeneral Brigade në drejtimin e FA-së
- **Dy martirë të lirisë** - Ali Pustina i Dibrës së Madhe dhe Haxhi Mehmet Alcani i Çermenikës
- Turi i **liqeneve akullnajore**
- **Tregim alegorik:** Në strofkullën e gjarpërit
- Borxhin ta ktheva vendlindje
- **Peshkatari i perlave** - tregim nga Artan Gjyzel Hasani
- "Një jetë për jetën e të tjerëve"
- Lamtumirë doktoreshë Sheza!
- U nda nga jeta Shemsi Manjani

cyan magenta yelloë black 1

Gazeta "Rruga e Arbërit" është një media e lirë dhe e hapur.
Çdo kontribut me shkrime, abonime ose donacione është i mirëpritur!
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro.
Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

Posta e Rruga e Arbërit

Gazetë e pavarur.
Nr. 6 (158). Qershor 2019
Gjendet në treg gjatë gjithë muajit Korrik 2019.

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.

Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.

Shkrimet refuzohen për botim vetëm në rast se merrni përgjigje me email. Për çdo rast tjetër shkrimet priten për botim në numrat e radhës.

Shkrimet në redaksi për numrin e radhës priten deri më **datë 20** të muajit, përveç rasteve të bashkëpunëtorëve të rregullt.

Gjithashtu, ju **kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**

GJITHASHTU, KUJTOJMË SE ÇDO SHKRIM I BOTUAR NË NJË MEDIA TJETËR APO RRJETE SOCIALE NUK KA PËRPARËSI BOTIMI.

JU LUTEMI, SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAIL-it, TË KENË PATJETËR ZANOREN "ë".

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

BOTUES:
Musa Riçku
Bujar Karoshi
Shaqir Skarra

Editor i faqes online: Agim Deva

Kontribuan për këtë numër:
Xhafer MARTINI
Osman XHILI
Miranda GOLECI
Haki PËRNEZHA
Avni ALCANI
Petro MEJDI
Artan Gjyzel HASANI
Dukagjin HATA
Halil RAMA
Sefer DUKA
Renato TOTRAKU
Zabit LLESHI
Nazmi KOÇI
Shehat CAMI
Mehdi DEMA

KËRKOHEN KORRESPONDENTË NË PESHKOPI DHE DIBËR TË MADHE

Të interesuarit për korrespondentë/menaxherë duhet të kenë pasion gazetarinë. Përbën avantazh përvoja në shtypin e shkruar ose në qoftë se kanë mbaruar studimet për gazetari dhe letërsi / marketing. Të jenë të angazhuar për punën në grup dhe të jenë të pavarur politikisht gjatë kohës që bashkëpunojnë me gazetën.
Të interesuarit të shkruajnë email
në adresën <rrugaearberit@gmail.com>
ose të telefonojnë në numrin
069 20 68 603.

Arkivi i gazetës është PA pagesë në faqen e internetit **ëëë.rrugaearberit.com.**
Falënderojmë z. **AGIM DEVA** për kontributin e vazhdueshëm për mirëmbajtjen e faqes së gazetës në internet dhe arkivin online.
Pajtimet në gazetë mund t'i bëni në çdo kohë duke komunikuar në adresat e redaksisë.
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit
<rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro. Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.
Për kontribute për gazetën mund të kontaktoni redaksinë ose mund t'i bëni ato përmes numrit të llogarisë më poshtë:
Raiffeisen Bank
Rruga e Arberit
Nr. llog. në lekë: 0010036640
IBAN: AL44 2021 1219 0000 0000 1003 6640

Adresa e gazetës:
Rr. "Zenel Baboçi",
Pall. "Ferar", Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
+355 69 20 68 603
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë

Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

ÇKEMI ASAJ DIBRE!

Punë burrash...



Burrat në bulevardin e Peshkopisë. Foto: Adriatik Sula

Nga **BUJAR KAROSHI**

"Burrat e Dibrës janë dembelë". Kështu thonin statistikat në fillim të majit, por u desh qershori që të tregonte të kundërtën: që burrat e Dibrës janë burra zamani. Kur i do të fortë, muskujt tregojnë; kur i do të zgjuar, me hile ta dëftojnë; kur i do të fjalës - llafin ata mbajnë; në i do të pushkës - plumbin ta tregojnë, në i do n'protesta - hurin me vete kanë; në i do për vota - tërmet ata e bëjnë...

Burra gjithkund: burra në zgjedhje, burra kundër zgjedhjeve; burra në protestë, burra kundër protestës, burra gazetarë, burra opozitarë, burra në përgjim, burra në vendim, burra në kuvend, burra në bashki, burra në fushatë, burra në burg, burra në polici, burra në vaki... Burra gjithkund, por gratë kurrkund...

E si u doli nami burrave, i thirrën të pastrojnë edhe plehrat e katundeve, por aty u tërhoqën: me llomet merren gratë... Jo se burrat nuk e bëjnë, por këtu hyn statistika: Jo të gjitha punët janë për burrat...

Por ndonjëherë punët i bëjnë bashkë burrat edhe gratë: kur gratë lajnë shtëpinë - burrat lajnë qeverinë; kur gratë mjelin lopët - burrat mjelin shtetin; kur gratë mbajnë llogaritë e shtëpisë - burrat mbajnë llogaritë e tenderave; kur gratë skuqin mishin - burrat pjekin presidentin; kur gratë merren me thashetheme për burrat e fshatit - burrat marrin nëpër gojë burrat e shtetit... Kur ndonjëherë mes burrash bie fjala për gratë, aty bëhen seriozë: janë punë burrash e nuk tregohen n'katund...

E si përfundim: burrat dolën kundër zgjedhjeve, por burrat i bënë zgjedhjet; burrat dorëzuan mandatin dhe burrat morën mandatin, burrat shkuan në burg, por burrat i arrestuan; burrat hodhën molotovë në protesta dhe burrat u plagosën; burrë ishte gazetari që xhironte me telefon; por burra ishin edhe policët që ia thyen; burra ata që shkuan në votime; burra ata që penguan votimet. Burra ata që i numëruan, burra ata që fituan... Me pak fjalë: ngado punë burrash...

Edhe "Portokallia" që shkoi këtë qershor nga Bulqiza e Dibra, burra ngjiti në skenë...

Edhe tunelin Shëngjun – Bulqizë burrat e hapën dhe po burrat e shembën edhe tunelin e Murrizit.

Edhe në Rrugën e Arbërit që po ndërtohet, burrat e dinë kur mbaron...

Iku qershori me punë burrash dhe kështu si e kanë nisur, grave u vjen radha në vjeshtë...

Ndaj bien poshtë statistikat e qeverisë: dembelët e mëdhenj në Dibër, burrat s'janë...

FALENDRERIME & NJOFTIME

Falenderojmë z. **MUHARREM GJOKA** nga Zall-Dardha e Dibrës për kontributin prej 100 Euro dhënë për botimin e gazetës. Me këtë rast, njoftojmë lexuesit dhe të gjithë ata që kanë ndihmuar ose dëshirojnë të ndihmojnë me donacione, se e vetmja mënyrë që **KONTRIBUTET TUAJA TË NJIHEN** janë pagesat **PËRMES BANKËS**. Edhe në rastet kur kontributet tuaja janë CASH, kërkoni një dokument të firmosur dhe vulosur nga redaksia.

* * *

Kujtojmë bashkëpunëtorët tanë se çdo **SHKRIM I BOTUAR NË NJË MEDIA** tjetër apo rrjete sociale **NUK KA PËRPARËSI** botimi, përveç rasteve kur kjo është konfirmuar më parë me redaksinë!

* * *

KËRKOHEN KORRESPONDENTË NË PESHKOPI DHE DIBËR TË MADHE. Të interesuarit për korrespondentë/menaxherë duhet të kenë pasion gazetarinë. Përbën avantazh përvoja në shtypin e shkruar ose në qoftë se kanë mbaruar studimet për gazetari dhe letërsi / marketing. Të jenë të angazhuar për punën në grup dhe të jenë të pavarur politikisht gjatë kohës që bashkëpunojnë me gazetën. Të interesuarit të komunikojnë me redaksinë.

* * *

Njoftojmë të gjithë bashkëpunëtorët dhe korrespondentët tanë se shkrimet duhet t'i sjellin në redaksi para datës 20 të muajit. Për çdo rast, komunikoni me redaksinë!

* * *

Për më shumë na ndiqni në Facebook në linkun: **goo.gl/1bq2r6**
ose në faqen tonë **www.rrugaearberit.com**

VEPRIMTARI

Festa e Qershisë hapi sezonin turistik në Dibër

Në Peshkopi u zhvillua me 1 qershor "Festa e Qershisë", por sezoni këtë vit nuk ishte i mbarë për fermerët. Reshjet e vazhduara të shiut gjatë muajit e dëmtuan shumë këtë frut, duke bërë që prodhimi i këtij viti të kalbej në pemë.

Dibra zë vendin e parë në Shqipëri për prodhimin e qershisë. Në këtë rajon janë mbjellë rreth 400 hektarë pemtore qershie dhe me një prodhim mesatar vjetor rreth 2400 ton.

Më shumë se 40 pjesëmarrës fermerë morën pjesë në panairin e organizuar me këtë rast, ku u prezantuan varietete të ndryshme qershie, agropërpunues të qershisë, gatime tradicionale, artizanë lokalë dhe prodhues mjalti.

Festa e Qershisë hapi edhe sezonin turistik, i cili do vazhdojë edhe me festat e tjera lokale si Festa e Drinit, festa e Bjeshkës, dhe mbyllen në fund të vitit me Festivalin Oda Dibrane dhe Festën e të Vjelave në vjeshtë. Organizatorët e këtij eventi janë optimist që ky vit do jetë një vit i mbarë për turizmin në Dibër, ku shikohet një interes nga vizitorët e huaj dhe vendas

Nën logon "Vizito Dibrën", janë një sërë aktivitetesh që organizohen për të promovuar Dibrën si një destinacion turistik që shquhet për mikpritje, traditën dhe natyrën e mrekullueshme.

Festa e Qershisë është një nga 9 festat lokale në Bashkinë Dibër, dhe që organizohet për gati 3 vite në Peshkopi nga grupi i organizimit të festave lokale, në kuadër të programit Dibra: Turizëm dhe Traditë (D2T), mbështetur nga USAID dhe Ambasada Suedeze në partneritet me ALCDF dhe Bashkinë Dibër.



aktualitet

TURIZËM

Kulla shekullore kthehet në bujtinë mikpritëse për turistët e huaj



Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural (AZHBR), ka investuar në agroturizëm edhe në Bulqizë, si një nga mundësitë më të mira për zhvillimin ekonomik të kësaj zone.

Julian Hupi, një ish-minator, zgjodhi të rindërtonte kullën shekullore, dhe ta kthente në një bujtinë mikpritëse për turistët e huaj, fluksi i të cilëve sa vjen e po shtohet në vendin tonë për lloje të ndryshme veprimtarish që ofrojnë kryesisht atraksionet turistike.

Ndër të tjera, Shqipëria, pjesë e EuroVelo Cycling Routes, është atraksioni i parapëlqyer i turistëve të apasionuar pas çiklizmit, pjesë e itinerarit të të cilëve është edhe zona e Bulqizës.

Ndërsa kulla e familjes Hupi është ndalesa e tyre e dëshiruar, për të shijuar kulturën, traditën, një Bulqizë turistike ndryshe nga si e njohim.

Juliani është shembull i përkushtimit, duke ndjekur ëndrrën për të ardhmen e familjes se tij dhe AZHBR është mbështetëse e projekteve cilësore, që rrisin shpresën për të gjithë ata që kërkojnë të zhvillojnë ekonominë në fshat dhe duan të rikthehen tek tradita. *(E.Xhajanka / ATSH)*

TURIZËM

Ecovolis prezanton Liqenet e Kacnisë



Një ekspeditë mjedisore drejt Liqeneve të Kacnisë, aty ku është djegur, prerë dhe shfarosur çdo pemë. Ashtu si motra e saj Lura është masakruar pa mëshirë, liqene mrekulli rrethuar nga shkatërrim. Aktivistët filluan mbjelljen e fidanëve aty, sepse të gjitha monumentet e bukurisë shqiptare do rimbillen. Mbjellja dhe mbrojtja e tyre janë misioni ynë, eko turizmi dhe punësimi rinor janë vizioni ynë. Dibra, Selishta, Kacnisa të ardhme kanë turizmin, natyrën e bukur, të kujdesur, të promovuar për turizëm. Liqenet mrekulli një ditë do të presin qindra vizitorë, prandaj shfarosjen aty do e kthejmë në pemë dhe gjelbërim... për kete duhesh ti, të çohesh dhe të bashkohesh, Lurën, Kacninë, Shqipërinë ta mbjellim e ta mbrojmë bashkë, mos lejo askënd të shkatërrojë natyrën tone, jeta jonë është e lidhur me natyrën, e tashmja e rinisë është e lidhur me turizmin, është dita të mbrojmë Tokën shqiptare nga krimet mjedisore. E ardhmja jonë është këtu dhe kjo Tokë ka zot, janë mijëra të rinj që do të punojnë në turizëm, qindra familje që do ushqehen nga ekonomia e turizmit. Dibra ka natyrën e bukur, sot duhet ta mbrojmë, ta mbjellim dhe ta zhvillojmë. Ndryshimin po e bëjnë qindra aktivistë që mbrojnë natyrën shqiptare! *(Facebook/Ecovolis)*



Përfundimi i punimeve për lidhjen e traverbangut Shëngjun – Bulqizë. Foto: Kujtim Alliu / Facebook

Përfundojnë punimet për lidhjen e traverbangut Shëngjun – Bulqizë

Pas afro tre vitesh punë ka përfunduar lidhja e traverbangut Shëngjun – Bulqizë. Traverbangu me një gjatësi prej 7310 metra ishte planifikuar të ndërtohej që në mesin e viteve '80, për të mundësuar menaxhimin e ujërave nëntokësorë të minierës së Bulqizës dhe po ashtu për të lidhur dy pjesë të saj, për të lehtësuar transportin e kromit. Lajmi për përfundimin e punimet është dhënë nga inxhinieri që ka bërë edhe ndjekjen e punimeve për lidhjen e traverbangut Shëngjun – Bulqizë, Kujtim Alliu.

Punimet për lidhjen e traverbangut ngecën për disa vite, ndërsa rifillimi i tyre u njoftuar një herë në prezencë të ish-kryeministrit Sali Berisha në majt të vitit 2013, pasi Balfin Group bleu aksionet e kompanisë koncesionare deri atëherë ACR, dhe sërish në gusht të vitit 2015-të në prani të kryeministrit Edi Rama. Një vit më vonë, në vitin 2016 qeveria vendosi të zgjasë koncesionin me 10 vjet duke premtuar investime përfshi traverbangun që i zgjasnin jetën minierës.

Ndërtimin i traverbangut "akuzohet" se ka shkaktuar rrëshqitje të tokës në Bulqizë, ku janë dëmtuar disa banesa dhe rruga e Arbërit:

Studimi i Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, i cili nga përpiluesit cilësohet si relacion emergjence që duhet të pasohet nga një studim i thelluar, gjeti po ashtu se ndër faktorët e rrëshkitjes ishte "ndryshimi i drejtimit të ujërave nëntokësorë drejt punimeve minerare" duke veçuar traverbangun dhe gërmimet minerare nga 335-350 metra nën nivelin e luginës.

Kompania AlbChrome e cila është koncesionari më i madh në minierën e Bulqizës dhe që po bën punimet për traverbankun, mohoi që aktiviteti i saj të ishte përgjegjës për situatën. "Mendimi ynë është se ulja e kores së tokës në një masë të tillë nuk është ndikuar nga ky punim", thuhet në një përgjigje që ajo i nisi BIRN.

Megjithëse i referohet po raporti të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar për llogari të Bashkisë Bulqizë, i cili veçon ndërtimin e traverbankut si një nga faktorët, kompania thotë se studim nuk konstatoi "që aresyeja është traverbangu".

Ndërkohë, autorët e raportit gjeologjik bëjnë thirrje për një studim të thelluar të rrëshkitjes së tokës në Bulqizë duke nënvizuar se Shërbimi Gjeologjik Shqiptar nuk i ka kapacitet financiare për ta zbatuar. Kjo kërkesë mbështet dhe nga bashkia e Bulqizës, e cila shprehet se i ka kërkuar ndihmë ministrive të linjës.

Kompania AlbChrome nga ana e saj mohoi që faji të ishte i punimeve dhe tha se mendonte që problemi ishte nga mungesa e kanalizimeve. Madje në një email për BIRN ata mohuan që uji i devijuar nga punimet që ata po bëjnë të kishte gërryer shtresa të buta të nëntokës. "Ujërat nëntokësore që dalin në ballin dhe trungun e Traverbangut janë të pastra, pa ndotje me masa torfike apo ranore, janë ujëra te pijshme (përdoren si ujë i pijshëm për Bashkinë e Klosit) dhe për këtë arsye ne mendojmë që hapja e këtij punimi nuk ndikon në sipërfaqe", deklaroi AlbChrome.

Koncensioni i pjesës më të madhe të minierës së kromit në Bulqizë iu dha nga qeveria në vitin 2001 kompanisë italiane Darfo s.p.a dhe ndërroi disa herë pronësi mes problemeve të shumta, aksidenteve të rënda me humbje jete të minatorëve, grevave të minatorëve dhe akuzave për mungesë investimesh. Kompania u ble nga BALFIN Group në vitin 2013 dhe ndërroi emrin në AlbChrome. *(bulqizaime.al)*



Më shumë mund të shikoni në faqen e gazetës në FB: Rruga e Arbërit ose ndiq linkun: https://tinyurl.com/lcc3e2f

Bëj një abonim online ose në print...

Kushton vetëm 600 lekë në vit...

email: rrugaearberit@gmail.com

NJOFTIM PËR BASHKËPUNËTORËT!

Njoftojmë të gjithë bashkëpunëtorët dhe korrespondentët tanë se shkrimet duhet t'i sjellin në redaksi para datës 20 të muajit.
Për çdo rast, komunikoni me redaksinë!

Rruga e Arbërit nr. 158

speciale

Kemi besim se Rruga e Arbërit do ti japë shumë frymëmarrje Dibrës, ekonomisë, bizneseve, investimeve. Resurset e fjetura deri tani, do të zgjohen, do të gjallërohen. Do të rritet ekonomia dhe të ardhurat e shumë familjeve, bashkë me atë të mbarë shoqërisë.

Lidhja me Rrugën e Arbërit të fshatrave të Grykës së Vogël dhe Gollobordës për zhvillimin e ekonomisë, turizmit historik e malor

Autorë: **ZABIT LLESHI, NAZMI KOÇI, SHEHAT CAMI, MEHDI DEMA**



Në foto: Zabit Lleshi duke mbajtur referimin.

Njësitë administrative të Grykës së Vogël dhe Gollobordës bëjnë pjesë në Bashkinë e Bulqizës të Qarkut të Dibrës. Ndodhen në jug-lindje të qarkut të Dibrës dhe kufizohen: Në lindje e veri lindje me Dibrën e Madhe, Maqellarën e Luzninë, në veri, veri perëndim e perëndim me Selishtën, Bulqizën e Zerqanin dhe në jug me Librazhdin.

Në këto njësi administrative bëjnë pjesë 37 fshatra, Shupenza (12) Gjorica (6), Ostreni (13) dhe Trebishti (6). Nga maja e Radacit në Klenjë (2 084 m) në Delgjurrë (Prat, Gjuras) dhe nga Ura e Topojanit në Okshtun (Plep) me një sipërfaqe prej 286,2 km², nga të cilat : Shupenza 104 km², Gjorica 35 km², Trebishti 49,5 km², dhe Ostreni 98,7 km². Brenda këtij teritori banon një popullsi prej 14 897 banorë, nga të cilët në Shupenzë 5503 banorë, në Gjoricë 5368, Trebishti 993 dhe Ostreni 3034 banorë. (Instituti i Statistikave Qarku Dibër, Rregjistrimi i popullsisë Tiranë 2011)

Ostreni dhe Trebishti lidhen me Rrugën e Arbërit tek Ura e Çerenecit. Vitet e fundit është hapur rruga Fushë Studën-Borovë-Sebisht-Orzhanovë-Ostren-Ramnagore-Ura e Çerenecit. Me asfaltimin e saj mbeten për t'u asfaltuar segmentet, Ostren-Trebisht, Dragalicë-Klenjë, Ostren i Madh-Ostren i Vogël dhe Ostren i Madh-Lejçan. Tuçepi lidhet me rrugën e vjetër buzë kufirit, Çerenec-Viçisht i Poshtëm-Miresh-Lladomericë-Tuçep. Në Lladomericë rruga mund të degëzohet për Pasinkë, nga Mireshi për Tërbaç.

Kërkohet të hapet rrugë e re nga Sebishti në Okshtun (Ara e Martinit) buzë zallit 4 km. Kjo lidhet edhe me rrugën e re që është hapur nga një firmë për Hidrocentralin e Smollikut që vjen nga Strikcani në Smollik, Ara e Martinit.

Nga Fusha e Studnës nëpër Qafë Përvallë-Prodan (17 km.) është një rrugë me trase të mirë dhe të qëndrueshme, ndërtuar më 1963 për shfrytëzim të lëndës drusore. Ky segment zgjatet mbi Plep, Gropa e Zezë, Miniera e Tërnovës. Po të asfaltohet kjo transporti i kromit nga Tërnova - Okshtun-Fushë Studen - Librazhd - Durrës, është më e shkurtër se rruga aktuale Tërnovë - Bulqizë - Durrës. Kjo zonë ka shumë resurse turistike dhe ekonomike, veç kromit është e pasur me lëndë drusore dhe bime medicinale.

Gjorica është e lidhur me asfalt, mbeten për tu shtruar vetëm rrugët e brendshme të cilat i ka marrë përsipër t'i kryejë kompania "Gjoka".



Harta e Grykës së Vogël dhe Gollobordës

Njësia administrative Shupenzë ka 4 fshatra të lidhura me asfalt, Okshatinë, Homesh, Boçevë e Shupenzë. Duhet të shtrohet më asfalt rruga Ura e Serbinit-Kepi i Gjurasit-Prat-Selishtë si dhe degëzimet me fshatrat Kovashicë, Zogje, Bllacë, Shtushan, Mazhicë, Gjuras e Delgjurrë afërsisht 50 km. Topojani lidhet më Okshatinën me një rrugë me gjatësi 3 km. Fshatrat e Katër Grykëve, po të ndërtohet e mirëmbahet, sidomos gjatë dimrit rruga Prat-Gjuras, lidhjen më të shkurtër me Rrugën e Arbërit e kanë të zbresin nga Gjurasi tek Ura e Serbinit e Shupenzë.

BUJQËSIA, BLEGTORIA dhe **PEMËTARIA** janë degët kryesore të zhvillimit të ekonomisë për Grykën e Vogël dhe Gollobordën. Në bujqësi vendin kryesor e zenë drithrat e bukës, misri, gruri, thekra, fasulja shoqëruese dhe patatet. Janë të njohura fushat e Homeshit, Shupenzës, Gjoricës, Mireshit, Lladomericës e Tuçepit, por edhe disa lugina të vogla si Ostreni, Luboleshi, Okshatina, Zogjet, etj. për prodhimin e misrit, grurit dhe fasules. Në konsideratë duhet marrë prodhimi i patates në Klenjë, Okshtun e Gjuras. Për ilustrim mund të marrim një shembull : Fusha e Shupenzës dhe Homeshit më 1985 ka marrë 50 kv. Grurë për ha., Gjorica në 300 ha mori 30 kv. për ha. duke prodhuar 9000 kv. grurë, Klenja në 150 ha mori 15000 kv. patate. (Ushtima e Maleve 1 shkurt, 24 mars 1986)

Janë afërsisht 5674 ha tokë bujqësore respektivisht, Shupenza 1899 ha, Gjorica 1368 ha, Trebishti 1019 ha dhe Ostreni 1388 ha që përbëjnë një rezervë të madhe për tregun e prodhimit të drithrave të bukës misër, grurë, thekër, patate, fasule, perime etj.

Kushtet natyrore e favorizojnë shumë rritjen dhe mbarështrimin e blegtorisë së imët, sidomos të deles dhe dhisë. Mali i Raduçit me bjeshkët e tij, Fusha e Klenjës (mbi 100 ha), Okshtuni me bjeshkët alpine, Fusha e Drerit, Gropa e Zezë, Fusha e Kuqe dhe Kolgreku kanë një kapacitet për mbarëshshtrimin e 7000-8000 krerëve. Vetëm kooperativa e Klenjës më 1986 kishte 5700 krerë të imta, dhe 300 të trasha e njëthundrakë. Të njëjtat kapacitete për blegtorinë e imët ka Shupenza, me kullotat alpine në Komavec (63 ha), livadhet e Bllacës, Pratit, Delgjurrës, etj. Në vitin 1960 vetëm fshati Bllacë kishte 3000 krerë të imta (1000 dele e 2000 dhi). (Xhevat Jella) Rraca e dhisë së Bllacës ka qenë e njohur në shkallë vendi, krahas asaj të Bulaçit në Muhur dhe Matit.

Në vitin 2018, Shupenza kishte 1800 krerë të imta e 2700 lopë, Gjorica 2500 të imta e 1720 lopë, Trebishti 2300 të imta e 827 lopë dhe Ostreni 4000 të imta e 866 lopë. (Internet 2018) Blegtoria ka kushte mjaftë të mira për mbarshtrim, por mungesa e baxhove, dhe e kushteve për tregëtimin e bulmetit dhe mishit, kanë sjellë një ulje të prodhimeve blegtorale, bashkë me atë të numrit të krerëve.

Drini i zi, Zallet e Okshtunit dhe Bulqizës, kanë peshk, kryesisht troftë, por pak vemendje i kushtohet kësaj pasurie e cila mund të zhvillohet me shpenzime shumë të vogla. Sokol Shtrezi në Kovashicë me punën e tij disavjeçare ka ndërtuar një rezervat për kultivimin e peshkut duke shfrytëzuar ujin e pastër të Gjurës së Leke. Ai po e zhvillon këtë biznes duke prodhuar deri 500 kv. peshk në vit, duke krijuar treg deri në Tiranë.

Gryka e Vogël dhe Golloborda kanë kushte mjaft të mira për rritjen e bletës. Eksperiencë ka në Bllacë (Gani Sinani e Femi Alimani), në Kovashicë (Naim Xhafa e Iljaz Xhafa), në Mazhicë (Met Koxha), në Izvirë (Bardhul Izvira), në Pasinkë, Klenjë, Prodan, etj. Afërsisht 700 koshhere bletësh kanë 4 njësitë administrative të këtyre zonave, ç'ka janë shumë pak për mundësitë e kushtet që ekzistojnë për rritjen e bletës.

Pemtaria është një degë tjetër ku ka kushte e mundësi të mëdha të rritet kudo në kodrat, deri në 800 m mbi nivelin e detit, molla, kumbulla, arra, thana, qershia, lajthia (kohët e fundit ka filluar të kultivohet në masë), gështenja, hardhia (në vreshta) etj. Arra në Gjuras, Shtushaj, Zogje, Pasinkë, Lubolesh, Trebisht, etj., Gështenja në Mazhicë, Tuçep, Orzhanovë, etj. Thana në Bllacë (sheshi i thanave), Pasinkë, Topojan, etj., vreshta në Viçisht, Shupenzë, Pasinkë, etj. Në fshatin Trebisht, brigadieri i pemtores Fitim Balla mori në vitin 1985, 50 kv. arra. (Ushtima e Maleve, 12 korrik 1986) Familja e Zenel Kajës në Gjoricë para pak vitesh mbolli 4 ha tokë me mollë dhe me të ardhurat e siguruara ngriti një bazë frigoriferike, me të cilin ka siguruar vijimin e tregut gjatë gjithë vitit. Vreshta janë mbjellë edhe në Viçisht (Mane Cami, Latif Lika), në Pasinkë, Tuçep, Trebisht, Ostren i Vogël, etj.

Ardhja e Rrugës së Arbërit do të zgjerojë tregun e prodhimeve bujqësore, misër, grurë, fasule, patate, mollë, arra, gështenja, thana, mjaltë dhe peshk, ndërsa për prodhimet blegtorale mungojnë bazhot, një mundësi për t'u shfrytëzuar nga bizneset private në Kovashicë, Izvor, Okshtun, etj. Për tregëtimin e mishit ekziston një thertore në Shupenzë me pronar Ramazan Miftari, i gatshëm për t'u vënë në shërbim të një tregu më të gjërë.

Gjatë rrjedhjes së lumejve janë krijuar hapësira inproduktive me shelgjishte me një sipërfaqe afro 796 ha. Ato mund të shërbejnë si lëndë e parë për prodhime artistike për në vend dhe për eksport . Kujtojmë se para viteve '90 Ndërmarja e Prodhimeve të Ndryshme në Peshkopi rreth 80% të lëndës së parë për thupra shelgu e merrte në zonën e Gjoricës dhe Shupenzës.

Ndërtimi i Rrugës së Arbërit do të zgjerojë tregun e prodhimeve bujqësore, misër, grurë, fasule, patate, mollë, arra, gështenja, thana, mjaltë dhe peshk etj.,të cilat do të jenë gati për t'u vënë në shërbim të një tregu më të gjërë.

Një zhvillim të shpejtë pritet të marrë turizmi historik, kulturor e malor, duke krijuar të ardhura për banorët vendas. Po ashtu, pasuritë minerare e ujore të Grykës së Vogël presin investime nga biznesi për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik.

PASURITË MINERALE TË GRYKËS SË VOGËL DHE GOLLOBORDËS

Nga pasuritë minerale të Grykës së Vogël dhe Gollobordës më të rëndësishmet janë vendburimet e Gurëve dekorativë (mermere) të zonës Kovashicë, Gjuras e Shtushaj dhe Ostren e Trebisht. (Bashkim Lleshi 2010) Një investitor i huaj (italian), erdhi pas viteve '90, bëri disa investime e nxori një sasi blloqesh të gurëve dekorativë, instaloi një fabrikë të vogël për prodhimin e pllakave, por nga viti 2010 u largua. Gurët dekorativë janë të cilësisë së mirë dhe mjaft të kërkuar, por presin investitorë vendas apo të huaj për të dalë në treg bashkë me vendburimin e Gjurasit. Para 6-muajsh, në Zogje (tek Gjuri i Çetës), një firmë tjetër vendase ka filluar punë me pak punëtor, në një dalje të gurëve dekorativë.

Minerale të tjerë që takohen në këtë rajon janë, Objekti e Manganit të Topojanit, dhe daljet e manganit të zonës së Trebishtit. (Hasan Hajdari 1972) Në këtë zonë takojmë dhe Objektet e argjilave të Çerenecit e Shupenzës për tulla e tjegulla dhe Inertet lumore të Çerenecit të Poshtëm. (Mustafa Manjani, Lenard Kazanxhi, Sefedin Shabani,1998,2004) Në Çerenec është zbuluar një punishte e herëshme që shërbente për pjekjen e tjegullave për mbulimin e shtëpive. Takohen dhe Shistet argjilo silicore të zeza (rrasat) për mbulimin e çative në Kovashicë (Rrasa e Toçit), Zogje (Hurdha e Lleshit), etj. Gëlqerorët e ranorët si lëndë e parë në ndërtim



Vendburimi i Kovashicës



Vendburimi i Gjurasit

e në infrastrukturë nga Vlashajt në malin e Homeshit, të Kovashicës e Bllacës deri në Gjuras, në zonën Sharra e Zogje, Shtushan, Gjurra e Mazhicës e Topojan, si dhe në zonën Ostren-Trebisht-Klenjë, të cilët janë përdorur që në kohët e lashta e deri më sot për qoshet e shtëpive e kullave, për gurë dekorativë etj. Daljet e ranorëve feldshpatikë për ndërtim e fajancë në Zogje, Shtushaj e Gjuras, të argjilave si ngjyrosës mineralë (bojra dheu) në Kovashicë, Zogje e Mazhicë (bota e zezë e Kovashicës dhe e Mazhicës), argjilat e kuqe (Kuçlat e Shalave në Zogje) dhe argjilat gri me cilësi shumë të mirë për poçeri të Kovashicës, që vendasit i përdorin edhe për bërjen e çerepëve për pjekjen e bukës. Këto argjila kanë veti pastruese dhe përdoren për larje në llixha. (Bashkim Lleshi 2018)

Në aksin e Rrugës së Arbërit nga Ura e Çerenecit deri në lumin e Drinit të Zi, kemi një pasuri të madhe të inerteve lumore. Përvoja e viteve pas`90, tregon se ato shfrytëzohen kryesisht pa kriter dhe duke krijuar mjaft probleme me përmbytjet, me dëmtimet e shkatërimet e tokave të bujqësore etj.

PASURITË UJORE TË GRYKËS SË VOGËL DHE GOLLOBORDËS

Lumi Drini i Zi, nga Ura e Spiles në Viden (pika e takimit të Gjurrës së Mazhicës me Drinin e Zi afër Dovolanit) 18 km., bashkë me Zallin e Okshtunut 34 km., Zallin e Buqizës e Shupenzës 23 km. Zallin e Tuçepit e Pasinkës, Gjurra e Kovashicës, etj. përbëjnë pellgun ujëmbledhës të Grykës së Vogël e Gollobordës. Ato shërbejnë për vaditje por edhe për prodhimin e energjisë elektrike. Në vitin 1967 u ndërtua He-ci i Çerenecit, më 1974 i Homeshit dhe Tuçepit, ndërsa vitet e fundit në Smollik për të shfrytëzuar energjinë e ujit.

Pasuri tjetër ujore janë edhe përrejt nga zona e Klenjës, Okshtunit, Ostrenit e Trebishtit që derdhën në Zallin e Okshtunit e Drinin e Zi. Ato të Homeshit, Kovashicës, të Zogje e Shtushanit që derdhen në zallin e Shupenzës dhe përrejt e Gjurasit e Mazhicës që bashkohen në Gjurrën e Mazhicës e derdhen në Drinin e zi në pjesën veriore në kufi me Luzninë (Hoteshin). Rrjedhjet e sipërme të tyre shërbejnë për vaditjen e tokave bujqësore. Kjo zonë është e pasur me ujra të freskëta si, Gjurrat e Kovashicës, të Zogje, Mazhicës dhe Delgjurra, Burimet e Izvorit në Viçisht, të Tuçepit, Klenjës, Okshtunit, etj mbi të cilët janë ndërtuar ujësjellësa për furnizimin me ujë të pijshëm të Okshatinës, fshatrave të Shupenzës dhe Gjoricës. Burimet tjera të vogla të gjithë fshatrave të Gollobordës e Grykës së Vogël përdoren gjithashtu për ujë të pijshëm. Për vaditje të tokave bujqësore funksionojnë Rezervuarët e Shtushanit dhe Mazhicës. Duhet të shikohet mundësia për të vënë në funksionim Rezervuarin e Bllacës me kapacitet 6 000 000 m^3 ujë për vaditjen e Maqellarës i cili u abandonua në fillim të viteve nëntëdhjetë.

Zalli i Okshtunit, pjesërisht i Bulqizës, proi i Zogje, nga Kovashica gjer në Drin të Zi, Zalli i Tuçepit dhe Pasingës mund t'i shërbejnë sportit



Pisha e Zogje (Vishkulli)



Lisi i Kovashicës

të lëvizjes me varka sportive (Rajting).

VENDET DHE MONUMENTET HISTORIKE

Në Grykën e Vogël dhe Gollobordë njihen si vendbanime të herëshme, Topojani, në epokën e bronxit, Gjorica, Tuçepi e Okshtuni në epokën e hekurit, etj. Toponimet si Xhiteca (Qyteza) e Gjurasit (Kazane) në Gjuras, Xhiteca (Qyteza) e Sute në Zogje, në shekullin e IV-tër, lidheshin me ato të Sofraçanit e të Krajkës. Gjetjet arkeologjike në Gjoricë, Deth të Mazhicës, Trebisht, Okshtun, etj. tregojnë për zhvillimin historik të këtyre zonave që në lashtësi, për rrugët lidhëse midis tyre dhe për qytetërimin e lashtë të kësaj zone. Janë gjithashtu të njohura kalaja e Homeshit, Tuçepit, Kojovecit, Prodanit, Trebishtit, etj. (Adem Bunguri 2010)

Të njohura janë vendet historike ku janë zhvilluar kuvende të rëndësishme të Maleve të Dibrës për luftë ndaj turqve, serbëve, bullgarëve, sic janë ato të Gjurrës së Mazhicës, Gropës së Ukut (Homesh), Fusha e Thatë (Gjoricë), Fusha e Klenjës, etj. (Munir Shehu , Kristo Frashëri 2012)

Kemi shumë luftëra e përpjekje të njësive partizane gjatë Luftës Nacionalçlirimtare si në Gjoricë, tek Ura e Topojanit, Zogje, Sofraçan, Çerenec, Trebisht, Prodan (ku u strehua Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Nacionalçlirimtare në Operacionin e Dimrit), etj. Ekzistojnë disa përmendore e lapidare, një pjesë të prishura e abandonuara. Për disa ngjarje nuk ka asnjë mbishkrim ku të marrësh ndonjë informacion për historinë e këtyre objekteve të vizitueshme nga turistë vendas apo të huaj. Organet e pushtetit lokal së bashku me intelektualët e treritorit që mbulojnë, kërkohet të punojnë për plotësimin e dosjeve për çdo ngjarje, për vendet historike, kalatë, monumentet e natyrës e të kulturës, bashkë me memorialet kushtuar atyre.

Gryka e Vogël dhe Golloborda kanë një etnografi shumë të pasur. Golloborda ka një veshje të veçantë, për fat të mirë, të ruajtur dhe të padëmtuar, sidomos veshja e grave, e cila përdoret në dasma. Veshja e burrave nuk ka ndonjë ndryshim me ato të burrave të malësisë dhe të Zerqanit.

Nga Monumentet e kulturës të vizitueshme për turistët e huaj dhe vendas mund veçojmë, kullën e Sal Markes në Zogje, me 4 kate e ndërtuar më 1840 rreth 180 vite më parë, (Zabit Lleshi 2011) ndërtesa 3 katëshe me plita (qerpiç) e breza druri e Shefki Kurtit në Shupenzë, kullat e Ferat e Zyber Koçit në Prodan (pak të rrënuara me mundësi rikonstruksioni), etj.

Në zonën e Grykës së Vogël dhe Gollobordës të banuar nga ortodoksë e katolikë vendas ka shumë toponime të kishave të vjetra, fatkeqësisht të rrënuara, kemi vetëm themele e gjurmë të tyre si, Kishat e vjetra të Gjurasit (Shën Kollit), kisha më e vjetër në rajon. Kryepeshkopi i Dioqezës së Durrësit Mark Skurra më 1641 i shkruante Papës së Romës: "Kisha e Gjurasit është rrënuar nga forcat turke, ju lutem paguani edhe për dy vjet priftin se kanë ngelur edhe 120 të krishterë" (Iljaz Zamputi 1965) Të vjetra janë edhe Kisha e Jakime në Shtushaj, Kishat e Vernicës, Gjinovecit, Prodanit, etj. Ekzistencën e kishave e tregojnë gjithashtu edhe shumë toponime pothuajse në të gjitha fshatrat e Grykës së Vogël e Gollobordës si, mali i Kishës e kodra e Kishës në Zogje, Viçisht, Tuçep, Okshtun, Trebisht, etj.



Teqja e Bllacës



Shpella e ftohtë Gjuras



Gjurra e Kovashicës

Teqja e Bllacës është një institucion tjetër fetar me veprimtari të shquar patriotike për mësimin e shqipes.

Është e njohur vizita e Abdyl Frashërit më 1878 në Bllacë, në takimin me malësorët e Grykës së Vogël tek varret e Shupenzës, në Moglicë të Okshtunit me hoxhë Moglicën, dhe përcjellja e tij prej familjes Koka, nga Plepat e Okshtunit për në Elbasan e Shqipërinë e Jugut.

GJEOMONUMENTET, HIDROMONUMENTET DHE BIOMONUMENTET

Ndër gjeomonumentet e miratuara kemi Shpellën e Ftohtë në Gjuras, 920 m. mbi nivelin e detit, me gjatësi 25 m. gjërësi 2m dhe lartësi 2m. (Perikli Qirjazi, Skënder Sala, 2006) ndërsa nga vendbburimet e gurëve dekorativë si gjeomonument mund të veçojmë vendburimin e Kovashicës dhe Kepin e qytetit në Gjuras (Kepi i Gjurasve). Kjo zonë është e pasur edhe me hidromonumente si, Delgjura, Gjurra e Kovashicës, Gjurra e Leke (Tejme), Gjurra e Mazhicës, Izvori i Viçishtit, Gjurra e Prodanit, etj. të cilat janë një pasuri e madhe e këtyre fshatrave.

Livadhet alpine si ato të Komavecit në Shupenzë (mbi Bllacë), në Klenjë, ato të Kozjakut Okshtun, etj. shërbejnë për verimin e blegtorisë. Gjatë dimrit mund të shfrytëzohen dhe për ski. Klenja ka favor të madh për të rigjallëruar këtë sport, ndërsa Komaveci duhet të lidhet më rrugë ose teleferik.

Nga Biomonumentet veçohet, Pisha e Zogje (e zezë) ose Vishkulli afro 500-vjeçare. Karakteristikë e saj është, se ndodhet në zonën e dushkut dhe rreth 650 m mbi nivelin e detit (Zabit Lleshi 2011), Lisi i Kovashicës afro 300-vjeçar, (Perikli Qirjazi, Skënder Sala, 2006) Mani i Zi i Jashar Camit në Viçisht, afro 300-vjeçar, etj.

Për turizmin malor do të shfrytëzohen bukuritë natyrore të Komavecit e Delgjurrës, Guri i Bilbilit e mali i Shullanit (Bllacë), Livadhi Marke, Arnitë e Kaje dhe Qafa e Kroi i Fangut (Zogje), Fusha e Teqes e Livadhet e Bllacës, Gjurrat e Mazhicës dhe Kovashicës, mali i Raduçit (Klenjë), Prodanit, Fusha e Klenjës etj. Në shumë nga këto bjeshkë e fusha mund të zhvillohet sporti dimëror i skive, etj.

Kemi besim se Rruga e Arbërit do ti japë shumë frymëmarrje Dibrës, ekonomisë, bizneseve, investimeve. Resurset e fjetura deri tani, do të zgjohen, do të gjallërohen. Do të rritet ekonomia dhe të ardhurat e shumë familjeve, bashkë me atë të mbarë shoqërisë.

SHËNIM:
Ndalohet kopjimi i këtij materiali apo përdorimi i tyre, me çdo lloj apo mjeti, përveç rasteve kur shërben si burim referimi. Materiali i mësipërm është punë origjinale e autorëve ndaj çdo keqpërdorim i tij, pa miratimin e autorëve është i ndaluar. Çdo shpërndarje përmes internetit duhet të ruajë linkun e botimit origjinal.



Kulla e Sal Markes



Kulla e Shefki Kurtit

REFERIMET

- Adem Bunguri (2010) "Prehistoria e Dibrës" Tiranë 2010
- Bashkim Lleshi (2010) - Shkëmbinjtë dhe mineralet industrialë (jo metalorë) të Shqipërisë, libër, Tiranë 2010
- Bashkim Lleshi "Rruga e Arbërit do ti shërbejë njohjes së mëtejshme të historisë" G."Rruga e Arbërit" mars 2017
- Bashkim Lleshi "Ruga e Arbërit i shërben edhe zhvillimit të mëtejshëm të turizmit malor"G.Rr.Arbërit"prill 2017
- Bashkim Lleshi (2018) "Pasuritë minerale të Grykës së Vogël"Gazeta "Valët e Drinit"1, 2018
- Gazeta Ushtima e Maleve 1 shkurt, 24 mars 1986
- Gazeta Ushtima e Maleve 3 maj 1986
- Gazeta Ushtima e Maleve 12 korrik 1986
- Hasan Hajdari (1972) - Raport mbi punimet e kërkim-zbulimit të kryera në vendburimin e Manganit Topojan në vitet 1968-1971, Ndërmarja Gjeologjike Bulqiizë 1972
- Hasan Hajdari (1976) - Raport mbi punimet e kërkim zbulimit në vendburimin e gëlqerorëve të mermerizuar Gjuras (Peshkopi), Ndërmarja Gjeologjike Bulqiizë 1978
- Iljaz Zamputi (1965) "Gjendja e Shqipërisë Veriore dhe të Mesme në shekullin e XVII-të faqe 251, Tiranë 1965
- Instituti i Statistikave Qarku Dibër, Rregjistrimi i popullsisë Tiranë 2011
- Kristo Frashëri (2012) Historia e Dibrës, Tiranë 2012
- Leonard Kazanxhi,Mustafa Manjani (1998) - Raport mbi punim et e kryera në vendburimin e Inerteve lumore
- Çerenec i Poshtëm në vitet 1997-1998, Ndërmarja Gjeologjike Bulqizë 1998
- Munir Shehu (2010) "Dibra I në vitet 1840-1860", Tiranë 2010
- Mustafa Manjani, Leonard Kazanxhi,Sefedin Shabani (2005) - Raport shkencor mbi rezultatet e punimet të kryera për argjila për tulla e tjegulla në vendburimet e Argjilave Shupenzë, Çerenec i Poshtëm, etj., Ndërmarja Gjeologjike Bulqizë 2005
- Perikli Qirjazi, Skënder Sala (2006) "Monumentet e natyrës së Shqipërisë" Tiranë 2006
- Vesel Hoxha,Bashkim Lleshi,Ilir Alliu,Sefedin Shabani, Naim Karaj (2007)- Pasuritë minerale të rajonit të Dibrës që mund të vihen në qarkullim ekonomik me ndërtimin e Rrugës së Arbërit. Kuvendi Teniko- Shkencor për Rrugën e Arbërit. Tiranë 26 maj 2007
- Xhevat Jella Kujtime në dorëshkrim. Shupenzë 2018
- Zabit Lleshi (2011) Artikulli ku përshkruan Kullën e Sal Markes dhe Vishkullin Gazeta "Dibra" nëntor 2004
- Zabit Lleshi (2018) "Gryka e Vogël" Gazeta Valët e Drinit nr. 2 Tiranë 2018 .

Në Radomirë mes njerëzve të mirë



Nga **XHAFER MARTINI**

Atë ditë që u paraqita për të filluar punën në shkollën shtatëvjeçare të Cerenit, këtu e 57 vjet më parë, isha djalosh i ri, njëzetenjë vjeçar. Kisha rroba që ishin prerë e qepur nga rrobaqepës Zeqiri, një shkodran i kulturuar, që bënte art me zanatin e tij. Për një djalë të ri, të arsimuar, me një profesion që e ka në natyrën e vet veshjen elegante, tek unë nuk kishte asgjë të qortueshme. Por kjo modë, në një farë kuptimi, më kishte sjellë mua në Ceren...

Kishte prapambetje të madhe në atë kohë. Djemtë, kur dilnin në oborr në pushimin e gjatë, nuk dinin lojë tjetër, veç ndiqnin me shkelma njëri-tjetrin. Ishin veshur me tirq dhe kaparone, megjithëse vapa ishte ende në fuqi (fund shtatori). Vajzat ishin veshur me kostumin popullor të krahinës (dimi dhe triko leshi). Ishin të turpshme, por, sidoqoftë, një element më i përparuar se djemtë: mësonin më mirë dhe ishin të sjellshme.

Këto m'u kujtuan, ndërsa po ulesha të shkruaja për takimin më të fundit me mësuesit dhe nxënësit e Cerenit. Në fakt, ky është një takim imagjinar, virtual, se nuk është as shkolla, as nxënësit, për të cilët fola deri më tani. Kanë kaluar më shumë se pesë dekada dhe gjërat kanë ndryshuar. Shkolla e dikurshme e Cerenit nuk ka asnjë shenjë në vendin ku ka qenë ngritur. Atë e kanë ndërtuar poshtë, në një lëndinë të bukur. Natyrisht, as nxënësit dhe as mësuesit nuk kanë si të jenë ata që kanë qenë në atë kohë.

Jahe Delia Selmani, ish-nxënësi im i asaj kohe në shkollën e Cerenit, më propozoi që më 6 qershor të këtij viti të nisemi për në Kala të Dodës. "Ke qenë mësues atje dhe sikur ke mall dhe nostalgji", - shtoi ai. Vërtet kisha dhe e prita mirë propozimin e tij. Me ne erdhi edhe ish-drejtori i arsimit të rrethit të Dibrës, Shkëlqim Koltraka, dhe dy vajzat e heroit të qiellit, Florian Delia, Jehona dhe Klea.

Kafen e pimë tek Ura e Lapave, ku është një hidrocentral i ngritur nga Firma "Gjoka". Vendi është i ngushtë se ndodhet midis dy shpateve të maleve, ku shikohet vetëm një hektar qiell, por pikërisht ai vend ishte bërë i industrializuar dhe i lulëzuar, aty ishte ngritur edhe një hotel me katër yje. Kjo tregon se dora e njeriut e transformon edhe natyrën, jo vetëm e bën funksionale që t'i shërbejë, por e bën edhe të bukur.

Kaluam gjithë ato fshatra të Lumës dhe shkuam në Ceren. Nuk u ndalëm aty ku ka qenë shkolla ku kam punuar një vit, se nuk ka asnjë shenjë të shkollës. Janë ndërtuar shtëpi, edhe ato ngushtë-ngushtë, mbështetur pas njëra-tjetrës. Shkolla është më poshtë, - tha Jahja, në lagjen Derbaç. Sigurisht, bëhet fjalë për shkollën e re.

Shkolla ishte ndërtuar në një vend të rrafshtë dhe hapësinor. Nxënësit, vajza e djem të rinj, njëri më i bukur se tjetri, nuk kishin asnjë dallim nga fëmijët e asaj moshe kudo në botë. Pyetëm për këtë muzikë që jehonte atyre maleve dhe na thanë se festonin mbarimin e mësimeve për ciklin e nëntëvjeçares. Na përshëndetën me mirësjellje dhe për shkakun tonë për pak kohë e ndalën muzikën dhe vallëzimin. Mësuesit i gjetëm në sallën e tyre. Gratë me përparëse të bardha, si të ishin infermiere. U ulëm rreth tryezës së madhe: Jahja na prezantoi kush ishim. Mbas disa minutash në sallë u fut një burrë i ri, veshur me shije, me një pamje vetësigurie, por pa asnjë grimë mendjemadhësi. Quhej Shpëtim Brika, ishte nga Ploshtani. Nuk ishte drejtues i shkollës, por atë ditë bëri punën e drejtorit, që mungonte për arsye personale.

Mua m'u drejtua me titullin "profesor" dhe më falënderoi për vizitën që bëja në shkollë, më falënderoi për ato pak libra që u dorëzova për bibliotekën e shkollës dhe, duke u mbështetur në ato pak fjalë të Jahjes, tregoi që unë në letërsinë shqipe zija një vend të nderuar. Ajo që më bëri përshtypje qëndron në faktin se ky burrë i ri, mësues matematike, fliste me siguri dhe i ujdiste shumë mirë fjalët që thoshte. Më Shkëlqim Koltrakën doli i njohur, se ky ishte drejtori i parë që e kishte emëruar në punë. Nga kjo mua m'u "përgjysmua" vlera, se drejtorët e shefat e arsimit nderohen shumë nga mësuesit. Por Shpëtimi ishte i tillë që nuk linte njeri pa e përkëdhelur në sedër. Më në fund ma dha fjalën mua, që të thosha disa fjalë.

- Kjo nuk është ajo shkolla e Cerenit ku kam qenë unë një vit, këta nuk janë nxënësit e asaj shkolle, as ju vetë nuk jeni po ai kolektiv arsimtarësh. Por mua më duket se jeni në të gjitha pamjet po ata, veçse të ndryshuar, të transformuar, të civilizuar, të rritur më shumë në shkallën e kulturës dhe të arsimit, përgjithësisht të zhvillimit njerëzor. Unë jam shumë i gëzuar që erdha midis jush, se do të largohem me pamje dhe përshtypje të tjera dhe rrallë do më vijë në kujtesë ajo pamje e zymtë e shkollës së dikurshme, ata fëmijë të varfër për nga zhvillimi kulturor, ajo trupë arsimore që, sigurisht, nuk ishte në nivelin tuaj. Atëherë në shkollë ishim katër - pesë mësues dhe jo si ju që qenkeni një armatë e tërë. Atëherë në shkollë asnjë mësues nuk vinte me veturë, por me çizme deri në gju se baltërat ishin gati të pakalueshme. Rruga e asfaltit që vjen deri në oborrin tuaj as që mendohej në ato kohëra. Gra dhe vajza nuk kishte mësuese. Por punuam dhe në ato kushte dhe mund të them jo vetëm pa mburrje, por si një të vërtetë absolute, se arsimi në kohën e diktaturës ka qenë një nga shtyllat më të forta të shoqërisë shqiptare që e ruajti nga shpërbërja qenien e saj, pavarësisht nga politizimet e ditura. Tani, sigurisht, ka ndryshuar arsimi dhe, ndryshimet, siç duhet të ndodhë, bëhen për mirë, por unë kam njëzet vjet i shkëputur nga arsimi dhe nuk di se në ç'drejtim ka ecur shkolla sot.

- Nuk ka ecur në kahjen e duhur, - e mori fjalën prapë Shpëtimi.- Nxënësit nuk janë më ata të disiplinuarit dhe të përkushtuarit si në kohën tuaj. Vërtet janë më të kulturuar dhe më të përparuar, por jo aq shumë të lidhur me mësimin, sidomos me librin. Edhe marrëdhëniet mësues – nxënës, nga domosdoshmëria për të dalë nga statusquoja e dikurshme, sikur nuk kanë lëvizur nga kahja e respektit reciprok. Këtë lloj pakënaqësie që Shpëtimi e tha në mënyrë të zbutur, e kisha dëgjuar edhe nga mësues të tjerë. Por unë kam pasur dhe kam mendimin që në marrëdhëniet mësues – nxënës , mësuesit janë faktori kryesor.

- Në të gjitha marrëdhëniet mësues- nxënës, - thashë kur e mora fjalën për së dyti, - fajin ua hedh mësuesve dhe jo nxënësve. Nxënësve nuk është se u ka ikur nderimi dhe respekti për mësuesit, por ata nuk mund të respektojnë ndonjë që nuk e meriton të jetë mësues. Më lejoni të sjell ndonjë rast nga praktika. Kisha një koleg, mësues letërsie, që, edhe pse kishte mbaruar fakultetin, nuk kishte asnjë të dhënë për të qenë mësues i kësaj lënde. Nxënësve nuk u imponohej me dituri, me art e me kulturë, por me dhunë. Dhuna nuk është vetëm fizike. Kur nxënësit i bënin zhurmë në klasë, nxirrte teserën e partisë dhe ua tunde nxënësve për të treguar se ishte komunist dhe se komunistët duheshin nderuar edhe kur nuk ishin në atë lartësi që kërkohej...

Ata që folën mbas meje dhe Shpëtimit, sado që asnjeri nuk m'u kundërvu hapur, dukej se anonin nga Shpëtimi. Kur këtë gjë e bëri edhe ish-drejtori i arsimit, Shkëlqim Koltraka, mbeta në minorancë për të mos thënë edhe në injorancë. Mësuesit i nderojnë shumë ata që kanë drejtuar arsimin. Por kjo nuk është kryesorja. Kryesorja qëndronte në faktin se diskutuam dhe folëm lirisht, prekëm shumë probleme të shkollës dhe të arsimit, sikur të ishte një analizë vjetore e punës në shkollë. Fakt pozitiv ishte se nxënësit që mbaronin nëntëvjeçaren ishin regjistruar edhe në të mesmen. Dhe prej këtyre kishte edhe vajza. Ajo shkollë, dalëngadalë, nga viti në vit, do të bëhej edhe shkollë e mesme.

Kur u duk se nuk kishte më gjë për të thënë, dolëm jashtë dhe bëmë fotografi në oborr. Pastaj pamë bibliotekën e shkollës. Ekzistonte si dhomë, madje ishte e rregullt, e pastër, me tryeza dhe karrige, kishte edhe libra, por ato ishin të asaj kohe kur unë kam filluar punën si mësues. Nuk kishte përtëritje, libra të rinj. Mësuesja e letërsisë ishte një vajzë e re, e cila na tha se ato libra që ishin në bibliotekë, nxënësit i kishin lexuar.

- Nga je? - e pyeta.

- Jam nga Shumbati, - më tha ajo.

-Ti qenke nga vendi i shkrimtarëve. – i thashë si me të qeshur.- Shumbati është një fshat që ka mbi tridhjetë shkrimtarë.

- Cili të pëlqen më shumë? - më pyeti ajo duke menduar që i kisha lexuar.

- Mua më pëlqen Haxhi Mandri, - i thashë.- Po ti lëmë shkrimtarët e Shumbatit, - shtova unë, - ti nga cili fis je?

- Jam e fisit Shkeka?

- E fisit Shkeka?! Po ne qenkemi miq bashkë. Unë kam shumë nderim e mirënjohje për shtëpinë e Shkekës, se më ka shpëtuar jetën. A rron Ali Shkeka?

- Jo, ka vdekur, - tha ajo që duhej të ishte e mbesa.

- Unë kam shkruar për nderin e madh që më ka bërë ai burrë...

Mësuesja e letërsisë deshi të dijë burimin. Mua nuk më kujtohej se në cilin nga librat e mi të shumtë për Dibrën kisha shkruar edhe për ngjarjen që lidhej me Ali Shkekën. I dhashë fjalën se do t'ia dërgoja burimin. Por më vonë, kur ngjarjen e analizova në vetmi, doli që vërtet kisha shkruar me hollësi, por këtë e kisha bërë në një vëllim kujtimesh që ende nuk është botuar.

***

Nja njëqind metra larg shkollës, ndanë rrugës së asfaltuar, ishte restorant piceria e Selami Baloshit, ku do të hanim drekë. Preferuam të hanim jashtë nën hijen e lisave dhe shushurimën e tyre. Ishim katër vetë: unë, Jahja, Shkëlqimi dhe Shpëtim Brika. Shpëtimi na e hijeshoi sofrën dhe muhabetin. Kam ngrënë një nga drekat më të mira të jetës sime. Brenda në restorant ishte plot me vajza dhe djem të rinj të moshës shkollore, tetëvjeçare. Hanin pica, një pjesë e tyre luanin përjashta në sheshin para restorantit. Më thanë se ishin nxënës shkolle, kishin ardhur për një piknik dhe për të shijuar një drekë në lokalin mes pyllit. Ushqimi që hëngrëm ishte krejt i pastër. Edhe këtu, gjatë ngrënies, më shumë biseduam për problemet e arsimit, meqë ishim të katër arsimtarë.

***

Mbas drekës na prisnin surpriza të reja. Rruga nga Cereni për në Tejs, rreth tri kilometra e gjysmë, ishte e paasfaltuar. Rruga kishte emrin "Florian Delia"- djalit të Jahes që ra dëshmor. Bashkë me ne ishin edhe vajzat e Florianit, Jehona dhe Klea, bëmë një fotografi tek pllaka e rrugës me emrin e Florianit. Vetëm për emrin e tij ajo rrugë duhej asfaltuar nga shteti. Në vend të asaj pllake mund të krijohej një formë tjetër lapidarike, në formë obelisku ose në një formë tjetër të përshtatshme, ku do të shkruheshin pak a shumë këto fjalë:

"Në gjithë botën aviacioni është arma më e nderuar, por edhe më e rrezikshme që e venë në funksionim njerëz të guximshëm, që dashurojnë jetën dhe profesionin, njerëz krenarë që kanë kuptuar se atdheu meriton çdo sakrificë, njerëz, shumica e të cilëve kanë lënë këtë jetë të rinj, sepse ata më shumë se tokës, u përkasin qiejve dhe qiejt marrin ata që dashurojnë më fort". Këtu vendi duhej hapur dhe pastruar dhe kjo mund të bëhej me asfaltimin e rrugës.

Jahja me shpjegonte për lagjet: e para, mbas Çernjevës, ishte lagjja Derbaç (ose Ujëmirë), pastaj vinin me radhë: Rade, Stërdoku dhe, në krye fare, Tejs. Në Tejs ku do të bujtnim, kishte dy hotele. Ne qëndruam tek hoteli i Sutki Ahmatit. Ishim në verandë përjashta dhe shikonim bukuritë e natyrës. Po bukuritë janë lart, mbas atyre maleve, dhe nuk mund të shikohen dhe të shijohen duke qëndruar në tarracë të hotelit.

Mbetej për të shijuar gjelbërimin. Edhe ky është gjë e madhe po ta vlerësosh. Gjelbërimi sikur t'i lëngëzonte sytë që na ishin tharë nga asfalti dhe betoni i kryeqytetit, nga pluhuri dhe pisllëku i tij. Të binte rehat shpirti dhe unë mund të rrija me orë të tëra duke vështruar atë peizazh që kisha përpara. Më dukej vetja si një i burgosur që sapo ka fituar lirinë dhe nuk din çfarë të bëjë me të. Këtu nuk kishte pluhur, makina, zhurmë, njerëz, aq shumë njerëz sa përplasesh me to; këtu nuk kishte djersë dhe erëra të qelbura si në autobusët urbanë në kryeqytet. Shoh me vëmendje, si me ngut, sikur pamja që kam parasysh, do të ndryshojë nga çasti në çast. Korabin e kisha fare afër, sa, po të zgjasje dorën, kishe iluzionin sikur do ta arrije. I pyesja vendasit e Tejsit se cila ishte maja më e lartë. Herë thonin për njërën, herë për tjetrën, nuk ishin kurrë në një mendje. Por V. Hoxha, që mbahet si njohësi më i mirë i asaj zone, më tha se asnjëra nga ato maje nuk ka qenë Korabi. Por unë nuk dua të hyjë në hollësira: për mua Korabi është një masiv majash. Nuk ka rëndësi përse nuk dallohet ajo më e larta.

U futa në dhomë: kishte gjithçka. Mungonte vetëm televizori. U kënaqa shumë që mungonte "arka e djallit": të paktën, për një natë, nuk do ta shikoja dhe dëgjoja Taulantin, Spiropalin e shumë të tjerë si ata. Këtu nuk do të kisha grindje dhe shamatosje "analistësh". Zakonisht në shtratin e huaj mua nuk më zë gjumi, por aty bëra një gjumë të lehtë dhe të ëmbël, nën shushurimën e Veleshicës që e kisha njëzet hapa larg. Mbas pushimit dola në verandë për të pirë kafe bashkë me Jahen. Pranë nesh erdhën edhe disa katundarë dhe biseduam për një kohë të gjatë. Pothuaj nuk lamë temë pa trajtuar. U thashë që xhamia e re që kishin bërë, më kishte pëlqyer shumë, se ajo ishte vërtet një vepër arti, ndërtuar me ndihmat financiare të emigrantëve të Radomirës. Por poshtë saj ishte një xhami tjetër, ajo e vjetra, edhe ajo mjaft e mirë. Unë u thashë që paratë e xhamisë së re t'i kishin përdorur për asfaltimin e rrugës. E para e punës, më thana ata, mërgimtarët e kësaj zone paratë i kishin dërguar për xhami dhe jo për rrugën; e dyta, me aq para sa ka kushtuar xhamia, nuk ndërtohej as gjysma e rrugës.

reportazh

Vijnë gazetarë dhe bëjnë fotografi e krijojnë idenë sikur këtu në Radomirë çdo shtëpi është e mbytur në bollëk dhe se çdo shtëpi është në gjendje të presë mysafirë të nderuar nga çdo anë e botës. Por këto janë gënjeshtra, nuk janë realitet. Realiteti është ky që po shikon. Edhe pse ka trokitur vera, nuk shikon asnjë të huaj, se nuk ka rrugë. Nuk ka rrugë as për të ardhur deri këtu, as për t'u ngjitur lart, në male. Rruga është turizmi.

Kujtime: Një natë te shtëpia e Ali Shkekës

"Mos m'u harroftë te Zoti"

Nga XHAFER MARTINI

Mësuesit e tjerë të Cerenit, kolegë me mua, ishin nga fshatrat rreth e rrotull; në çdo mbrëmje shkonin në shtëpi. Megjithatë kishin sjellë nga një dyshek dhe jorgan në "odën e mësuesve" dhe rrinin ndonjë natë aty... Këshilli i fshatit na kishte futur në një shtëpi të braktisur të një familjeje që ishte arratisur. Nuk bënte as për stallë, pale më për mësues. Banja ishte jashtë, nja dhjetë metra nga dera e jashtme. Të paktën ta kishin vendosur pak më larg. Vetëm emrin kishte të tillë. Ajo ishte formuar nga dy dërrasa që i kishin ngulur përballë njëra-tjetrës, pa derë dhe pa mbulesë. Për ujë as që bëhej fjalë. Ishte mbasdite janari dhe kishte rënë shumë borë. Isha i vetëm në atë që mund të quhej dhomë dhe po lexoja një roman. Nuk më kujtohet kush ma solli lajmin që shkollat ishin mbyllur për një afat të pacaktuar për shkak të borës së shumtë. Në Ceren natyra të gënjente. Atje borë binte shumë, por erë nuk frynte. Rrugët ishin të hapura. Që atje ku isha, vëreja se rrugët dredhonin si plagë të bardha. Nuk kishte më shumë se tri-katër orë ditë, por unë atëherë isha në moshën më të mirë. Mund të shkoja edhe nesër në shtëpi, por nuk i dihej kohës. E nesërmja mund të sillte borë të re, rrugë të zëna. Kisha shumë besim tek gjendja ime fizike. Rrëshqita tatëpjetë kodrës së Çernejvës me një shpejtësi të pabesuar dhe në lokalitetin e Sllovës kam arritur me diell. Rruga vazhdonte të ishte e hapur dhe me një orë natë me siguri do të trokisja në derën e shtëpisë sime. Lodhje nuk ndjeja aspak. Por muzgu në dimër, sidomos në kohë me borë, bie papritur. Kur mbërrita në Shumbat, u njoha me një realitet tronditës: tani nuk kishte më rrugë të hapura: Frynte një erë e tërbuar që vinte nga Veriu dhe gjithçka ishte bërë dystë. Një burrë në gjysmë të moshës, po shkarkonte kalin me dru që e kishte sjellë nga mali.

- Për ku kështu, or djalë? - më pyeti ai.

- Për në Fushë Alie, - i thashë.

- Kthehu dhe rrimë sonte. Nuk shkohet në Fushë Alie se nuk ka rrugë.

- Faleminderit, - i thashë. – Kur kam ardhur deri këtu, këtu e në Fushë Alie nuk e kam fare problem.

Po të ishte rruga e hapur, vërtet nuk e kisha problem. E çava borën me forcë dhe me shpejtësi rreth njëqind metra, por shpejt e kuptova se ishte një gjë e pamundur. Nuk e kisha menduar se mund të errësohej kaq shumë në një mot me borë, jashtë në fushën e hapur. Palltoja më ngriu në trup. Më dukej se isha mbuluar me llamarinë dhe jo me pallto të re. Qerpikët dhe flokët ishin mbuluar me akull. Rrugë nuk kishte dhe unë ecja kot, të dalë ku të dalë. Gjithnjë e më avash i hidhja hapat dhe e kuptova se isha i humbur. Diçka u shfaq në rrezen e shikimit tim të kufizuar. Një gjë e zezë përparonte ngadalë në drejtim tim. Mund të ishte njeri, por mund të ishte ujk. Më shkuan djersë të ftohta në gjithë trupin. Për fat të mirë, ai që vinte drejt meje ishte njeri. Ishte një djalë i ri, gati në moshën time.

Mezi e çamë rrugën bashkë deri tek shtëpia e Shkekës.

Djali kishte një dru në dorë dhe me të i ra tri herë derës. Shtëpia ishte dykatëshe. Në katin e parë nuk kishte dritë fare. Llampa ishte ndezur vetëm në katin e dytë. U dëgjua një dumllimë shkallëve dhe gërvima në llozin e derës dhe ajo u hap. Para nesh ishte një burrë i gjatë, i parruar, me një peliçe rupa-rupa të hedhur krahëve. Shtëpia e Shkekës ishte mësuar me udhëtarë që i zinte nata në rrugë.

Soba kishte qenë ndezur. Por unë isha krejt akull. Kisha nevojë të ndërrohem, të vishja rroba të thata dhe ato që kisha veshur të thaheshin pas sobës. Por varfëria në atë shtëpi ishte ulëritëse.

- Jemi djegur këtë verë, më është djegë shtëpia me çfarë kishte brenda, shpëtuan vetëm njerëzit. Nuk kemi as rroba për të fjetur, - tha plaku.

Isha ulur në një shtroje të varfër: një copë hasër dhe diçka si lëkurë sipër. Kërkova një shkam që ta tërhiqja më tepër mbi vete nxehtësinë e sobës. Shkamin ma gjetën dhe në atë pozicion mund të më thaheshin edhe rrobat që kisha veshur. Tani akulli i madh në flokë dhe në qerpikë më ishte shkrirë, por isha lagur aq shumë sa dukej sikur kisha hyrë në lumë me gjithë rroba veshur.

- Nuk do ta harroj kurrë nderin që më bëre. Më shpëtove jetën, - i thashë plakut nesër në mëngjes kur u ndamë.

- Mos m'u harroftë te Zoti, - tha plaku.

Kur shkova te shtëpia, m'u duk sikur kisha lindur për së dyti. Ajo copë rrugë, edhe pse në zemër të ditës, më mbajti katër-pesë orë.

***

Dy vjet më vonë isha prapë mësues në Fushë Alie. Po rrija në një tryezë në klubrestorantin e lokalitetit dhe sesi më shkuan sytë te një plak i vjetër, i rrëgjuar që po rrinte me gomar nën hijen e rrapit. Gomari përpiqej të hante ndonjë fije bari që kishte filluar të thahej se ishte vjeshtë e dytë. Me pak "shtrydhje" kujtese e gjeta kush ishte plaku: Ali Shkeka. E pyeta përse kishte dalë asaj ane. Për drithë, - tha, - kam fëmijët pa bukë.

I thashë kamerieres që t'i binte plakut një mish me patate dhe një makaronë.

- Kush je ti që po m'i bën këto ndere? - më pyeti plaku.

Ia thashë emrin, por nuk më mbante mend, se më kishte shpëtuar jetën dikur. Nuk doja t'i hapesha para se të vinte çasti i duhur.

- Drithë këtu nuk ka kush Avdi Martinit. Do të shkojmë tek shtëpia e tij. Ja, dhjetë-pesëmbëdhjetë minuta larg e kemi.

Mbas gjysmë ore ishim në shtëpi. Babai po rrinte në hijen e mollës së re. Kur mori vesh kush ishte dhe se çfarë kërkonte më tha mua:

- Shko e na merr kalin në brraka. Të vish si vetëtima.

Nuk kaluan as dhjetë minuta dhe ata më panë si kapërcente dushqet e rralla dhe porenet Pela e Zezë; mbante njëqind e pesëdhjetë kile pa iu dridhur gjunjët aspak. Babai i tha Ali Shkekës:

- Gomarit hipi se ke kodrën përpara. Kalin e bie djali.

- Unë nuk kam aq para sa me ble një kuintalë e gjysmë drithë. Kam dalë me ble aq sa të mbajë gomari. Po drithi më duhet dhe duhet të më presësh për pare.

- Ti m'i ke dhënë me kohë paret e drithit, - i tha babai.

Vetëm atëherë Ali Shkeka mori vesh që më kishte shpëtuar jetën.



E pashë se u mbeti hatri përse u përmenda xhaminë që ata e donin shumë. Për mua ishte vetëm një krenari arkitekturore.

U interesova për gjithçka, sidomos për emigracionin. Kanë emigruar shumë nga Radomira. Djemve të rinj tani nuk u pëlqen të shkojnë me dhen në mal ose në shtegtim, nuk u pëlqen të jenë çobanë. Kjo ka anën e vetë të mirë, se jeta kërkonte horizonte të reja dhe se qytetërimi modern u përket edhe radomirasve, por ka edhe të keqe: Radomira nuk është vend që duhet të braktiset në mënyrë masive. Ajo është pëllëmbë e flori dhe floririn e ka në sipërfaqe: toka (mali, bjeshka, pylli), uji dhe ajri. Bagëtia është jeta dhe begatia e këtyre njerëzve. Po bagëtia do shumë punë, shumë kujdes. Të përballosh shtegtimin ishte një gjë shumë e rëndë, shumë e vështirë, por bagëtia e donte. Në Radomirë sot mbarështohet delja, si gjithmonë. Dhia mungon fare. Nuk e rritin, se dëmton pyllin. Pylli në Radomirë është i shenjtë. Në fshat kishte edhe lopë. Një tufë prej tyre na zuri rrugën kur po ktheheshim në Tiranë. Sa të bukura dhe të pastra ishin! Lopa duket tek pastërtia. U ndriste lëkura, ecnin të qeta dhe madhështore, me gjinjtë plot qumësht që sa nuk u zinin për tokë, me ata sy të bukur që herë-herë u tregojnë ngazëllim, herë-herë shqetësim. Duhet të duash bagëtinë, që të jetosh në këto male, duhet të punosh shumë për ta mbajtur atë. Këtu njerëzit janë përgjysmuar, por edhe bagëtia është përgjysmuar. Dhe është për të ardhur keq, se qumështi nuk u shkon kot, nuk është fjala vjen, si në Tiranë (fshatrat përreth), dhe në mjaft fshatra të tjerë ku një kile qumësht kushton më pak se një kile ujë. Radomira ka baxhën e vet, ku qumështi përpunohet dhe u shitet fshatarëve me çmim të arsyeshëm. Mishi i qengjit shitet dhe ka çmim të lartë. Nga qengjat mund të fitosh disa milionë në vit, se pothuaj çdo shtëpi shet nga njëqind qengja.

Në mëngjes, ndërsa po pija kafe në klub bashkë me Jahen, vjen edhe Lavdrim Madana: një djalë i ri, por dukej si i përgjumër dhe i stërlodhur. Gjithë natën e kishte kaluar me dhen. Ishte nga të pakët të rinj që e donte fshatin dhe nuk do të largohej kurrë prej tij. Kishte 500 dele dhe u shërbente me devotshmëri dhe përkushtim.

- Delja të lodh shumë, - thotë Lavdrimi. – Të jep shumë, por do kujdes dhe shërbim të madh. Punojmë shumë dhe lodhemi, por kjo është punë për vete, nuk punojmë për askënd tjetër. Vërtet atje në Angli djemtë tanë mund të fitojnë më shumë se unë, por punojnë për të tjerët.

- Ti do të largohesh ndonjëherë nga Radomira?- e pyes.

- Kurrë, për fare nuk do të largohem. Kaq qejf, si shembull, të shkoj nja dy javë të shikoj si jetojnë djemtë tanë atje, si është Anglia e të tjera, por të rri atje gjithmonë, këtë e kam të pamundur.

- Po në Tiranë ke qejf të jetosh?

- Qofshi ju që jetoni në Tiranë. Në Tiranë, për shtresën e varfër, nuk ka jetë.

Klubi rri plot deri në orën dymbëdhjetë, bëjnë ndonjë lojë domino, luajnë me letra ose shikojnë sportin. Këtu në klubin e Ahmatit biseda është e këndshme, me zë të ulët, e kulturuar, nuk dëgjon fjalë të pista, fjalor rrugësh. Përkundrazi, i drejtohen me respekt njëri-tjetrit. Shkurt, është një mjedis i kulturuar. Kërkoj një gotë raki dhe klubisti, më thotë se nuk ka.

- Nuk fus raki në klub, sado që të më sjellë fitim. Nuk e dua fitimin me sherre dhe me prishje të atmosferës së këndshme që ekziston.

Mua më sjell një gotë uiski. E ke prej meje, - më thotë.

Shtrohet darka: me mish, me të gjitha llojet e mezeve dhe të djathërave, me sallata dhe me turshi, me kos dhe me tasqebap, me çfarë të duash. Kur bëjmë të paguajmë, është e pamundur. E keni prej meje edhe darkën, thotë Ahmati. Ti, meqë je shkrimtar dhe e ke zanat penën, fole një fjalë për këtë Radomirë, mos shkruaj rrena, se rrenat nuk na pëlqejnë. Trego realitetin siç e shikon. Vijnë këtu lloj-lloj gazetarësh, që në pjesën më të madhe janë mashtrues.

Pronari i hotelit tjetër ishte më inatçor ndaj gazetarëve ose, më saktë ndaj atyre që shiten si gazetarë. Në këtë klub nuk është e ndaluar rakia, e, megjithatë, sherre dhe sjellje të këqija nuk ka. Radomirasit e kanë të hershme, shumë të hershme sjelljen e mirë ndaj njëri-tjetrit, besnikërinë dhe njerëzillëkun. Edhe në diktaturë, - thotë Jahja, kështu ka qenë, bile atëherë uniteti ka qenë edhe më i fortë, se vetëm kështu mund të shpëtoje pa u dëmtuar. Dhe, në fakt, Radomira nuk është dëmtuar: nuk ka pas njeri në burg, jo se regjimi nuk kishte kundërshtar, por se radomirasit e mbulonin njëri-tjetrin. Kurrë nuk e nxirrnin në shteg për keq. Pastaj ka edhe një anë tjetër të moscënimit të radomirasve nga sistemi i kaluar: ne ishim vend kufitar, ne na mbanin fije të tjera, të padukshme, të një patriotizmi të lashtë lidhur me këtë tokë, nuk na mbante frika e postave dhe e ushtarëve. Për ata ne iknim të gjithë me gjithë bagëti, siç edhe ka ndodhur ndonjë rast i rrallë. Por e gjithë kjo mënyrë sjelljeje, kujdes i përbashkët për të ndihmuar njëri-tjetrin ka krijuar një klimë besimi, një dashuri për njëri-tjetrin, që është kthyer në vlerë". Radomira nuk është e lehtë për ta njohur, radomirasit janë njerëz të thjeshtë dhe punëtorë, por shumë të zgjuar sa të dallojnë menjëherë nëse je njeri i ndershëm dhe ke shkuar për t'i nderuar dhe vlerësuar apo ke shkuar për t'i mashtruar.

Po le t'ia lëmë fjalën pronarit të hotelit tjetër që thotë: "Më vjen një prej atyre që e hiqte veten si gazetar dhe më thotë: "Më jep njëqind mijë lekë (të vjetra), të të bëj reklamë për hotelin". Nuk e dua atë lloj reklame që bëhet prej paresh. Ato zakonisht janë gënjeshtra. **Unë jam neveritur prej këtyre lloj gazetarësh se mashtrojnë, marrin këtu tek unë, fjala vjen, një pjatë me mish, e paraqesin sikur të jetë një tavë e pjekur, marrin tek baxhiu disa lloj djathërash ose ndonjë produkt tjetër, diku, tek klubi tjetër mund të marrin ndonjë asortiment dhe kur shtrojnë sofrën që duhet ta kenë marrë hua edhe atë, e filmojnë në atë mënyrë sikur aty të jenë grumbulluar të mirat e botës. Krijojnë idenë sikur këtu në Radomirë çdo shtëpi është e mbytur në bollëk dhe se çdo shtëpi është në gjendje të presë mysafirë të nderuar nga çdo anë e botës. Por këto janë gënjeshtra, nuk janë realitet. Realiteti është ky që po shikon. Edhe pse ka trokitur vera, nuk shikon asnjë i huaj, se nuk ka rrugë. Nuk ka rrugë as për të ardhur deri këtu, as për t'u ngjitur lart, në male. Rruga është turizmi.** Po të ketë rrugë, ti tani nuk rri duke biseduar me mua, por shkon dhe shikon ato vende që vërtet janë për t'i shikuar. Ata që vijnë, mund të mos kenë të gjithë makina, por, kur ka rrugë, pronari i hotelit ve në dispozicion të tyre një mikrobus dhe ja puna e u krye. Po rrugët duhet t'i bëjë shteti. Mos na thuaj ne "Hë, zhvilloni turizmin", kur nuk kemi rrugë.

- Gra nuk vijnë këtu në klub? - e pyes unë Ahmatin, pronarin e hotelit tjetër.

- Të huajat, domethënë turistet vijnë. Të vendit jo. Hala nuk e kemi arritur atë gradë kulture.

Jahja ma bën me shenjë që të mos e çoj më tej atë punën e grave.

- Mos e bëra si shoku Zylo, që kur shkon në fshat, i thotë kryetares së gruas që të lahen ata të parët në banjo të përbashkëta që nën shembullin e tyre ta ndjekin dhe fshatarkat e tjera?

- Jo, mor jo, asnjë temë nuk është tabu sot. Ti the vetë në takim me mësuesit në Çernjevë se kjo rini kaq shumë e emancipuar, e veshur si në kryeqytet, që këndon e vallëzon, është fara e së resë që po përhapet. Natyrisht, kur ata të bëhen në moshë, kur të fejohen dhe të martohen, do të shkojnë bashkë, si çift, edhe në klub, restorant dhe kudo. Ka sa të thyhet akulli, pastaj nuk ka gjë që e ndal dukurinë e re...

Mëngjesin e hëngra në një shtëpi, tek një baxhanak i Jahes. Tryezën e gjetëm të shtruar, njësoj si shtrohet në Tiranë në restorantin më të mirë. Kjo dëshmon se kudo ka hyrë kultura, ka hyrë e reja dhe përparimtarja, ka hyrë e bukura. Unë e përfytyroj këtë vend plot turistë dhe jam i sigurt për këtë, sikur kudo të ketë rrugë, rrugë të asfaltuar si në malet e Austrisë, atëherë turistët që përgjithësisht janë të moshuar, do të ngjiteshin dhe tek Liqeni i Zi, edhe tek Panairi (Punajer), dhe kudo ku ka mrekulli të natyrës. Por këtu rrugë nuk ka dhe turizmi do rrugë. Mua më ka habitur Kroacia me një turizëm të shtrirë tek çdo shtëpi bregut të detit. Nuk dukej si det, por si liqe, se uji vende-vende futet thellë në kontinent duke krijuar gjire të stërmëdhenj. Po ama xhadeja e asfaltuar i shkonte rrotull, nuk kishte vend që nuk përshkonte ajo, plus autostrada madhështore prej qindra kilometrash. Një që më shpjegonte përse Kroacia u bë kaq shumë e përparuar për dhjetë-pesëmbëdhjetë vjet, më tha këtë: ata u kapën pas tri gjërave kryesore: e para,- rrugët; e dyta- rrugët, dhe e treta- po rrugët. Pa rrugë nuk ka zhvillim. Çdo njeri nga Tirana pak po të jetë i dashuruar pas natyrës dhe gjërave të virgjëra, do t'i bënte tri orë me makinë për të shkuar një natë në Tejs për të parë ato mrekulli të natyrës. Por ai do të sakrifikonte po të kishte rrugë.

Por e keqja më e madhe është braktisja e fshatit. Kësaj nuk ke si ia bën, se tre-katër kilometër rrugë edhe mund të ndërtohen. Ka mjaft shtëpi, siç më thotë Jahja, që janë bosh. Edhe shtëpia e tij është bosh. Ajo është ndërtuar e re si karabina, por tani Jahja, edhe po të ketë para me thasë, nuk i bën zemra ta përfundojë. Mbasi ajo bosh se bosh do të mbetet. Njëri djalë i Jahes, siç e di gjithë Shqipëria, ra në krye të detyrës, djali tjetër është në Angli familjarisht. Ai nuk vjen më në Tejs. Kjo është tragjedia kombëtare: rrjedhja e popullsisë.

Rruga e Arbërit nr. 158
turizëm

Visit Diber

**Nëse nuk e ke vizituar ende Dibrën,
nuk e ke parë ende Shqipërinë!**

Turi i ligeneve akullnajore

Përshkrimi i turit të 17 ligeneve akullnajore të Lurës dhe Kacnisë

Janë 17 liqene akullnajore në parkun kombëtar të Lurës (7 liqene) dhe në zonën e Kacnisë, që është pjesë e territorit të Selishtës dhe Klosit, 10 liqene.

Gjatë këtij itinerari ke mundësi të eksplorosh fshatrat e Njësisë Administrative Lurë, Parkun Kombëtar të Lurës dhe fshatrat e Njësisë Administrative Selishtë dhe pyjet e Balgjait, Kacnisë, Mbas Dejës, që janë vazhdim i Parkut të Lurës.

Përveç natyrës mahnitëse, vlerat etnografike të kësaj zone janë unikale në llojin e saj, me kullat e larta me gurë të gdhendur, oboret e rrethuara me furda druri, mikpritja dhe prodhimet e veçanta të malësorëve që nga bulmeti, mjalti, gatimet tradicionale akoma të panjohura, ia shtojnë bukurinë dhe interesin për eksplorimin e kësaj treve.

Udhëtimi është 3 ditor, me makinë 4x4 dhe për pasionantët e ecjes në këmbë janë programuar shëtitje në pjesët më interesante dhe atraktive të 17 liqeneve.

EKSPLORO 17 LIQENET AKULLNAJORE NË LURË DHE KACNI

KOHËZGJATJA:	3 DITORE
LËVIZJA	ME MAKINE 4x4 OSE ME ECJE
GJATËSIA E SHTEGUT:	58 KM
VËSHTIRËSIA:	NIVELI MESATAR DHE I VËSHTIRË









Dita 1

Shijo Zonjën Lurë, një nga mrekullitë alpine të Shqipërisë

10:00 Eksploro natyrën e parkut kombëtar të Lurës, në pllajat e Lanë Lurës

Pas dy orë udhëtimi nëpër luginën e Drinit të Zi, ku ke lënë pas kanionet e Setës dhe bukuritë e fshatrave, arave dhe staneve të Çidhnës, të shfaqet magjishëm pllaja e Lanë Lurës, pjesë e Parkut kombëtar të Lurës.

Lanë Lura është një nga zonat më të mbrojtura me livadhe të gjera, pyjet të gjelbëruara, stane dhe burime ujore të shumta. Këtu ke mundësi të shijosh edhe grykën e malit të Gjargjishtit dhe Gurë Lurën, stanet, bimësinë e shumëllojshme dhe mund të shikosh zogj të ndryshëm. Pas 2.5 orë eksplorim në Lanë Lurë, dreka te Kroi i dhenve.

12:30 Dreka në stanet në Lanë Lurë ose me vete e paketuar

14:00 Nisja për në fshatin Fushë Lurë

14:20 Vizito fshatin turistik të Fushë Lurës

Fushë Lura ka një pamje panoramike me luginë alpine, që rrethohet nga malet me pyje të Lurës nga të gjitha anët, duke krijuar një diversitet natyror të mrekullueshëm. Ndalesa e parë te rruga në Borie Lurë. Ndalesa e dytë është në hyrje të fshatit për të vizituat kullat karakteristike, oboret e rrethuara me furda druri dhe gjelbërimin e livadheve, duke filluar nga kullat e Gjokolajve, Tolleve, që është monument kulture, dhe shumë kulla të tjera. Ndalesa tjetër është në qendër të fshatit, ku njihesh me vlerat historike tradicionale dhe natyrore të krahinës.

17:00 Akomodimi dhe darka tek Hotel Lura

Dita 2

Eksploro natyrën e 7 ligeneve akullnajore të Lurës (me makinë 4X4)

7:30 Mëngjesi i bollshëm në hotel

8:30 Nisja në Liqenet e Lurës me makinë

10:00 Eksploro dhe shijo bukuritë e 7 liqeneve të Lurës

Udhëtimi me makinë nëpër rrugë mali në gjendje të mirë përmes pyjeve të Parkut të Lurës, pas 1 ose 1.5 ore të shfaqen liqenet e Lurës. Udhëtimi për të shijuar të 7 liqenet do të bëhet me shëtitje në këmbë dhe zgjat 3 orë.

Dreka pas 3 orë shëtitje do të jetë në Fushën e Pelave, që është një nga perlat alpine të kullotave dhe lëndinave.

13:00 Dreka është e paketuar dhe e marrë me vete

14: 00 Nisja për në Selishtë, fshati Lukan

16:30 Mbëritja dhe akomodimi në fshatin Lukan

Udhëtimi zgjat 2.5 orë nëpër Zhurin e Pllaut. Rruga është malore dhe kalohet vetëm me makinë 4x4. Aventura është e pranueshme për çdo natyrë vizitorësh.

18:30 Darka në shtëpinë pritëse, kampingje ose në lokalin e minierave

Dita 3

Eksplorimi i 10 ligeneve akullnajorë të Kacnisë.

7:30 Mëngjesi me ushqime të vendit te shtëpia pritëse

8:30 Vizitë në bjeshkën e Balgjait dhe 10 liqenet akullnajore të Kacnisë

Nisja nga fshati Lukan për në bjeshkën e Kacnisë bëhet vetëm me makina 4x4 dhe arritja në destinacion kërkon 2-3 orë. Me ecje dhe shëtitje në këmbë për rreth 3 orë shijohen dhe eksplorohen 10 liqenet akullnajore, peizazhi i bukur dhe pyjet përreth liqeneve dhe stanet.

13:30 Dreka është e paketuar dhe marrë me vete, shijohet buzë ujit të ftohtë burimi dhe lëndinës me lule

14:30 Nisja për në Peshkopi

Përgjatë rrugës malore të Qafë Murrës vizitorët kanë mundësi të shikojnë fshatrat e Selishtës dhe të shijojnë peizazhe të mrekullueshme të Katër Grykëve dhe kanionit të përroit të Murës.

16:30 Akomodimi te shtëpitë pritëse

Sugjerohen:

GUEST HOUSE "KONAKU"	0692053492 hsalkurti@gmail.com
AGRO-TURIZËM DASHE ZERJA	0699377337 fabianzerja@gmail.com
GUEST HOUSE "UKA"	0673625835 udhetomegresin@gmail.com
KAMPINGU "KAPXHIU"	069-2258182 campingpeshkopi@gmail.com
Hotelet e qytetit:	www.visitdiber.al

17:30 Darka në shtëpinë pritëse ose restorantet e qytetit

Dita e 2 / Opsioni i dytë

Eksploro 7 liqenet e Lurës me ngjitje dhe ecje në këmbë

7:30 Mëngjesi në hotel me ushqime të vendit dhe larmi produktesh

8:30 Nisja në Liqenet e Lurës me ngjitje në këmbë (variant 2).

10:00 Eksploro dhe shijo bukuritë e 7 liqeneve të Lurës:

Udhëtim me këmbë përmes pyjeve të parkut të Lurës, ku pas 1.5 orësh të shfaqen liqenet e Lurës. Eksplorimi i 7 liqeneve zgjat 3 orë. Vizitorët njihen me karakteristikat e liqeneve, emrat, natyrën dhe legjendat. Dreka pas 3 orë shëtitje do të jetë në Fushën e Pelave, që është një nga perlat alpine të kullotave dhe lëndinave.

13:00 Dreka është e paketuar dhe e marrë me vete

14:30 Shijo diversitetin natyror të parkut të Lurës

Kthimi për në hotel në Fushë Lurë do të kryhet nga Gurë Lura. Vizitorët kanë mundësinë të shijojnë diversitetin natyror të parkut të Lurës, duke u kënaqur me bukuritë e natyrës së malit të Runjës dhe pamjen magjepse të Gjallicave të Gurë Lurës, si dhe kanionin e Setës nga pjesa e sipërme.

Në këtë itinerar njihen me legjendat, historinë, kulturën dhe traditën e lurjanëve, si zona më e pastër ilire, nga ku kanë marrë edhe emrin, si dhe tregohet rrënojat arkeologjike te kepi qytetit.

Udhëtimi zgjat 2 - 2.5 orë me ecje normale.

17:00 Akomodimi dhe darka te Hotel Lura

Ky projet u mbështet nga D2T "Dibra: Turizëm dhe traditë"

reportazh

Në kuadër të Projekti D2T, i mbështetur financiarisht nga ALCDF, u organizua një udhëtim në këtë trevë, për t'u njohur me zonën e Parkut Kombëtar të Mavrovës.

Udhëtim nëpër trojet shqiptare të **Maqedonisë së Veriut**

Nga **HAKI PËRNEZHA**



Shqiptarët e këndej kufirit në dekada kanë dashtë të lidhen e njohin pjesën tjetër shqiptare të mbetur jashtë kufijve shtetëror që në vitin 1913. Pas viteve nëntëdhjetë, edhe pse liria e lëvizjes në mes dy vendeve ishte e mundur, për shumëkënd ka qenë dhe mbetet sfidë. Nuk ka dibran nga këndej, por edhe matanë kufirit që nuk e ka ëndërruar një gjë të tillë. Në këtë kuadër, edhe Projekti D2T i mbështetur financiarisht nga ALCDF, organizoi një udhëtim në këtë trevë me objektiv për t'u njohur me punën e bërë për destinacionet turistike në zonën e Parkut Kombëtar të Mavrovës. Grupi i përzgjedhur për këtë vizitë përbëhej nga disa nga guiderët e trajnuar nga D2T, si dhe disa nga pronarët e shtëpive pritëse, të cilët kanë interes të shtuar për turizmin.

Veprimtaria jonë nisi me një vizitë në Qendrën e Informacionit Turistik të Mavrovës. Një godinë e bukur e ndërtuar në anë të liqenit, me mjedise të bollshme, ku stendat e së cilës ishin të mbushura plot me fletëpalosje e albume të shtigjeve të shumta turistike, të cilat të "tërhiqnin" për t'i parë nga afër. Punonjësi i kësaj qendre, me një anglishte të pastër, na dha mjaft informacion, duke treguar edhe dëshirën që edhe Peshkopia ta kishte një qendër të tillë. U larguam nga kjo qendër duke marrë me vete një lumë falënderimesh e urimesh për ne që kishim zgjedhur për të vizituar Parkun e Mavrovës. Destinacioni i parë ishte parku i skive, i cili, sipas shoqëruesit, është i dyti në Ballkan, pas atij të Sarajevës. Këtu vërtet lëvizjet ishin të pakta, jo si në dimër, por ama ajo që na bëri përshtypje ishte kujdesi i banorëve për të mbajtur pastër mjedisin. Askund nuk gjendej ndonjë copë letër a qese plastike të shpërndara nga erërat. Kur e krahasojmë me situatën në mjediset tona, ku ndotja plastike shihet si një gjë normale, mendojmë se vërtetë puna e guiderëve dibranë dhe e shtëpive pritëse për të përmirësuar diçka, është vërtetë sfiduese.

Lëmë pas parkun e skive dhe në kthim marrim rrugën përmes pllajave në një lartësi mbidetare mbi 1400 m, për të shkuar në fshatin turistik Galishnik. Interesante, për të shkuar në këtë fshat përshkuam 16 km rrugë të asfaltuar, anash së cilës mijëra dele kullosnin të qeta në freskinë alpine. Diku, në qilimin e gjelbërt pllajor, anës rrugës gjetëm dy punëtorë dhe një makinë mbeturinash(!). Vështrojmë makinën dhe punëtorët, të cilët mblidhnin mbeturinat në mes të maleve dhe mendonim: "Ah sikur edhe Peshkopia të kishte dhe një tjetër makinë mbeturinash…". Poshtë një gryke ku dallohej së largu qyteti i Dibrës së Madhe, ndaluam në fshatin turistik Galishnik. Edhe pse një fshat i vogël, i cili banohej më shumë me turistë, dallonte për kujdesin e treguar për mirëmbajtjen e shtëpive karakteristike të ndërtuara dekada më parë. Kisha e fshatit dhe bustet e heronjve të fshatit janë ruajtur me fanatizëm. Afria ajrore me Manastirin e Shën Bigurit i ka bërë disa nga banorët të besojnë legjendat urbane për lindjen e Skënderbeut, pikërisht në këtë fshat(!). Largohemi nga Galishniku pasi shijuam një kafe të ofruar nga njëra nga shtëpitë pritëse të fshatit.

Dreka ishte planifikuar në Grykë të Radikës, te resorti "Korabi". Ushqimet e shumëllojshme të përgatitura enkas për ne do të na shijonin shumë. Pas kësaj iu drejtuam Manastirit të Shën Bigurit. Terreni ku është ndërtuar ky manastir është mjaft i rrëpirtë, muret e tij sikur kanë "mbirë" nga guri. Këtu duket shumë e qartë përpjekja e sllavo-maqedonasve për të përvetësuar gjithçka që është shqiptare. Historiani Ilmi Veliu ka punuar shumë në këtë drejtim dhe ka mbërritur në përfundimin se djegia e arkivit të këtij Manastiri ka ndodhur pikërisht në momentin që sllavo-maqedonasit mësuan se dokumentet në arkiv tregonin dhe vërtetonin origjinën shqiptare të këtij Manastiri. Këtë e tregon më së miri edhe përpjekjet për të sllavizuar emrin shqip BIGUR-i. Një emër i përbërë me përngjitjen e ndajf "mbi-bi" me emrin "gur". Shihni përpjekjet e dështuara për ta sllavizuar: emrin "bigur" e kanë shndërruar në "bigor" + ski. Largohemi nga ky Manastir, i cili në Mesjetë ishte në juridiksionin e Gjon Kastriotit dhe se pikërisht për këtë edhe feudali i asaj kohe, Gjoni, ashtu sikurse atij të Hilandarit, edhe këtij manastiri i fali dy-tre fshatra përreth e ndër to ishte edhe fshati Galishnik, për të cilin u fol më lart. Pas kësaj grupi iu drejtua fshatit tjetër turistik Llazaropolje (ose fusha e Lazarit). Një fshat në mes malesh e pllajash, në lartësinë mbidetare 1400 metra, rruga për tek i cili na mori shumë kohë. Sa gryka e qafa, sa male e pllaja kaluam për të mbërritur në Llazaropolje! Një fshat me mbi 70 shtëpi të braktisura, por të meremetuara e të përshtatura për të pritur turistët e

Na bëri përshtypje kujdesi i banorëve për të mbajtur pastër mjedisin. Askund nuk gjendej ndonjë copë letër a qese plastike të shpërndara nga erërat... mendojmë se vërtetë puna e guiderëve dibranë dhe e shtëpive pritëse për të përmirësuar diçka, është vërtetë sfiduese.

shumët që vinin në çdo stinë. Një hotel me mbi 34 dhoma fjetje, në këtë lartësi e largësi nga qendrat urbane, të bën të mendosh se sa punë është dashtë nga pronarët e shtëpive pritëse të fshatit. Edhe këtu vizituam kishën e fshatit, në oborrin e së cilës ishte varrosur Gurshin Koka, me emrin e sllavizuar Gurçin Kokaleski. Edhe "ciceroni" i kishës, edhe pse nuk pranonte që ishte shqiptar, dinte plot fjalë shqip dhe kuptonte. Kur e pyetëm se ku i ke mësuar këto fjalë, ai tha se i kam pas dëgjuar kur isha i vogël (!).

Gjumi në këto pllaja, pas një dite të lodhshme do të ishte shumë i ëmbël dhe të nesërmen kthehemi dhe ndalesa do të ishte në Sistemin Balnear të Kosovrastit. Mjeku i caktuar na shoqëroi në të gjitha mjediset e kompleksit, duke na shpjeguar teknikat që përdoren për mjekimin e sëmundjeve të ndryshme.

Vizita do të vijonte nëpër luginën e rrjedhës së Drinit, ujërat e kaltra të të cilit herë të grumbulluar e herë në tuba na shoqëruan deri



në Strugë. Këtu grupi u njoh me përpjekjet që struganët bëjnë për të zhvilluar turizmin.

Largohemi nga ky qytet, pak të "zemëruar", me ato drurë e dërrasa të cilat "disiplinojnë" ujin e Drinit. Valët e buta e të qeta të lumit vinin vërdallë duke kërkuar ndonjë të çarë për të ikur nga ai pellg stërmadh drejt honeve e kratereve të rrjedhës së tij nëpër Dibër të Vogël.

Qershor 2019









Ilir Pilku, modeli i një dibrani të zgjuar dhe atdhetar, që aq shumë na duhet në kohërat e sotme.

Ilir Pilku, *dibrani që nuk i harron rrënjët*

Nga **OSMAN XHILI**

Ishte viti 1912, kur makineria serbe vazhdonte të godiste, të sulmonte e të shkatërronte trojet shqiptare e në veçanti Dibrën. Si dhe shumë familje të tjera të kësaj treve, në fluksin e lëvizjeve të intelektualëve që shoqëruan Ismail Qemalin ishte dhe Mehmet Pilku, stërgjyshi i Ilirit, i cili pas shkollimit në universitetet e Stambollit, u vendos në Vlorë dhe më vonë në Tiranë. Mehmeti ishte një burrë i zgjuar e me shumë vlera. Bashkë me Lef Nocin, ai njihet si themelues i Postë Telegrafit Shqiptar dhe qëndruan si drejtues të këtij institucioni për të paktën një periudhë dhjetë vjeçare. Jo vetëm kaq, Mehmeti ishte dhe deputet i qarkut të Dibrës në Parlamentin shqiptar të asaj kohe.

Njëzetë vite më vonë, kur nazizmi i shpalli luftë thuajse gjithë botës, valë të reja emigrantësh u derdhën ku mundën nëpër Europë. Hebrenjtë ishin pjesa më e prekur nga kjo murtajë. Familja e nderuar Pilku hapi dyert tej e tej për të pritur njerëzit në nevojë. Ata e kishin përjetuar vetë një dramë të tillë, vetëm dy dekada më parë, ndaj nuk nguruan ta bëjnë këtë gjë për të tjerët. Nuk ishte fjala se do të shtoheshin dhe ca frymë për t'i mbajtur me ushqime. Problemi më i madh ishte rreziku, nëse diktohej një gjë e tillë. Plumbi i gjermanëve nuk do të kursente as familjen pritëse, as dhe atë të ardhur. Familja Neumann ngriti aty strehën e re, pas një udhëtimi sfilitës, fizik e psikologjik. Por dhe pse kanë kaluar shumë kohë, pasardhës të familjes Neumann në Washington nuk harrojnë të vijnë, të kontaktojnë e të falënderojnë bamirësit e dikurshëm për nderin e bërë nga familja Pilku.

Familja Pilku vazhdoi e vazhdon të prodhojë njerëz me kulturë, me dinjitet e profesionalizëm në shumë fusha. Një prej tyre ka qenë dhe Naim Pilku, kushëriri i parë i prindërve të Ilirit. Ai ka pasur kontribute të dukshme në sport dhe në vepra kulturore. Ai mund të përmendet si një nga themeluesit e basketbollit shqiptar dhe arbitri i parë ndërkombëtar për këtë sport. Pa harruar të përmendim xhaxhain e tij, Adnant Pilku, një nga inxhinierët e talentuar, që me mundin e tyre krijuan dhe ndërtuan vepra që trashëgohen edhe sot.

VAZHDIMËSI

I përmendëm këto, pasi ka dhe shumë të tjera për të kuptuar se Ilir Pilku u lind, u rrit dhe u edukua në shtratin e një familje me vlera të mëdha. Ai mbaroi shkollimet e larta në lëmin e ekonomisë agrare, në vitet kur po binte komunizmi dhe një erë e re ndryshimesh frynte në Shqipëri e në rajon. "Nuk e kishte të lehtë familja ime për të siguruar të drejtën e studimit universitar për shkak të biografisë, por respekti shoqëror për familjen e mundësoi atë" - thotë Iliri. Përveç përgatitjes e nivelit profesional, rastësia e fati u bënë aleatë të djalit të sapodiplomuar, duke punuar

Kontributi ynë, - thotë Iliri, ka qenë i dukshëm, qoftë tek "Kop Fruti", te ferma Kaza apo tek fabrika e përpunimit të qumështit "Ngota". Plani i biznesit, projekti teknologjik, certifikimi dhe dhënia e kredive të buta, kanë qenë të gjitha objekt i punës dhe përkushtimit tonë.



pothuaj gjithnjë me projekte dhe organizata ndërkombëtare. Filloi punë me FAO-n, në rolin e administratorit, në projektin e parë, në kooperim me të huajt pas pluralizmit. Pas kësaj eksperience të parë, ndihmoi e dha kontribut në ngritjen e kapaciteteve, pranë Ministrisë së Bujqësisë, për një periudhë shtatë vjeçare.

Lufta e Kosovës i dha një tjetër eksperiencë Ilirit. Tashmë ai do të ishte në pozicionin e administratorit pranë zyrës së Kombeve të Bashkuara për Shëndetësinë, për refugjatët e ardhur nga Kosova. Ai do të menaxhonte të gjitha ndihmat dhe asistencën në këtë sektor kaq jetik e të rëndësishëm. Ndonëse periudhë jo shumë e gjatë, mësimet, kontaktet dhe eksperiencat e fituara do të kishin vlerë për gjithë jetën. Në fund të vitit 1999 Iliri angazhohet pranë zyrave të USAID në Tiranë. Qëllimi i kësaj zyre ishte të ndihmojë bujqësinë shqiptare me projekte, fonde, kredi të buta e fonde garancie, kur fermerët nuk kishin kolateralin e nevojshëm. Ky kontribut dhe angazhim bëri që të startojnë biznese të reja me teknologji bashkëkohore në fushën e bujqësisë apo qendra grumbullimi për produkte bujqësore. Fabrikat e qumështit si "Erzeni", "Lufra", "Mireli" kanë qenë pionierët e para të kësaj asistence dhe të këtij bashkëpunimi.

Një hap shumë i rëndësishëm u hodh në përgatitjen teknike të fermerëve dhe të investitorëve të rinj. Në seminare të ndryshme trajnuese në Tiranë apo në rrethe, u sollën lektorët më të mirë amerikanë, por edhe nga shtete të tjera. Po kështu, u aplikua dhe mënyra tjetër, ajo e dërgimit të njerëzve në vendet e zhvilluara për ta përfituar këtë eksperiencë direkt te burimi. Të paktën 30 – 40 veta e kanë pasur këtë fat e kënaqësi, duke shkuar në Amerikë.

Në vitin 2008 Iliri shkëputet pak kohë nga USAID, për të dhënë ndihmesën në ngritjen e funksionimin e Agjencisë së Zhvillimit Bujqësor dhe Rural, që sot njihet me emrin AZHBR. E shtyhu nisma "Brain gain" për të kontribuar në dobi të sipërmarrjes në bujqësi pranë Institucioneve Shtetërore. U hartuan manualet e para se si do të funksiononte kjo agjenci dhe si do të bëhej aplikimi dhe pagesa e fermerëve që do të aplikonin në projektet e reja.

Iliri rikthehet sërish te programet e USAID-it, duke dhënë kontribut në ngritjen e departamentit të agrobiznesit. Numërohen rreth 400 sipërmarrje në bujqësi që kanë përfituar asistencë teknike, ndihma, fonde e kredi të buta, nga zyra jonë - tregon Iliri.

PROJEKTI NDËRKUFITAR

Në vitin 2017 Ilir Pilku, tashmë me një eksperiencë gati 25 vjeçare, paraqet një projekt propozim pranë Delegacionit Europian në Shkup. Projekti në fjalë kishte të bënte me bashkëpunimin ndërkufitar mes Maqedonisë e Shqipërisë, në rajonin e dy Dibrave për çështjet e bujqësisë. Kjo nismë u miratua nga Delegacioni Europian dhe sot numri i projekteve që kanë marrë miratimin e janë financuar është rritur ndjeshëm. Ndihma e fermerëve në të dy anët e kufirit është parë në dy drejtime. Në asistencën dhe përthithjen e granteve për zhvillimin e fuqizimin e tyre, si dhe në certifikimin e produkteve të tyre me titujt "Global Gap", "ISO 22 000"dhe "Organik". Si rezultat i kësaj ndihmese, mjaft produkte të kësaj treve kanë arritur të penetrojnë në tregjet perëndimore, që do të thotë më shumë të ardhura në xhepat e fermerëve. Jufkat "Zerja", Neki Mehmeti, Zija Keshi, Arjan Zogu e shumë fermerë të tjerë do t'i jenë mirënjohës Ilirit dhe zyrës së tij për ndihmesën e pakursyer që ai u ka dhënë.

Kontributi ynë, - thotë Iliri, ka qenë i dukshëm, qoftë tek "Kop Fruti", te ferma Kaza apo tek fabrika e përpunimit të qumështit "Ngota". Plani i biznesit, projekti teknologjik, certifikimi dhe dhënia e kredive të buta, kanë qenë të gjitha objekt i punës dhe përkushtimit tonë. Në vitin 2016, me insistimin e Ilirit, zyra e USAID vendosi të hapë një degë konsulence në Dibër, një zyrë që drejtohet nga Çlirim Leshi, një djalë i gjeneratës së re. Vizioni, këmbëngulja dhe dëshira e madhe për të ndihmuar fermerët e kanë bërë këtë djalë të ri një pikë referimi e konsulent të pazëvendësueshëm në projektet e reja. Falë këtij përkushtimi e kësaj këmbëngulje janë

ILIR PILKU: Kam filluar të hedh në letër disa ide zhvilluese për ekonominë dibrane dhe padyshim që do të gjej burimet e financimit ndërkombëtar.

Ilir Pilku ka tashmë një mal me eksperiencë. Ai përpiqet të ndihmojë gjithë bujqësinë shqiptare, por Dibra ka rrënjë të thella në zemrën e tij. Ashtu si një djalë i mirë, që nuk e harron vendlindjen e të parëve të tij, Iliri përpiqet t'i bëjë me shumë kënaqësi një dhuratë bujqësisë dibrane, sa herë që mundet dhe pa përtuar aspak.

ngritur ura të reja ndihme e bashkëpunimi, duke pasur partnerë të tjerë të një gjenerate profesionistësh, si Daliun, Haxhiun, Osmanin, Besnik Alkun.

Ka pak kohë që Iliri dhe zyra e USAID kanë mbështetur me konsulencë dhe fonde një degë tjetër, të afërt me bujqësinë, agroturizmin dhe turizmin rural. Ngritja e bujtinave si ajo e Salkurtit pranë qytetit të Peshkopisë, Sabri Shahinit në Rabdisht dhe e Lul Hupit në Bulqizë, tregojnë se turizmi malor dhe ai historik do të ndihmojnë ndjeshëm në rritjen e të ardhurave për banorët e Dibrës.

Vetëm pak ditë më parë Iliri ishte në studion e TV SCAN për të promovuar turizmin malor në Shqipëri. Bashkë me të ishte miku i tij, drejtues i guidave të huaja në Shqipëri, Tobi Gessler. Ata folën për potencialet e shumta që ka vendi ynë në këtë drejtim dhe politikat që duhen ndjekur, për të pasur sa më shumë përfitime nga ky sektor.

Ilir Pilku apo shef Liri, siç e thërrasim ne, miqtë e tij, ka tashmë një mal me eksperiencë. Ai përpiqet të ndihmojë gjithë bujqësinë shqiptare, por Dibra ka rrënjë të thella në zemrën e tij. Ashtu si një djalë i mirë, që nuk e harron vendlindjen e të parëve të tij, Iliri përpiqet t'i bëjë me shumë kënaqësi një dhuratë bujqësisë dibrane, sa herë që mundet dhe pa përtuar aspak.

Tashmë ai ka kaluar në një angazhim të ri me BERZH-in. E pyesim nëse detyrat e reja mund të anashkalojnë vëmendjen e tij për Dibrën, por përgjigjja e tij është e shpejtë: "Kam filluar të hedh në letër disa ide zhvilluese për ekonominë dibrane dhe padyshim që do të gjej burimet e financimit ndërkombëtar". Ky është modeli i një dibrani inteligjent dhe patriot, që aq shumë na duhet në kohërat e sotme.

Gazeta "Rruga e Arbërit"

Aty ku fjalët nuk i merr era...

Bëj një abonim online ose në print...


Kushton vetëm 600 lekë në vit...

email: rrugaearberit@gmail.com

traditë

FJALË E FRAZEOLOGJIZMA TË RRALLA

Marrë nga libri "Toponimia e Çidhnës" i autorëve Haki Përnezha dhe Rruzhdi Bitri, Botimet M&B, Tiranë, 2016.



FRAZEOLOGJIZMA TË RRALLA

- ***Kaç e fugj:*** *Kafsho e hidh*. Thuhet për dikë që nuk kursen, që shpërdoron, që është dorëlëshuar, por edhe kur dikush punon keq: *E kishte ba kaç e fugj*.
- ***Deri n't'rrefme t'pushk's:*** *Deri sa rreh pushka, deri ku qet pushka*. Përdoret për të treguar një distancë deri 500-600 metra.

  Kraje polic e bith' magjer: *Kryet polic e bytha gomar*. Thuhet për dikë që ka çrregull të dukshëm në veshje.
- ***Kallaj pa nishadër:*** Një zgjidhje e shpejtë, e përkohshme , jo e qëndrueshme, jo e sigurt. Kallaji i vënë pa pastë (*nishadër*) nuk qendron gjatë në enë.
- ***Bejë e gjer:*** *Mbaj e sill*, por dhe *mbaj e bjer*. Përdoret për të treguar momentin *kur dikush rreh dikë pa pushim*. Fjala *gjer*, përdoret në dy kuptime: *bjer-i*, me i rënë dikujt, dhe kuptimi i dytë, *sill - me prurë, me e ngritë më këmbë*.
- ***Rref e shtajp':*** *Rrih e shtyp, dhunë*. Përdoret për të treguar se dikush i është nënshtruar një dhunë të vazhdueshme. *Vajza nuk mundi të durojë dhe iku. Rref e shtajp, rref e shtajp çdo ditë.*
- ***Ra e diç:*** *Vdiq aty p*ër aty.
- ***E dhan' e zotit:*** Thuhet për dikë që ka ndonjë të metë trupore: *ia ka dhanë Zoti*.
- ***Fap e fap:*** Onomatope*: Lidha* çenin *ham-ham/ Dy pordhë pam-pam*.
- ***Fat gjur e beft kacup:*** Përdoret me kuptimin: shumë i pafat.
- ***Krajet xhëk e menen carrok:*** Koka xhok - bardhë (me thinja, bardhë si gjogu), mendja carrok - fëmijë. Përdoret me kuptimin *burrë i thinjur, me mendje fëmije*.
- ***Zehesh n'petulla:*** *Zihesh në petulla*. Thuhet për dikë që është i egër, i sertë në komunikim. Zihesh kur nuk e pret, duke ngrënë petulla.
- ***E bam' kal':*** *E bamë kalë*. Përdoret me kuptimin: ramë në ujdi, e bindëm dikë, e detyruam të pranojë. *Mezi e bamë kalë me shkue.*

FJALË TË RRALLA

► ç'nrak: *Ai rrinte ç'nrak*. Qendrim jokomod.

► çakrravaj': Sende të ndryshme shtëpiake, të imëta.

► ç'naj': Çini. Enë në formën e pjatës prej tunxhi. Enë e ardhur nga *Kina, çini, kineze*.

► çësnar: Quhet trau që vihet nga kulmi i çatisë drejt e në qoshe të saj. Trau i qoshes, *qosnar, çësnar*.

► çajç: Quhet majuca e opingave, pjesa e mbledhur para gishtit të madh të këmbës. Çyq-i, pjesa *kyç*. Me këtë kuptim: *tyta e armës* apo edhe *buza e ibrikut*. Çajçi i *pushkës i zinte në tokë. Më është grisur çajçi i opegës.*

► çiçevetëm: *Vetëm, vetëm si qyqe, qyqevetëm*. E njëjtë me *fillikat* te Çabej.

► çfetër: Boçja e gështenjës, pjesa gjëmbore.

► çohet: E njëjtë me *ndërzehet* te Çabej· Çohet gjendja e afshit tek bagëtitë; Çabej e quan *të ethurit*, gjendja biologjike e çiftëzimit. Pas çiftëzimit vjen faza e vëzhgimit nga blegtorët, për të vërejtur nëse *mbajti* ose jo bagëtia. Nëse bagëtia brenda tre javësh nuk kërkon të çohet sërish, thuhet se *ka mbajtë*. Përdoret dhe me kuptim konotativ, për të treguar persona që merren shumë njëri me tjetrin.

► çirak: Në burim, nga turq. çirak, nxënës, shegert. Fjalë e njëjtë me çka shkruan Çabej. Në të folmet e zonës fjalës i është shtuar kuptimi *u rehatua, u kënaq: E bani Zoti* çirak. *Merre, u bëfsh* çirak! Edhe në frazeologji: *Ja çirak, ja çipllak*.

► çigene: Grua e përdalë, kurvë. Përdoret vetëm për gjininë femrore. *Oj filane, oj çigene / Hullu, hullu pak tetene* (këngë), sipas nesh: *Oj filane* (emri), *oj cigane / Afrohu, afrohu, më këndej. Tetene, tetëhe* (*për këtu*), *tetene*, me zgjerim.

► çethun: Njëllojë me *të ngjethur, të rrënqethur*. Drithërima nga të ftohti, nga ethet, nga emocione të forta. Për më shumë shih edhe tek Çabej.

► çenth's: Njësoj me *klisheza* te Çabej për *qejzit e thojit*. Më kanë dalë çentha (spicat e thonjve).

ANEKDOTA E MUAJIT

"NUSJA, NUSJA" E NUSJA KURRKUND...

Njani ishte çoban me bagëtitë e fshatit. Edhe pak i mangët e ma së shumti e kalonte në stane se në shtëpi. E kishin ba mend disa herë familja me e fejue, por hë sot e hë nesër e nuk ju ishte ba për mbarë. Njëherë i zunë nuse e vendosën me ba një darkë të vogël me aheng. Çobani kishte kujtuar se ia kishin sjellë nusen tek shtëpia. Shkuan në stan dhe e thirrën se i kishin zanë nuse. Kur erdhi në shtëpi dëgjoi disa gra që po këndonin.

- Çfarë është kjo? - pyeti.

- Fjalë nusje ke, ta kemi zanë nusen! - i thanë.

- A nuk e keni sjellë akoma a?

- Jo se kemi pru, por e kemi zanë.


- A kështu qenka puna? Qe besa ika prapë në stan. Boll ma me fjalë që tridhjetë vjet dëgjoj "nusje, nusja" e nusja kurrkund nuk asht!

(Sh.Skarra)

TREGIM ALEGORIK

Në strofkullën e gjarpërit

Nga **SHAQIR SKARRA**



Fare pranë Liqenit të Zi, në Kala të Dodës, ndodhet një toponim, që vendasit i thonë "Strofkulla e gjarprit". Po t'i hedhësh një vështrim herët në mëngjes shpatit të malit matanë fshatit Radomirë, deri në breg të lumit Veleshicë, duken disa gurë të ndritshëm që rrezatojnë edhe më shumë kur bije dielli. Sipër kësaj shpatine në lashtësi, gojëdhëna tregon se ka pasur miniera ari dhe ndoshta kemi të bëjmë me qytetin antik Demastion, për të cilin flasin studiues dhe arkeologë vendas dhe të huaj. Po legjenda çfarë tregon për "Strofullën e gjarprit'?

I thamë të gjitha këto se nganjëherë dhe legjendat kanë një bazë të vërtetë. Tregojnë vendasit se pikërisht këtu ku sot ndodhet ky toponim ishte një arë. Një fshatar i varfër ngjitej tek kjo arë dhe e punonte vazhdimisht. Një ditë, tek po pushonte pikërisht tek ky vend, nga një e çarë shkëmbi doli një gjarpër i zi sterrë dhe tepër i gjatë. Fshatari i varfër u tremb dhe bëri të ikte.

- Mos ik! - i foli gjarpri.- Ne të dy do të bëjmë një marrëveshje bashkë. Do të më bini tek kjo e çarë një tas me qumësht dhe unë do t'ju lë një pare floriri në tas.

Kaq tha gjarpri dhe u largua. Fshatari, i bërë dyll i verdhë në fytyrë, i vajti në shtëpi, por nuk tregoi për atë që kishte parë.

- Nesër në mëngjes mori tasin me qumësht që të provonte fjalët e gjarprit se sa të vërteta ishin dhe u nis për në arë. Shkoi në fillim tek guva dhe la tasin me qumësht dhe pastaj filloi të punonte në arë. Kur do të kthehej në darkë në shtëpi shkoi të merrte tasin, syve nuk po u besonte. Në fund të tasit zverdhonte një flori.

- Në darkë nuk tregoi tek shtëpia. Kështu vazhdoi plaku disa ditë me radhë. Në mëngjes çonte qumësht në tas dhe në darkë merrte një flori. Ekonomia e tij filloi të ndryshonte dhe nga i varfër u bë më i pasuri i fshatit.

- Një ditë u detyrua të shkonte diku për miqësi. Mori djalin e vetëm dhe i dha porosi:

- Merre, bir, tasin me qumësht! Kur të shkoni tek ara, aty ndodhet një shkëmb i vogël, i çarë. Tasin me qumësht lene aty se del një gjarpër dhe e pi. Në fund të tasit gjarpri ka me të lënë një flori. Ti mos bëj asnjë lloj veprimi tjetër, vetëm zbato këshillat e mia.

Kaq i tha babai djalit.

Shkoi djali e veproi si i tha i ati. Pas pak gjarpri doli nga strofkulla dhe filloi të pinte qetë-qetë qumësht në tas. Sapo mbaroi qumështin, gjarpri hodhi floririn në tas dhe bëri të kthehej në strofkull. Djali kishte parë me bisht të syrit në të çarën e shkëmbit dhe sytë ia kishin verbuar grumbuj me florinj që ndodheshin brenda.

Sakaq i bie gjarprit në bisht me një dru me qëllim që ta mbyste dhe të merrte të gjithë thesarin që fshihej në strofkull. Nga goditja gjarprit iu këput vetëm bishti. Ky, ashtu siç ishte i plagosur, u kthye dhe kafshoi djalin. Vdekja ishte e menjëhershme. Në darkë plaku dyshoi se diçka kishte ndodhur djalit, ndaj u nis tek strofkulla. Kur pa djalin të vdekur, i thirri gjarprit që të dilte, se i kishte sjellë qumështin si ditët e tjera. Gjarpri, pa dalë jashtë strofkullës, u përgjigj:

- Bishti pre,

- Djali n'dhé,

- S'ka miqësi ndër ne.

Marrë nga vëllimi "Gurrat e Korabit", Botimet "Email", Tiranë 2012

Osman Miha - Qytetar Nderi i Bulqizës, një vlerësim i merituar, i vonë, por siç thotë populli: "Më mirë vonë se kurrë"

Osman Miha - Nderi i Bulqizës

Nga **SHAQIR SKARRA**

Këshilli bashkiak i Bulqizës shënoi në shenjë, duke nderuar një ndër inxhinierët e minierës, ish drejtorin e shkollës së mesme të bashkuar, Osman Miha, me titullin e lartë "Qytetar Nderi".

Ditën e premte, më datë 14 korrik 2019, shumë të njohur dhe familjarë të Osmanit, miq e shokë, kolegë e ish nxënës të tij e lanë vapën dhe zagushinë e madhe të Tiranës dhe udhëtuan drejt Bulqizës.

Lajmi që me datën 14 korrik, në orën 11:00 paradite do t'i dorëzohej titulli "Qytetar Nderi" Osman Mihës në qytetin e vogël të Bulqizës ishte shpërndarë kudo nëpër qytet dhe domosdo që ishte pritur me gëzim. Një vlerësim i merituar, i vonë, por siç thotë populli: "Më mirë vonë se kurrë" . Ndaj, që në orët e para të mëngjesit, lokali para "TV Bulqiza" ishte mbushur plot, sa edhe tavolinat ishin bashkuar me njëra-tjetrën. Të njohur e panjohur, por shumica në Bulqizë, Osmanin e njihnin jo vetëm brezi i tij që punoi për shumë vite me to, por edhe më të rinjtë. Ishin të vjetrit ata që kishin treguar për inxhinier Osmanin kur punonte dhe drejtonte në minierë, por edhe vite më vonë kur ishte drejtor shkolle. Erdhi kryetari i Bashkisë Bulqizë z.Milaim Damzi, kryetari i Këshillit bashkiak Gazmend Kënga si dhe gjithë anëtarët e Këshilllit bashkiak, ku rrallëherë kishte ndodhur që në vendime të tilla vota të ishte unanime.

Si gjithmonë, në të tilla evenimente të rëndësishme dibrane, gazetari i talentuar i televizionit shqiptar Defrim Methasani do të fillonte të moderonte këtë aktivitet. Në fillim shfaqet një dokumentar i shkurtër, por mjaft i pasur nga jeta dhe veprimtaria e gjatë e Osmanit si në fushën e inxhinierisë minerare, ashtu edhe në atë të mësimdhënies, përgatitur nga Defrim Methasani. Të pranishmit u përqendruan sy e veshë në skenë, ku po shfaqej dokumentari. Jo që nuk e njihnin Osmanin, por mënyra se si i kishte gërshetuar ngjarjet Defrimi, vlente për t'u parë vërtet me mjaft kërshëri dhe interes.

Pas dokumentarit radha do të ishte për kryetarin e Bashkisë zotin Milaim Damzi, i

Milaim Damzi: Janë të pakta fjalët sot në këtë eveniment vërtet mjaft të rëndësishëm, e nisi përshëndetjen e tij zoti Damzi. - Të flasësh për ish mësuesin tim, për njeriun e familjarin model, për intelektualin gjithëplanësh Osman Miha nuk është nevoja të mendohesh gjatë, se fjalët burojnë nga ndjenja e shpirtit dhe zemrës, pasi me punën, sjelljen dhe virtytet e tij, Osman Miha ua imponoi respektin të gjithëve në qytetin e Bulqizës.
Emra të tillë si Osman Miha vetëm nder dhe krenari i japin qytetit tonë.



Këshilli bashkiak i Bulqizës nderoi inxhinierin e minierës, ish drejtorin e shkollës së mesme të bashkuar, Osman Miha, me titullin e lartë "Qytetar Nderi".

Te Osman Miha nuk ka ndryshuar asgjë. Është po ai i pari, që nuk dinte të mbante inate, nuk kishte mllefe, por përkundrazi, rrezaton gjithmonë e kudo vetëm dashuri e respekt në maksimum për njerëzit.

cili foli shkurt për Osmanin. "Janë të pakta fjalët sot në këtë eveniment vërtet mjaft të rëndësishëm, e nisi përshëndetjen e tij zoti Damzi. - Të flasësh për ish mësuesin tim, për njeriun e familjarin model, për intelektualin gjithëplanësh Osman Miha nuk është nevoja të mendohesh gjatë, se fjalët burojnë nga ndjenja e shpirtit dhe zemrës, pasi me punën, sjelljen dhe virtytet e tij, Osman Miha ua imponoi respektin të gjithëve në qytetin e Bulqizës. E prita me shumë dëshirë kërkesën e ardhur nga një grup intelektualësh për dekorimin e Osmanit. Emra të tillë si Osman Miha vetëm nder dhe krenari i japin qytetit tonë.

Folën pastaj Emin Gjapi, ish nëndrejtor shkolle e shok me Osmanin, Hamdi Haka, ish mësues në shkollën e Bulqizës, Agim Totraku, Muharrem Gjoka, Faik Bruçi, Latif Miha, i cili përshëndeti të pranishmit edhe në emër të familjes.

Bujar Karoshi, i cili kishte ardhur nga Tirana për këtë veprimtari, në përshëndetjen e tij ndër të tjera tha: "Për mua është një ceremoni e veçantë dhe shumë domethënëse. E njoh Osmanin pak si inxhinier, mësues e hartues tekstesh të arsimit profesional, por e njoh më mirë si një njeri të përkushtuar, të ndershëm,, korrekt e gjithmonë të buzëqeshur. Cilësi këto që e kanë bërë ta njohin të gjithë si një inxhinier të zotin, një mësues e drejtues të përkushtuar. Ky nderim që këshilli bashkiak i Bulqizës i ka bërë Osmanit,nuk është vetëm një nderim për të individualisht, por një respekt që u bëhet të gjithë mësuesve dhe njerëzve të punës. Është me fat Bulqiza që ka një Qytetar të tillë Nderi, sepse me të tillë njerëz, nderi i Bulqizës dhe Dibrës vetëm rritet".

Në fund, qershia mbi tortë, - siç u shpreh Defrimi, kryetari i Bashkisë Milaim Damzi i dorëzoi titullin e lartë "Qytetar Nderi i Bulqizës" Osman Mihës me motivacionin "Për punë të shquar në minierë dhe gjeologji dhe kontribut të çmuar në arsimin profesional në Bulqizë".

Fundi i këtij aktiviteti nuk përfundoi këtu. Latif Miha, vëllai i vogël i Osmanit, administrator i kompanisë së ndërtimit në Tiranë "Andi Konstruksion", kishte menduar ndryshe.

Të gjithë së bashku, ashtu siç ishim të pranishëm në atë sallë, u drejtuam për një drekë në dalje të Bulqizës, një drekë kjo më tepër se familjare, miqësore e shoqërore, ku nuk munguan as këngët e vallet dibrane. Orët u zgjatën e vetëm vonë pasdite e lamë Bulqizën, por e lamë me një "Qytetar Nderi" më shumë.

Po kush është në fakt Osman Miha, për ata që nuk e njohin dhe duan të dinë më shumë për jetën dhe veprën e "Qytetarit të Nderit" më të ri të Bulqizës?

U bënë më shumë se pesëmbëdhjetë vite që njihem nga afër me inxhinierin e minierave Osman Miha. Pesëmbëdhjetë vjet nuk i thonë pak. Takime të shpeshta, kafe, biseda të ndryshme komunikimi dhe herë-herë edhe debat miqësor. Nuk pata fatin ta njoh më herët Osman Mihën, atëherë kur qyteti i vogël i Bulqizës gumëzhinte si zgjua bletësh në çdo orë të ditës dhe natës. Jeta ime në atë periudhë kohe kishte marrë rrjedhë tjetër, e inxhinier Osmani e kishte lënë me dhimbje vendlindjen e tij të dashur, Qafë-Murrën për të ardhur përfundimisht në këtë qytet të bukur, të zhurmshëm, gjithë jetë e gjallëri, rrethuar nga male të lartë.

Shpeshherë kisha menduar që t'i shkruaja dy fjalë për inxhinier Osmanin, por hë sot e hë nesër, nuk më ishte bërë mbarë. Pikërisht ky titull i lartë nderi u bë shkak që kujtesa ime të trokiste tamam në kohë, dëshira për të shkruar e portretizuar jetën dhe veprën e intelektualit, inxhinierit, njeriut model, dibranit të mirë e palodhur Osman Mihës.

Lindi në Qafë-Murrë në një natë të ftohtë shkurti të vitit 1947. Ishte fëmija i parë i Hidër Mihës dhe domosdo edhe përkujdesjet ishin më të mëdha. Vendi sapo kishte dalë nga lufta e madhe dhe e gjatë nacionalçlirimtare dhe era e barotit të djegur ndjehej kudo.

Hidër Miha, edhe pse vetë ishte i paarsimuar, e donte arsimin dhe kishte besim të plotë që vetëm nga arsimi, vendi duhej të ndryshonte, ndaj dhe kurrë nuk ia preu vrullin dhe dëshirat që kishte djali i tij për t'u shkolluar.

Osmani do të vazhdonte shkollën fillore e shtatëvjeçare në fshatin e tij të lindjes dhe më vonë do të zbriste në Lunarë. Ishte larg fshatit, duhej të ecje më këmbë, në kohë të mirë dhe vështirë, por nuk u shkëput nga shkolla asnjë ditë, nuk bëri asnjë mungesë dhe niveli i tij mësimor ishte shumë i kënaqshëm. Përparimi i tij në mësime kishte rënë në sy edhe të mësuesit Adem Perhati, i cili do të ngulmonte shumë që Osmani të vazhdonte më tej.

Të drejtat e studimit vinin pak dhe me planifikim. Degët e preferuara dhe të pëlqyera nuk para vinin në fshatra të thella siç ishte Qafë-Murra.



cyan magenta yelloë black

Osman Miha qëndroi drejtor pranë shkollës së mesme të bashkuar të Bulqizë nga viti 1975 deri në vitin 1990, plot pesëmbëdhjetë vjet.



Osmani nuk qëndroi vetëm në rolin e drejtuesit dhe administrimit të një shkolle të madhe, por punoi shumë dhe me përpilimin e mjaft teksteve mësimore për shkollat profesionale si autor, por edhe me bashkautor.
Këto tekste nuk ishin vetëm për shkollën e mesme profesionale në Bulqizë, por shërbenin për të gjitha shkollat profesionale në vendin tonë.

Në vitin 1961 erdhi një e drejtë studimi për në teknikumin e minierave dhe gjeologjisë në Përrenjas, të cilën me të drejtë e fitoi Osman Miha. Ishte hera e parë që largohej nga familja, por vullneti që kishte për t'u shkolluar nuk e pengonte fare të niste një jetë larg familjes e fshatit. Shpeshherë, si nën zë, i thoshin Hidrit bashkëfshatarët e tij se djali tashmë nuk do të kthehet në fshat, do të vazhdojë shkollën e nuk dihet ku e përplasin dallgët e jetës. Djali i madh, shtylla e shtëpisë, nuk do të të bëhet krah mbështetje për ty në blegtori e bujqësi. E Hidër Miha i dëgjonte të gjithë, por e kishte vendosur se djalin nuk do ta ndalonte në udhën e dijes.

Atë mëngjes shtatori të vitit 1961 Osmani largohet nga fshati me një valixhe të vjetër druri, për të mos u kthyer më kurrë. Fillimi i shkollës së mesme ishte edhe shkëputja përfundimtare fizikisht me vendlindjen. Them fizikisht, se shpirtërisht Osmani kurrë nuk është shkëputur nga vendlindja e tij e dashur.

Në vitin 1965 përfundon teknikumin e mesëm gjeologji-miniera në Përrenjas me rezultate të mira dhe pushimet e verës i bëri në vendlindje. Nuk qëndroi shumë pranë prindërve, pranë vëllezërve dhe motrave. Një detyrë e re tashmë e priste. Jeta e tij merrte rrjedhë krejt ndryshe. Osmanin e kishin caktuar me punë në minierën e kromit të Bulqizës. Kjo ishte dhe periudha që Osman Miha do të përqendrohej jo vetëm me punë, por edhe me banim përfundimisht në qytetin e Bulqizës. Për një periudhë kohore dy vjeçare punoi si brigadier, teknik miniere, teknik makshedër në minierë. U njoh gjatë kësaj periudhe me minierën, me të fshehtat e vështirësitë e saj. Ky ishte edhe kontakti i parë i Osmanit me minierën, por edhe një përvojë e madhe pune, ku gërshetohej bukur teoria që kishte fituar në shkollë me praktikën që po e shikonte dhe prekte vetë me duar.

Në vitet 1967-1972 Osman Mihën do ta gjejmë në Universitetin e Tiranës, sot Universiteti Politeknik, fakulteti Gjeologji-miniera. I kishte dalë e drejta e studimit për inxhinier miniere, të cilën e përfundon me nota të mira në vitin 1972.

Pas përfundimit të shkollës kthehet tashmë i kompletuar në qytetin minator të Bulqizës. Qyteti kishte filluar të rritej e mjaft banorë të rinj i ishin shtuar Bulqizës. Edhe Osmani jetonte në këtë qytet të bukur minatorësh.

Në fillim filloi punë përgjegjës sektori dhe kryeinxhinier kantieri në Ndërmarrjen e Ndërtimit të Minierave, por këtu nuk qëndroi gjatë. Duke parë aftësitë e tij menaxhuese sidomos në fushën e arsimit profesional, Osman Miha caktohet drejtor i shkollës së mesme të bashkuar Bulqizë, ku kishte degët: miniera, gjeologji, shpim, elektrike, mekanike, bujqësore dhe të përgjithshme, një shkollë kjo me shumë profile dhe me një kolektiv të madh si në mësues, ashtu edhe në nxënës. Shkolla ishte hapur vite më parë, por nga vetë profilet e ndryshme, ku shumica ishin profesionale, vazhdonin edhe një numër i madh nxënësish, jo vetëm nga qyteti i Bulqizës, por edhe nga të gjitha fshatrat e deri në Shupenzë. Shkolla vazhdonte me tri turne, ku Osmani në kohë të mirë e të keqe do të dilte nga shtëpia në orën 6 të mëngjesit për të hapur dyert e shkollës e për t'u interesuar që të ndizeshin sobat në kohë të keqe, pasi nxënësit vinin të lagur dhe largohej nga shkolla vetëm në mbrëmje vonë. Në fillimet si drejtor shkolle vetëm kolektiv arsimtarësh kishte 135 veta, ku shumica vinin nga Tirana, por edhe nga rrethe të ndryshme të vendit.

Jo pak, por Osmani qëndroi drejtor pranë kësaj shkolle nga viti 1975 deri në vitin 1990, plot pesëmbëdhjetë vjet. Osman Miha nuk është thjesht vetëm një kontribues i zhvillimit të arsimit profesional në Bulqizë, por realisht një nga themeluesit e tij, dhe me emrin e tij lidhet edhe progresi i mëtejshëm i këtij arsimi. Ai e drejtoi gjatë shkollën e mesme shumëdegëshe të Bulqizës dhe i dha fizionomi të qëndrueshme profilit të minierave me drejtimin kompetent si hartues i teksteve dhe për lidhjet e gjera me minierën e kromit, duke përgatitur specialistë të aftë për zbulimin dhe shfrytëzimin e burimeve minerare, veçmas të kromiteve. Shkolla e mesme e Bulqizës, nën drejtimin e Osmanit dhe të disa mësuesve me emër, u bë baza e përgatitjes së specialistëve të lartë në degë të ndryshme të universitetit, që shkallë-shkallë plotësuan nevojat me kuadro vendas. Në hyrje të qytetit të Bulqizës ajo shkollë tërhiqte vëmendjen me godinën, me kabinetet e gjuhës së huaj, të kimisë, fizikës etj., që konkurronin denjësisht edhe ato të shkollave më të mira në qendër të Tiranës.

Janë me qindra e qindra kuadro që dolën nga bangat e kësaj shkolle e sot drejtojnë sektorë të ndryshëm të ekonomisë, dolën mjekë e inxhinierë, ushtarakë të zot e ekonomistë, gjuhëtarë e diplomatë. Krahas punës si drejtor shkolle, Osmani nuk qëndroi vetëm në rolin e drejtuesit dhe administrimit të një shkolle të madhe, por punoi shumë dhe me përpilimin e mjaft teksteve mësimore për shkollat profesionale si autor, por edhe me bashkautor. Të tillë tekste mund të përmendim: "Makina minerare", "Transport miniere", "Makina transport miniere 1", "Makina transport miniere 2". Këto tekste nuk ishin vetëm për shkollën e mesme profesionale në Bulqizë, por shërbenin për të gjitha shkollat profesionale në vendin tonë.

"Shkolla kishte vërtet mësues të mirë e kualifikuar, - thotë Osmani, por edhe nxënësit vinin të gjithë të përgatitur mirë. Kishte nxënës që edhe vetë mësuesi kishte frikë kur futej në orën e mësimit, pasi ishin aq të përgatitur, sa me pyetjet që bënin ua vështirësonin orën e mësimit edhe vetë mësuesve nëse do të vinin në klasë të papërgatitur mirë. Të tillë nxënës mund të përmend Bardhul Camin, i cili ishte i talentuar në të gjitha lëndët, saqë mësuesi kur e pyeste, orën e mësimit e ktheni në debat, duke përfituar njëkohësisht të dy së bashku, nxënësi dhe mësuesi. Edhe nxënësit pa shkëputje nga puna kishin një përparim të dukshëm, ku shumica vazhduan shkollën e lartë e të tjerë filluan punë në minierë si teknikë, gjeologë, mekanikë, elektricistë etj. Kryesore ishte se direkt nga shkolla nxënësit që mësonin pa shkëputje nga puna pajiseshin edhe me kategorinë e punës, pa qenë nevoja ta merrnin me testim në minierë."

Kur gjykojmë rreth aftësive drejtuese e organizuese të Osman Mihës, të mençurisë së tij për zgjidhjen e problemeve të shumta që i dilnin përpara, të shumta e të komplikuara, me urtësinë që e karakterizonte ai dinte që t'i zgjidhte të gjitha e t'u jepte udhë. E vetmja mënyrë për të bërë punë të dobishme, ndoshta jo të mëdha, por që të jenë të mirëpritura nga njerëzit, është që ta duash atë që bën dhe të lodhesh e të sakrifikosh për të arritur gjithçka. Dhe Osmani ishte shumë i dashuruar me punën, me profesionin.

Osmani dhe familja e tij bëjnë diferencën për mikpritjen, për njerzillëkun dhe raportin e krijuar me qytetin minator të Bulqizës.

Pas viteve nëntëdhjetë, Osmanin e heqin si drejtor shkolle, edhe pse kishte dhënë shumë, sa shkolla e Bulqizës radhitej si një ndër shkollat më të mira në shkallë vendi. Pas shkëputjes nga arsimi Osmani kalon drejtor i ndërmarrjes së bukës në Bulqizë dhe në vitin 1994, si rezultat i reformave që po bëheshin, doli i papunë. Gjatë viteve 1997-1998 fillon punë si shef në zonën "D" dhe nga vitet 1999-2000, kryespecialist i pagave dhe normave në minierën e Bulqizës.

Në vitin 2001 largohet përfundimisht nga Bulqiza dhe vjen me banim në Tiranë. Këtu fillon punë pranë firmës së ndërtimit "Andi Konstruksion", që kishte themeluar dhe administron vëllai i tij i vogël Latifi, në fillim si ekonomist e sot vazhdon përsëri si drejtues teknik pranë kësaj firme me reputacion në Tiranë dhe jashtë saj.

Punoi e jetoi në një kohë të vështirë, në një moshë të re, kur shokët e tij ende nuk kishin dalë nga bangot e shkollave. U përplas me dallgët e jetës nga më të vështirat, por Osman Miha ishte një pinjoll i një familje të mirë, të njohur jo vetëm në Qafë-Murrë, por dhe jashtë sinorit të saj. Ai veproi me kujdes dhe çau përmes dallgëve dhe furtunave, se i tillë ishte brumosur.

Logjika udhëzon vetëm një pjesë të vogël të njeriut, ndërsa pjesa tjetër i bindet pasionit dhe ndjenjave të vërteta. Ndërsa jam njohur fare mirë me punën gjysmëshekullore të Osman Mihës, të cilën e ka nisur me hapa të vegjël, por mjaft të sigurt për të "udhëtuar" gjatë, mendja më shkon te mundësitë që paska në fakt njeriu për të qëndruar deri në fund besnik, për të ndryshuar veten dhe shoqërinë. Ai gjithë karrierës së tij ia kushtoi arsimit në përgjithësi e në veçanti arsimit profesional. Osman Miha ka qenë gjithmonë pjesë në teatrin e jetës shqiptare, por kurrë si spektator i saj.

Kanë kaluar shumë vite, kanë rrjedhur shumë ngjarje dhe ujëra të rrëmbyeshme në jetët njerëzore. Te personaliteti i Osman Mihës nuk ka ndryshuar asgjë, megjithëse i ka kaluar shtatëdhjetë vitet. Është po ai i pari, që nuk dinte të mbante inate, nuk kishte mllefe, por përkundrazi, rrezaton gjithmonë e kudo vetëm dashuri e respekt në maksimum për njerëzit.



Bujar Karoshi: Për mua është një ceremoni e veçantë dhe shumë domethënëse. E njoh Osmanin pak si inxhinier, mësues e hartues tekstesh të arsimit profesional, por e njoh më mirë si një njeri të përkushtuar, të ndershëm, korrekt e gjithmonë të buzëqeshur, cilësi këto që e kanë bërë ta njohin të gjithë si inxhinier të zotin, mësues e drejtues të përkushtuar. Është me fat Bulqiza që ka një Qytetar të tillë Nderi, sepse me të tillë njerëz, nderi i Bulqizës dhe Dibrës vetëm rritet





www.rrugaearberit.com

Na ndiqni *online*, falë ndihmës së z. Agim Deva, të cilin e falenderojmë për ndihmën dhe përkushtimin.

Informacioni për faqen online: **info@rrugaearberit.com**

Informacioni për versionin e printuar: **rrugaearberit@gmail.com**

Përdor KONTAKT PAGE për pyetje dhe sygjerime.

Shtyp butonin **"NDIHMO EDHE TI"** që gjendet në faqen e parë në versionin online për tu abonuar dhe kontribuar në botimin e gazetës, ose kontakto me redaksinë. Çdo kontribut bëhet publik.

Çdo lloje kontributi shkon në masën 100% në llogarinë e gazetës në Tiranë/Shqiperi në mënyrë të sigurtë përmes PayPal.

Website është një kontribut në shërbim të botimit të gazetës "Rruga e Arbërit", lobimit për ndërtimin e rrugës me të njëjtin emër, që do lidhë Tiranën me pjesën tjetër të Ballkanit në Lindje të Shqipërisë, si dhe zhvillimin e Dibrës dhe krahinave përreth.

Mund të na ndiqni edhe në Facebook duke kërkuar me emrin "Rruga e Arbërit" ose përmes lidhjes:

https://tinyurl.com/lcc3e2f

Foto Majtas tregon pamjen e parë të faqes zyrtare në Facebook të gazetës *Rruga e Arbërit*

NE nuk jemi gazetë e pavarur, NE jemi gazetë e lirë
dhe pavarësia dhe liria jonë garantohet
vetëm nga mbështetja e lexuesve...

BËJ PAJTIMIN TËND!

Një pajtim vjetor kushton:
Në Shqipëri: **600 lekë.** Në Europë: **10 Euro.**
Në SHBA dhe vende të tjera: **15 USD**.

Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

REKLAMO BIZNESIN TËND

Një faqe e plotë me ngjyra kushton 15000 lekë

Me **1000** lekë mund të rezervosh një reklamë gjatë gjithë vitit në format kartvizite (8x5cm)

BOTIMET M&B


LIBRA PËR ÇDO BIBLIOTEKË


Të gjitha botimet tona mund ti gjeni pranë rrjetit të librarive "ADRION", librari "Art's" të Stacioni i Trenit në Tiranë, FletaXXI në Peshkopi ose mund ti porosisni përmes agjencive të shpërndarjes së librit ose Bukinist.al




























kujtime

Njerëz të mirë të Dardhës! Me dashurinë dhe respektin me të cilin na rrethuat, i kaluam të gjitha vështirësitë.

Kur më merr malli për gegërishten

Nga **PETRO MEJDI**

Molla të këputuna një deget
dy qershia lidh në nj' rrfan'.
Ku fillojnë kufijt ' me geget,
rrin' dy çika me një nanë.
Ndre Mjeda "Andra e jetes "

Kujtoj, që ende nxënës, kur shkoja nga Skorea në Poliçan, për të ndjekur tetëvjeçaren dhe kur nga larg shikonim mushka të ngarkuara që i ngisnin kufitarë të postës së Sopikut, ne fshiheshim në dushkajën e dendur poshtë rrugës. Mbanim frymën derisa të kalonin dhe mundoheshim që të dallonim ndonjë fjalë nga dialogu i tyre. E kapnim ndonjë fjalë dhe pastaj mundoheshim që të zbërthenim kuptimin dhe konstatonim se ishin fjalë që i dinim, por pak më ndryshe. Nuk ishte vetëm gjuha pak ndryshe, se shumica e tyre vinin nga krahina të Shqipërisë së Mesme dhe të Veriut, ashtu dhe djemtë e anëve tona shkonin ushtarë në viset e tyre, por ajo që na trembte më shumë ishin armët. Karabine apo automatik, më shpesh me grykë poshtë dhe rrallë të varura në samarin e mushkës. Ne më të vegjlit merrnim guxim dhe qëndronim anash së përpjetës shtufore, derisa të kalonin ata. Na thërrisnin "Ella re pedhja, ella re kopeles" dhe ne dilnim nga dushqet. Guximi dhe miqësia arritën deri atje saqë bënim dhe shkrepje boshe. Mua, pra, që dikur në fëmini trembesha nga fjalët e gegërishtes, më takoi fati që të "bashkëjetoj" me këtë dialekt të shqipes gati 20 vjet. Në fillim kontakti me të ishte në librat e Leximit letrar dhe antologjitë mësimore. Mjeda, Migjeni, Filip Shiroka, Qemal Stafa, Vaso Pasha e Luigj Gurakuqi ishin poetët mjeshtra të poezisë së shkruar në këtë dialekt. Dhe rasti e solli që të jem student m'u në zemër të gegërishtes letrare, e cila i dha letërsisë shqipe perla të paarritshme. Muajt e parë ishin të vështirë. Por muzikaliteti nga njëra anë dhe koloriti gazmor dhe humoristik i të folmes, bënë që t' i kuptoj, por asnjëherë nuk munda që të flas sadopak në shkodranishten e bukur. Kur isha nxënës në Poliçan, në një numër estrade të rinisë së fshatit, të drejtuar nga i shumëtalentuari Jorgo Iso, Kosta Iso, veterineri që kishte bërë shkollën në Shkodër, në një kuplet të interpretuar në shkodranisht bëri që të qeshin të gjithë. Ndoshta për mua që isha nga jugu dhe greqishtfolës më pengonte dhe "tradhtonte" aksenti i toskërishtes jugore dhe më shumë ai i greqishtes, një gjuhë krejt e veçantë. Tani



Lura. Marrë nga https://www.intoalbania.com/attraction/lura-national-park/

që i njoh mirë të dy gjuhët, greqishten dhe shqipen, bindem se kanë të përbashkët jo melodinë, por anën dinamike të të folurit.

Erdhi emërimi. Në Dibër. Fillimisht Lura! As një muaj. Ndoshta ishte se vija tashmë nga një jetë disavjeçare në një qytet të gegërishtes, por e folmja e Lurës m' u duk shumë e kuptueshme. Jo vetëm kur më drejtoheshin mua, se njerëzit në këtë rast mundoheshin të kujtonin gjuhën e librave, por edhe kur flisnin me njëri-tjetrin i kuptoja mirë. U transferova në Ostren. Rezistova pak tek zyra e drejtorit Hajri Begu, një nga mësuesit intelektualë të vërtetë të Peshkopisë. - Nuk mund të të ndihmoj! Është urdhër i Sanie Batkut. Vrapova te harta e Shqipërisë që të shoh se ku ndodhet ky fshat. Sapo pashë, se gati ngjitur me të kalonte vija e kuqe e xhadesë, mblodha valixhen. I hipa një makine të tregtisë. Të nesërmen dal tek agjhencia pranë lumit. I drejtohem një burri. - Cili autobus shkon për në Klenjë? - Futu mbrenda dhe po nuk dëgjove shqip, ulu në të! Po kjo, thashë me vete! Nuk e dija këtë hollësi, se në vendin ku shkoja, nuk flitej shqip. Si në fshatin tim, më kaloi një mendim. Gjatë gjithë rrugës shumica flisnin sllavisht. Më vonë mësova se asaj të folmeje vendasit i thoshnin "bugarski " dhe dëgjova shprehjen "Ar znaesh bugarski Njie znajet po nash", ishte një shprehje që e dëgjova shpesh, sa kohë qëndrova në Ostren. Më ndjekin gjuhët e huaja, mendova ato ditë. Por kishte dhe një të mirë, shqipen e flisnin si në Pogon, shumë pranë gjuhës së librave. Mësova goxha nga gjuha e vendit. Edhe tani në Greqi e praktikoj me bullgarët. Nuk më kuptojnë gjithmonë. Erdhi dhe transferimi tjetër. Nga kufiri me Mirditën, në kufi me Librazhdin dhe tani me Kukësin. Zall Dardha! E njohur prej meje nga këngët e Haziz Ndreut dhe Lirie Rashës. Sa ramë në kontaktin e parë me banorët, fqinjët e pallatit ku do të banonim dhe disa nxënës që na ndihmuan për të shkarkuar skodën, e ndjeva vështirësinë e të folmes së vendit! Nga ato ditët e para më ka mbetur e pashlyer nga kujtesa kjo skenë: Ishte një mbasdite e vranët. Në lartësitë e maleve retë kishin zbritur në pllajat e tyre. Isha para PTT-së. Unë, Shqipja, mamia e spitalit dhe xha Mustafa, njeriu i mirë Mustafa Hoxha, me të cilin më vonë u bëmë miq. Filluan të bien ca pika shiu. Xha Mustafa thirri një nga djemtë e tij, nxënësi im, dhe i thotë: Or tei, a je tu shkue me mal dhaet se a tu fillu shaju! Unë hapa sytë dhe vështrova maminë. Mesa duket, vështrimi im ishte i tillë që mamisë iu duk sikur i thashë: "Më thuaj se çfarë i tha?!" Xha Mustafa i tha djalit të tij të shkonte të milte dhitë para se të fillonte shiu. Djali filloi të fliste si shokët e tij vendas. Kur shkonim në Tiranë i jepnin pecin e petëve dhe e vinin të këndonte një këngë me çifteli. Dhe ai nuk ia prishte qejfin gjyshit, se i sillte fera manafera dhe këndonte: A më njeve (ndjeve) moj a më njeve, kur të vuna unazën, të cilën e kishte dëgjuar të kënduar në festivalin zonal. Kur shkonim në Skore dhe i shpëtonte ndonjë fjalë në gegërisht, disa e ngacmonin duke i thënë "malok". Një ditë erdhi i mërzitur.

Erdhi dhe transferimi tjetër. Nga kufiri me Mirditën, në kufi me Librazhdin dhe tani me Kukësin. Zall Dardha! E njohur prej meje nga këngët e Haziz Ndreut dhe Lirie Rashës. Sa ramë në kontaktin e parë me banorët, fqinjët e pallatit ku do të banonim dhe disa nxënës që na ndihmuan për të shkarkuar skodën, e ndjeva vështirësinë e të folmes së vendit!

Ishte një mbasdite e vranët. Në lartësitë e maleve retë kishin zbritur në pllajat e tyre. Isha para PTT-së. Unë, Shqipja, mamia e spitalit dhe njeriu i mirë Mustafa Hoxha. Filluan të bien ca pika shiu. Xha Mustafa thirri një nga djemtë e tij, nxënësi im, dhe i thotë: Or tei, a je tu shkue me mal dhaet se a tu fillu shaju! Unë hapa sytë...

Gati për të qarë e na tha: Në Zall Dardhë më thonë grek, në Skore më thonë malok!

Njerëz të mirë të Dardhës! Me dashurinë dhe respektin me të cilin na rrethuat, i kaluam të gjitha vështirësitë. Kur ikëm, lame shumë miq e shokë! Por unë si lexues gjithmonë kam lexuar dhe lexoj letërsi në gegërisht. Mbaj mend, pa përmendur klasikët e letërsisë shqipe, "Vlaga e dheut" dhe "Diell nën kreshta" të Filip Ndocajt, novela dhe tregime, poezi të Mark Gurakuqit, poemat e Llazar Siliqit, vëllimi poetik i kolanës së poezisë shqipe të Drago Siliqit, proza dhe poezia e Kol Jakovës etj., vepra të cilat i lexoj edhe tani.

Pas vitit 1990 hapësira e leximeve në gegërisht u zgjerua dhe me vepra të Fishtës, Koliqit, Camajt etj. Më kanë rënë në dorë dhe botime të brezit më të ri të autorëve shkodranë, kryesisht. Nuk jam plotësisht dakord me ta! Ja , pra, nga frika prej fjalëve gege, u bëra një lexues i zellshëm i letërsisë së shkruar në atë dialekt. Sa herë më merr malli për ato vise të legjendave shqiptare dhe banorët e tyre, marr një libër nga rafti dhe çmallem!



Shtëpi tradicionale në fshatin Zall Dardhë/ pinterest.com



Shtëpi tradicionale në fshatin Zall Dardhë/ illyriapress.com

Shumbati është një fshat model i urtësisë dhe mençurisë së përcjellë në mexheliset e odave shumbatase, i filozofisë së të drejtës, e cila nuk e ka humbur kurrë orientimin, edhe në kohët më të vështira...

Borxhin ta ktheva vendlindje

Nga **DUKAGJIN HATA**

Kërkimi në kujtesën e të gjallëve dhe të të vdekurve, duke ndjekur gjurmët e breznive në kohë, është një nga misionet më kuptimplotë të njeriut në jetë, pasi pa e ditur se nga ke ardhur, nuk mund të dish as ku je e as ku do të shkosh. Sidomos në moshën e autorit të këtij libri, Shaqir Skarra, por dhe në moshën time, ky kërkim kthehet në një model verifikimi të ndodhive dhe rrëfimeve të atyre që kanë ardhur gjer në kohë-hapësirën e brezit tonë si mesazhe vazhdimësie dhe përjetësie.

Duke lexuar këtë libër, rresht pas rreshti, pasazh pas pasazhi e kapitull pas kapitulli, bindesh se autori ka bërë një punë serioze, me pasion e përkushtim, për të na përcjellë historinë e një fshati, vendlindjes sonë të dashur, të cilit i ka mjaftuar vetvetja për të mbijetuar dhe përcjellë mesazhe nëpër kohë, gjer në ditët tona.

Shumbati nuk është një fshat i zakonshëm e për rrjedhojë dhe ky libër për të, shkruar me aq ngrohtësi e dashuri nga autori Shaqir Skarra, nuk është një libër i zakonshëm. Ndaj dhe përgjegjësia ime për të bërë një punë kualitative, redaktoriale, mori një dimension tjetër. Sa më shumë shtyhesha në rrjedhat e ngjarjeve të trajtuara në këtë libër, të personazheve të gjallë e të vdekur, të kujtesës së gurëve, pemëve, trajtave toponomastike, që rrëfejnë një narrativë ngulmimi autokton, aq më shumë kuptoja se përveçse një lloj manuali njohës e reflektues mbi udhëtimin e një fshati në kohë, ky libër është dhe një monografi me vlerë për luftën e njeriut të thjeshtë për të mbetur krenar në ngulmimet e tij, në etjen e tij për të ndryshuar rrjedhat e vështira dhe të pamundura, në favor të një jete më të mirë, më dinjitoze dhe më kuptimplote.

Gjurmët e Shumbatit në histori shtyhen thellë në qerthujt e kohës, deri në Antikitetin e largët, edhe pse gjurmimi shenjor i tyre, me anë të dokumenteve shkrimorë, është realitivisht i vonë. Duke qenë pikë kalimi jo vetëm për trevën e Dibrës, por dhe më gjerë, këtu kanë kaluar ushtri të huaja e vendase, mbretër, komandantë e strategë ushtarakë, janë bërë beteja e luftëra të stuhishme, si Beteja e Torviollit, e cila ka hyrë në analet më emocionuese të lavdisë shqiptare, duke dëshmuar në shekuj shpirtin e qëndresës së pathyeshme për liri dhe dinjitet shoqëror.

Shumbati është një fshat model i urtësisë dhe mençurisë së përcjellë në mexheliset e odave shumbatase, i filozofisë së të drejtës, e cila nuk e ka humbur kurrë orientimin, edhe në kohët më të vështira, kur e drejta dukej se nuk ekzistonte dhe shpërfytyrimi e degradimi qenë ngritur në sistem.

Shumbatasit janë njerëz punëdashës, me intuitë të mprehtë, me kurajë e shpirt qëndrestar, për të përballuar sfidat dhe për të shtruar rrugët e zgjedhjeve dhe zgjidhjeve më të mira të mundshme.

Ky libër përcjell sagën e fiseve të një fshati që e duan jetën dhe në emër të saj, të vlerave më qenësore të ekzistencës njerëzore, si nderi, dinjiteti, besa e bujaria, kanë sakrifikuar e vazhdojnë të sakrifikojnë, pasi një jetë e vlefshme dhe kuptimplote për t'u jetuar nuk mund të ketë kuptim pa këto kode të forta të ekzistimit njerëzor.

Shumbatasit i shohim në këtë libër si luftëtarë të angazhuar në të gjitha luftërat për liri e mëvetësi, si bartës të mendësive më të përparuara të kohës, si njerëz që dinë të respektojnë mikun, shokun, fqinjin, dinë të mbështesin të tjerët në nevoja ekzistenciale, në kushtrime lufte e qëndrese, si punëtorë duarartë dhe mentarë të odave e mexheliseve.



Autori përpiqet të vendosë pikat mbi "i" për ngjarje, episode të ardhura nga koha në kohë, nga brezi në brez, protagonistë, fise, tradita e kode zakonore, shenja të tjera ekzistimit të një fshati, që nga ngulmimet e para në kohë-hapësirën e fillimit, kur shfaqen më së pari gjurmët e tij dhe gjer në ditët e sotme.

Në shpalimin e gjithçkaje shpirtërore, që nga kultura e mikpritjes gjer tek ushtrimi i riteve, zakoneve e traditave të ardhura brez pas brezi, Shumbati është krejt i veçantë dhe shpreh mendësinë e një fshati që di të respektojë vlerat, di të ndërtojë jetën dhe të shijojë mirësitë e natyrës dhe universit.

Autori depërton në shtresimet e mendësive dhe psikologjisë shumbatase, që kanë vënë në veprim mekanizmin e jetës në këtë fshat të madh, me një etje të pashuar për dinjitet njerëzor.

Në këtë këndvështrim, kuptimshmëria e rrëfimeve të Shaqir Skarrës në këtë libër janë të ngrohta, të vizatuara lehtë dhe të spërkatura me nuanca të imëta nostalgjie e malli, çfarë është më se e natyrshme për dikë që niset në një "aventurë" shkrimore drejt rrënjëve të vendlindjes, të cilat janë rrënjët e tij dhe të të gjithë ne të tjerëve, që jemi pjesë e tyre, pjesë e një sage krenarie dhe dashurie njerëzore, me emrin Shumbat.

Përshkrimet e gjalla, të detajuara imët, me një narrativë të ngrohtë e stil të zhdërvjellët, ku zotërojnë fjalitë e thjeshta, me rezonancë komunikimi sa më të gjerë, e bëjnë këtë libër të lexohet me një frymë, me kureshtje dhe dëshirë reflektimi.

Në libër ka momente prekëse dhe emocionuese, siç është, bie fjala, rezistenca e organizatës bazë të partisë së Shumbatit, e cila në unison me banorët e tjerë të fshatit, edhe pse nën survejimin famëkeq të Sigurimit, bënë një qëndresë të fortë, për të mos lejuar kthimin e fshatit nga ndërmarrje bujqësore, siç ishte, në kooperativë. Edhe pse mekanizmat e kohës ishin diabolikë dhe, siç thotë populli: "Murit me kokë nuk i bihet", ky akt tregon se për shumbatasit, bashkëjetesa në harmoni dhe në interes të përbashkët të gjithsecilit, qëndronte më lart se çdo ideologji dhe direktivë e kohës.

Autori duhet përgëzuar për punën me përkushtim e përgjegjësi që ka bërë në shkrimin e librit, në qëmtimin dhe përcjelljen e fakteve dhe detajeve jetësore e historike, me një gjuhë të thjeshtë e të kapshme nga të gjithë.

Secili fis, secila familje, gjithkush që ka një kontribut sado modest në fisnikërimin dhe lartësimin e emrit të Shumbatit, zë vend në faqet e këtij libri, të shkruar me zhdërvjelltësi e ngrohtësi, të shkruar, si i thonë asaj fjalës, me zemër në dorë.

Ky libër duhet të jetë një libër tavolinë për çdo familje shumbatase, për çdo shumbatas, kudo që ndodhet, në vendlindjen e tij të rrënjëve e degëve apo në treva të tjera të atdheut, urbane a rurale qofshin, në emigracionin e vjetër a të ri, në diasporë e gjetkë... Por ia vlen ta kenë si libër shtëpie të gjithë ata që duan të njohin më në gjerësi e më në thellësi historinë e trojeve tona etnike, nëpërmjet dyerve, fiseve e fshatrave më në zë, histori e përgjithshme kjo, ku rri me aq natyrshmëri e dinjitet historia e veçantë e Shumbatit, përcjellë nga autori Shaqir Skarra.

Ky libër përcjell sagën e fiseve të një fshati që e duan jetën dhe në emër të saj, të vlerave më qenësore të ekzistencës njerëzore, si nderi, dinjiteti, besa e bujaria, kanë sakrifikuar e vazhdojnë të sakrifikojnë, pasi një jetë e vlefshme dhe kuptimplote për t'u jetuar nuk mund të ketë kuptim pa këto kode të forta të ekzistimit njerëzor.

BORXHIN TA KTHEVA VENDLINDJE
Vështrim historik dhe etnokulturor
SHAQIR SKARRA

Botimet M&B
ISBN 978-9928-256-85-0
Faqe: 444 / Çmimi: 1500 lekë



botim i ri

Peshkatari i perlave

Pak kohë më parë, ndërsa po kërkoja diçka në dhomën ku dikur rrinte im atë, aty pranë librave dhe disqeve të vjetër të gramafonit gjeta një ditar të tij ku mungonin shumë fletë. Të gjithë rreshtat fshirë e prishur. Në ato fletë të zverdhura kishin mbetur vetëm tituj të ndryshëm këngësh dhe poshtë tyre edhe një datë.

Dëgjoj këngët që i pëlqenin tim eti dhe e njoh siç nuk e kam njohur ndoshta më parë, si nëpër mjegull e shoh atë, ndjej hapat e tij, buzëqeshjen dhe vështrimin herë të ëmbël e herë ironik. Kujtoj duart e tij që lëviznin nën ritmin e notave.

Kjo që po dëgjoj tani, ndërsa po shkruaj këto shënime, është një pjesë e trishtuar nga "Peshkatarët e Perlave" dhe daton kur ai ka qenë njëzet e katër vjeç. Kur unë isha një vjeç. Ndoshta ka qenë i dashuruar në atë kohë. Ndoshta jo me time ëmë. Ndoshta po.

Më vonë në faqet e ditarit te tij mungojnë këngët. Nuk dëgjonte më muzikë kur ne fëmijët u rritëm. Më trishton shumë ky fakt. E mbaj mend madje kur na thërriste "Hej çuna, mbylleni atë radio se na çmendët me muzikë tërë ditës!"

Mbyllej në vetminë e tij dhe zhytej mes faqeve të librave deri në përhumbje.

Ime më vuajti tërë jetës nga xhelozia për të. E donte shumë. Edhe sot kur thinjat e kanë mbuluar të tërën dhe një reumatizëm e vjetër e bën të ecë me ndihmën e një bastuni shkon te varri i tij dhe me një zë që e dëgjon vetëm ajo diçka i pështpërit.

Nga lëvizja e buzëve kuptoj që i thotë: "T'i kam falur të gjitha..."

E dashuronte nëna. E adhuronte edhe pse me flatrat që i jepte prania e mrekullueshme e saj në jetën e tij, ai herë-herë fluturonte në vise të tjera...

Qytetet e vogla kanë gjithnjë gra interesante. Mjafton të kesh vështrim të kujdesshëm dhe i dallon lehtësisht ato. Nën hapin e lehtë dhe në flokët që ua merr era me pak vështirësi një sy i stërvitur mund të shquajë pasigurinë dhe dramën e pashkruar të tyre.

Unë nuk i njihja ato të gjitha. Por ato të gjitha më njihnin. Mbaj mend vagullt nga fëmijëria ime imazhe grash të panjohura, të cilat, teksa më shihnin në rrugë, ndalonin, më pyesnin nëse isha djali i tij dhe më përqafonin e më puthnin në faqe.

Duhet të kenë qenë vërtet të bukura mikeshat e babait. Më vjen mirë të mendoj kështu. Ai shquhej për shije të hollë, dëgjonte muzikë të përzgjedhur dhe lexonte shumë poezi.

* * *

Sot takova dikë pranë varrit të tij. Një grua e panjohur. Plakë. E rrudhur, e thinjur dhe me një tufë lulesh në dorë. Më pyeti për të.

"Siç e sheh, babai ka kohë që ka vdekur", - i thashë duke i treguar me dorë fotografinë e tim eti mbi varr.

"E di...e di...", - m'u përgjigj, "por..."

Heshti dhe pas një grime, me vështrimin hedhur drejt diçkaje të largët e të padukshme si përjetësia, shtoi: "Babai yt ishte tërheqës si djalli. Kam bërë gjëra të çmendura për të..."

"Po nëna rron?", - më pyeti pas pak.

"Rron... ashtu... e sëmurë dhe e plakur tashmë..."

"O Zot sa i ngjason tyt eti!", - tha befas plaka me lule dhe duke më parë drejt e në sy nisi rrëfimin e saj:

"Isha e re atëherë... disa vjet më e madhe se babai yt. Isha shtatzënë dhe nga dita në ditë prisja të lindja fëmijën e tim shoqi, kurse yt atë asokohe kishte një djalë motak, që ishe ti. I gjithë qyteti ynë i vogël e dinte që ne ishim dashnorë. Edhe nëna jote e dinte. E mrekullueshmja nëna jote! Atë ditë isha grindur me babain tënd. Shumë! Aq shumë, sa rrezikova një abort spontan. Më kishte rënë të fiktë dhe më kishin çuar me urgjencë drejt e në maternitet. Në sallë të operacionit, ku punonte nëna jote. Isha tërësisht në duart e saj. Unë dhe fëmija im i ardhshëm. Në duart e gruas që unë urreja më shumë. Në duart e asaj që sa e sa herë kisha uruar me gjithë zemër të mos kishte ekzistuar kurrë. Në dorën e asaj së cilës nuk guxoja kurrë t'i dilja përballë rrugëve të qytetit. Nëna jote e mrekullueshme! Ajo që përjetësisht e mbante larg meje babain tënd...

Operacioni i vështirë dhe zgjati disa orë... Humba shumë gjak dhe rrezikoja të vdisja nga hemorragjia. Në një moment më doli narkoza dhe ndjeva thikën dhe pincetat në duart e nënës tënde që punonin mbi trupin tim... Këtu...", dhe plaka vuri duart aty poshtë. Ia hodha sytë aty dhe instinktivisht mendova nënën. Kushedi si është ndjerë ajo para atij fundbarku të përgjakur të shemrës së vet...

"Herë-herë dora e saj fshinte djersët e ftohta që mbulonin ballin tim... dhe më thoshte: "Kurajo... kurajo... edhe pak dhe mbarojmë...". Fëmija lindi pothuajse i mbytur nga ujërat e mia... Një mami e hodhi në koshin ku hidheshin foshnjet e lindura të vdekura, por ajo, nëna jote, gruaja që unë urreja aq shumë, e rrëmbeu në çast nga ai kosh dhe me frymëmarrje gojë më gojë e shpëtoi dhe e ktheu përsëri në jetë beben time... vajzën time...

Ditën kur do të dilja nga materniteti, i shkova në zyrë. Doja t'i flisja shumë, por nuk i thashë asnjë fjalë. Nuk mundja. I dhashë një dhuratë të vogël. Nuk donte ta pranonte. E hapa dhuratën dhe që andej nxora një pllakë gramafoni. Ishte "Peshkatarët e Perlave". Ajo nuk e dinte se ai disk ishte kujtimi më i çmuar i jetës sime. Ma kishte dhënë djalli, yt atë, ditën kur ishim njohur. Dhe unë ia dhashë nënës tënde. E pranoi... Që atëherë nuk e pashë më as nënën tënde e as djallin tim. Ika nga ai qytet... Dhe ja ku jam tani para këtij varri... Dua t'i jap këto lule... të parat dhe të fundit që unë i dhuroj atij..."

Iu afrua edhe më vendit të mermertë ku im atë fle në paqe gjumin e madh. Doja ta shoqëroja, por ajo nuk pranoi. Donte të ishin vetëm.


* * *

Kur u ktheva në shtëpi nënën e gjeta të zhytur në kolltukun e saj duke dëgjuar muzikë dhe me një libër në prehër... Si përherë, e qetë dhe pa fjalë, më priti me vështrimin e saj të butë. E përshëndeta me të puthurën e zakonshme. E përqafova një copë herë dhe pastaj vura në gramafonin e vjetër "Peshkatarët e Perlave". Sapo nisën tingujt e parë, ajo mbylli sytë, ndërsa unë nisa të shkruaj këto rreshta...

Akoma me sy të mbyllur është dhe nuk e di nëse ajo po dëgjon muzikën... po fle... apo ka vdekur.

BOTIM I RI/ PËR POROSI


M&B Botime dhe Studio Grafike / Rruga "Isa Boletini", Nd.2, H.12, Nj.Admin.nr9, 1017, Tel. 069 20 68 603 (Viber). Tel. 068 65 08 441 (WhatsApp).
E-mail: mbbotime@gmail.com
Ose përmes rrjetit të Librarive #Adrion, #Bukinisti dhe agjencive të shpërndarjes së librit në Tiranë.



RUTINA PERFEKTE
Tregime të zgjedhura
ARTAN GJYZEL HASANI

Botimet M&B
ISBN ISBN 978-9928-256-86-7
Faqe: 168 / Çmimi: 700 lekë

BOTIME TË TJERA TË KËSAJ SHTËPIE BOTUESE NGA I NJËJTI AUTOR:





botime

“Një jetë për jetën e të tjerëve”

Nga **XHAFER MARTINI**



Ideja për të shkruar një libër për fisin Buci dhe për mikun tim dr. Ramazan Buci ka qenë e hershme, por kjo ide futej nëpër linja të ndryshme arsyetimi dhe mendimi mbrapsej për t’u rishfaqur më vonë dhe për t’u kundërshtuar prapë. Më shumë fitonte peshë mendimi që një monografi nuk është e domosdoshme. Mbase Ramazani ishte nën ndikimin e një thënie të Çehovit, që te njeriu çdo gjë duhet të jetë ose e domosdoshme, ose e mrekullueshme. Por libra të tillë sot nuk mund të shkruhen. Madje, librat më të dobët sot janë monografitë për fiset, të mbushura me lëvdata. Atëherë, përse ta rëndojmë shoqërinë edhe me një libër tjetër si këto? Binim në një mendje se këto libra, në shumicën dërrmuese pa asnjë vlerë, ose me vlera shumë të kufizuara, e kanë diskredituar në një farë mënyre fjalën e shenjtë “libër” dhe po u marrin frymën edhe librave të mirë. Promovimet e këtyre librave ku ata që e merrnin fjalën, e ngrinin në qiell shkruesin, saqë ky i fundit kujtonte se, në mos gjeni, ishte shkrimtar i madh. Këto lavdërime bajate dhe të pasinqerta, pa asnjë përgjegjësi intelektuale, u bënë të neveritshme. Po në këtë kuadër arsyetimi, ka edhe një mendim të kundërt, që konsiston në faktin që nuk e ka fajin monografia si lloj letrar, por mënyra se si shkruhen ato. Shkruesit e tyre e marrin punën kollajshëm.

Në shumicën dërrmuese të rasteve, ata që angazhohen me këtë punë, gjithçka mund të bëheshin, vetëm shkrimtarë jo.

Megjithatë, arsyetoja unë në bisedë me Ramazanin, po të mos shkruhet ky libër për fisin tënd dhe për jetën tënde, pasardhësit e tu, nipërit dhe stërnipërit e shumë breza që do të vinin mbas tyre nuk do të dinin se fisi Buci nuk ka qenë në këto troje mot e dynja, por ka ardhur nga vise të tjera mjaft vonë. Bucet nuk kanë ardhur me makinë dhe me mjete të tjera moderne, nëpër rrugë të asfaltuara, siç udhëtohet sot, por më këmbë dhe të ngarkuar me plaçka; nuk kanë ardhur për një ditë, as për një javë, por për muaj e vite, rrugë pa rrugë, nëpër shtigje malesh dhe humnera, të kërcënuar nga i ftohti i madh dhe i nxehti përvëlues, nga kafshët e egra dhe njerëzit e fiseve dhe viseve të tjera, që ishin armiqësorë me shtegtarët. Pa këtë libër, ata që do të vijnë, nuk do ta dinë se fisi Buci edhe këtu ku është vendosur, nuk është pritur me lule, edhe këtu është ndeshur me një jetë shumë të vështirë, të mundimshme që është përballuar me lodhje dhe vështirësi të shumta; nuk do ta dinin se pikërisht për këtë arsye, mjaft nga fisi Buci janë ngritur edhe prej këtu dhe kanë kërkuar vende më të mira për të jetuar. Kjo është arsyeja që këtë fis sot e gjejmë të përhapur në Fushë Lurë, Vlashej, Arrën, Qafë Murrë, Fushë Alie, Macukull, Lazarat, Gjirokastër, Shkodër, Sarandë, në Greqi, Itali, mbase edhe në vende të tjera.

Megjithatë, ky vend – Mustafet - Fisit Buci i është dukur dhe i duket i shtrenjtë, se këtu janë varret e të parëve, këtu është gjaku dhe djersa e shumë brezave, këtu është nderi, dinjiteti, identiteti që ata i kanë marrë kudo ku kanë shkuar, se këtu është vendi “ku të duket balta më e ëmbël se mjalta”.

Brezat e ardhshëm do të mësojnë se Buci ka lidhur miqësi me shtëpi të para në Çidhën, në Dardhë, në Reç, në Muhurr dhe në vendet e tjera; do të mësojnë si kanë jetuar të parët e tyre, si kanë bërë dasmat e mordet dhe do të çuditen me faktin se në ato kohëra nuk ka pasur lokale për gëzime dhe fatkeqësi familjare, ku gjithçka e gjen gati; ata do të mësojnë se për një dasmë duhet të preokupoheshe tre muaj para për të mbledhur në popull filxhanët e kafesë, tepsitë, kazanët, mutafët, qilimat, sixhadet, lëkurat e gjithçka tjetër që duhej. Por më vështirë ishte për të përballuar morden, që të binte papritur dhe papandehur, pa pyetur për njeriun që të merrte, pa pyetur nëse ishte shkulmi i dimrit apo zhegu i verës, pa pyetur nëse kishe apo nuk kishe bukë në shtëpi... Por të gjitha këto janë përballuar.

Ne themi ta ruajmë traditën në të gjitha shfaqjet e saj, të ruajmë edhe traditën e ndërtimit, ato kullat me gurë të gdhendur dhe dyert e dritaret me blloqe mermeri në vend të shtalkave të drurit. Ata që do të vijnë, nga ky libër do të mësojnë edhe si janë ndërtuar këto kulla si kala, për të cilat janë mobilizuar njëqind burra dhe njëqind kuaj për të sjellë gurët, trarët dhe mermerët nga Prati, dhjetë orë larg vajtje-ardhje. Ne sot mësojmë si janë ndërtuar piramidat e Egjiptit, por nuk dimë si janë ndërtuar kullat tona.

Pa këtë libër, brezat e ardhshëm nuk do ta dinin se të parët e tyre, edhe pse në këtë vend kanë vuajtur shumë dhe kanë hequr shumë, kanë luftuar dhe kanë derdhur gjakun për ta mbrojtur nga çdo invador. Varret e fisit Buci janë kudo nëpër Dibër dhe më larg saj. Ata janë burim krenarie për Bucet sot, por do të jenë akoma më shumë për brezat e ardhshëm. Pa e ditur se nga vjen dhe kush je, nuk din ku do të shkosh dhe cili do të bëhesh.

Prej këtij libri jo vetëm Bucet, por të gjithë, do të mësojnë se një nga fisi i tyre, Ramazan Buci, ka qenë doktor i shkëlqyer dhe organizator i zoti, njeri me humanizëm të thellë, me dashuri dhe përkushtim të jashtëzakonshëm për shëndetin e njeriut për të bërë secilin të lumtur, do të mësojnë se në sajë të aftësisë dhe vullnetit ai arriti të marrë gradën “Doktor” dhe të japë mësim në disa universitete.

Prandaj, ky libër, jo vetëm sipas një linje arsyetimi, por sipas shumë syresh, më duket me vend për t’u shkruar, madje e quaj të domosdoshëm. E, pra, meqë qenka i domosdoshëm, vlen edhe kur nuk është i përsosur.

BOTIM I RI/ PËR POROSI

Botime M&B

Rruga “Isa Boletini”, Nd.2, H.12, Nj.Admin.nr9, 1017, Tel. 069 20 68 603 (Viber). Tel. 068 65 08 441 (WhatsApp). E-mail: mbbotime@gmail.com Ose përmes rrjetit të Librarive #Adrion, #Bukinisti dhe agjencive të shpërndarjes së librit në Tiranë.



SHQIPONJAT - *Roman*
CYZIA ZYKË
Titulli në origjinal:
C. Zykë, Les Aigles
ISBN 978-2-268-03713-4
© 2000 Editions du Rocher
Jean-Paul Bertrand

© 2019 për botimin në shqip
Botimet M&B
Përktheu: Genc Kamberi
Redaktor: ENVER HYSA
ISBN 978-9928-256-76-8
Faqe: 320
Çmimi: 1000 lekë

Është e rëndësishme të njohësh origjinën tënde.

Diktatura paranojake e Enver Hoxhës vonoi takimin tim me tokën ku lindi im atë.

Ishte 1990-a kur për herë të parë shkela tokën shqiptare.

Shqiponjat është një roman.

Personazhet janë të frymëzuar nga persona që kam takuar.

Veprimtaritë e paligjshme që kam përshkruar, kanë ekzistuar.

Të gjitha vazhdojnë të ekzistojnë dhe sot.

Faktet historike që kam përmendur janë të vërteta.

Me Shqiponjat, unë mbyll portën e aventurës sime të gjatë sentimentale me Shqipërinë.

Cizia Zykë

***

Cizia Zykë është aventurieri i fundit i shek. 20-të. Ai vjen si kërkues i arit me librin “Oro”, si kontrabandist me librin “Saharaja”, si gangster me librin “Paradia” dhe si romancier i suksesshëm me librat “Paranoïa”, “Fièvres”, “Alixe”...

Ky njeri u nis në kërkim të rrënjëve të tij: Shqipërisë, Tokës së Shqiponjave. Po takimi me të nuk i eci mbarë. Kur po përfundonte xhirimin e një filmi dokumentar, Cizia Zykë akuzohet për spiunazh dhe kontrabandë veprash arti. I fshehur si refugjat në Ambasadën e Francës në Tiranë, ai u largua me ndihmën e Quay d’Orsay-it.

Shqiponjat janë ata që ai kishte ndeshur gjatë peripecive të tij. Burra të tmerrshëm që një diktaturë e hekurt i kishte bërë si të marrë. Dinoja, ndërmjetësi i mallkuar, Skënderi, vrasësi me buzëqeshje prej engjëlli, Bunki, varfanjaku dhe Dhimitri, financieri i pamëshirshëm.

Shqiponjat janë burrat dhe gratë që gjatë 50 viteve ishin mbyllur në kafaz e që u hodhën në Europë në vitet ‘90.

Shqiponjat janë 3 milionë qytetarë të rrënuar që e plaçkisin vetë vendin e tyre.

Një roman realist e autentik. Katër fate të tmerrshme që dëshmojnë egërsinë dhe vetminë.

Si Shqiponjat. Nga i madhi, shumë i madhi Zykë.

përshtypje

Kujtimit të HIDE KALOSHIT (NDREUT),
vajzës së Elez Isufit.

Hide Kaloshi, profili i një gruaje fisnike

Nga **MIRANDA GOLECI**

Kur punon në një shtëpi botuese dhe librari, pra, kur je rrethuar nga librat, kur merresh gjithë ditën me redaktime dhe korrigjime, e ke të vështirë të orientohesh për të lexuar libra të mirë, që të të nxjerrin nga përditshmëria e mërzitshme.

Megjithatë, unë e bëj këtë duke u nisur nga autorët. Dhe Xhafer Martini është njëri ndër tyre, i cili në orientimin tim letrar është ai të cilit i kushtoj kujdes në lexim dhe në atë që ai përfaqëson për mua apo dhe për shumë lexues, jo vetëm dibranë.


Në librarinë tonë ky autor është i pranishëm me të gjithë librat e tij. Më kishte rënë në sy vazhdimisht libri me titull "Tempulli i dashurisë", në kopertinën e të cilit ishte portreti i një gruaje, me sytë që të vështronin në mënyrë magjepsëse, por përveç kopertinës, nuk kisha mundur ta shfletoj. Gjatë redaktimit të librit "Pedagogjikja – Personalitete", u ndesha me këtë zonjë në kuptimin e mirëfilltë të fjalës, me historinë e saj, madje, e dyzuar nëse autori e kishte përshkruar siç ka qenë apo e ka lartësuar atë më shumë se ç'duhet, ia shpreha dhe autorit këtë shqetësim. Ai më sugjeroi të lexoja librin "Tempulli i dashurisë" dhe do të bindesha akoma më shumë se çfarë përfaqësonte Hide Kaloshi dhe kohën në të cilën ajo kishte jetuar.

Kur fillova ta shfletoj, u ndodha para një të papriture të këndshme: libri më rrëmbeu që në faqet e para dhe nuk e hoqa nga dora derisa e mbarova. Më ka lënë mbresa. Nuk më kishte ndodhur më parë që një libër i këtij zhanri të më tërhiqte aq shumë.

Protagonistja jetësore, njeriu për të cilën shkruhej, rrezatonte dritë dhe mençuri. Në jetë njeriu varet nga këndi që e shikon. Shkrimtari e ka vënë atë në ato pozicione artistike ku ajo lëshon një dritë të butë dhe të këndshme dhe të shkakton shumë emocione njerëzore. Jeta e kësaj gruaje është shumë interesante, edhe pse ka jetuar gjithnjë në zonat më malore të Dibrës, siç janë Sllova dhe Sina. Në tërë pamjen dhe sjelljen e saj ka diçka fisnike, tipike malësore, tipike shqiptare. Jeta e saj kaloi nëpër dy faza: faza e parë, e mrekullueshme e fëmijërisë dhe e rinisë, pastaj faza tragjike e moshës mesatare dhe e pleqërisë. Ajo i bashkon këto faza në një të tërë: atë nuk e hutoi as begatia dhe madhështia e shtëpisë ku lindi, por as nuk e tronditi dhe e rrëzoi tragjizmi i derës ku jetoi. Tiparet më të qenësishme të karakterit të saj janë qëndresa, urtësia, mençuria, bujaria. Nuk besoj të ketë grua tjetër, me jetën e saj, që t'i ketë manifestuar këto cilësi si ajo.

Unë e konsideroj si një fat jetësor dhe artistik që kësaj gruaje i ka kushtuar një monografi shkrimtari Xhafer Martini. Po ua prezantoj: Është fjala për Hide Kaloshin, (Ndreun), e bija e Elez Isufit, gjeneralit me shajak.

Pena mjeshtërore e autorit na njeh shkurt, por saktë, pa asnjë teprim, me dy familjet më të shquara të asaj kohe, me Kaloshët dhe Ndretë. Mbasi kjo gjë bëhet në masën e duhur dhe me mjaft mjeshtëri, flitet për "gjeneralin me shajak", Elez Isufin, për familjen e madhe të Ndreut që kishte tetëdhjetë vetë brenda. Nga këto, rreth pesëmbëdhjetë ishin vasha të mëdha, belikore, që kishin kapur moshën e martesës. Ishte një befasi e këndshme, shumë e këndshme për mua, kur mësova se Elez Isufi, megjithëse shumë i zënë me veprimtarinë e tij atdhetare, gjente kohë dhe kujdesej edhe për edukimin e vajzave të kësaj familjeje, madje jo vetëm të Ndreve, por edhe të fshatarëve të tjerë përreth. Për herë të parë mësova se arsimi në shqip nuk ka filluar me ndonjë shkollë tjetër, por me shkollën femërore të vajzave të Ndreut, shkollë, e cila ishte origjinale, e papërsëritshme, krejt e veçantë, se aty nuk mësohej me libra e me fletore, nuk kishte asnjë mjet mësimi dhe asnjë orendi mësimore; aty nuk shkruhej dhe nuk lexohej. Ajo ishte Shkolla e Fjalëve. E kisha ndeshur edhe më parë nëpër librat e Xhaferit



këtë togfjalësh, por e kisha kuptuar si metaforë. Por nuk ishte metaforë: ishte një shkollë e vërtetë, e një lloji të veçantë, dhe autori nuk e kishte shpikur nga mendja e vet, por e kishte ndeshur në realitet.

Autori i këtij libri, Xhafer Martini, që e ka njohur personalisht Hide Kaloshin, është mahnitur nga dijenitë dhe personaliteti i saj edhe kur ishte në moshë të shtyrë. Ajo mund të recitonte vargje nga Lahuta e Malësisë dhe nga vepra të tjera të Naimit, Pashko Vasos e të tjerë.

Libri është shkruar në vetën e parë, por me vetë të alternuar, me çka duhet kuptuar se një kapitull e "shkruan" vetë Hidja, një kapitull tjetër e shkruan, fjala vjen, një nga vëllezërit e saj, dijetari, Xhelal Ndreu, një e shkruan djali i saj, Fehmi Kaloshi, e kështu me radhë. Kjo i jep veprës larmi dhe bukuri stili, dinamizëm dhe freski. Hidja shikohet nga shumë anë, jepen shumë profile të saj nga njerëzit që e kanë dashur dhe e kanë njohur më mirë. Hidja tregon se Elez Isufi nuk kishte në "oborrin" e tij vetëm Hoxhë Kallën, por edhe njerëz të tjerë të shkolluar fort mirë si Osman Myderizi, Abdulla Çanga, Ismail Strazimiri; tek ai ishin miq të përhershëm burra të shquar të asaj kohe, atdhetarë dhe mendjendriturit, Isa Boletini, Hasan Prishtina, Luigj Gurakuqi, Fan Noli, Islam Spahia, Ahmet Zogu, Hoxha Kadria, Aqif Pashë Elbasani, Seid Najdeni, Mehmet Pashë Deralla, Iljaz Pashë Dibra, për të përmendur vetëm disa prej tyre.

Në këtë mjedis u rrit dhe u edukua Hide Ndreu. Zoti ia kishte falur mendjen dhe bukurinë.

Me punët e shtëpisë nuk merrej vetë Elezi, se ai ishte mik në shtëpi. Merrej i biri, Ceni. Ai kishte në dorë edhe fejesën dhe martesën e vashave të Ndreve. E kërkonin gjithandej Hiden se kishte nur, bukuri dhe hijeshi, kishte dituri më shumë se burri më i ditur, sa vetë Elez Isufi konsultohej me të dhe nuk bënte asnjë punë të rëndësishme pa marrë mendimin e saj. Më në fund, Elezi ia preu Cenit: "Me Hiden mos u merr, do ta fejoj vetë. Bile e kam fejue." "E ku e paske fejue?" – e pyeti Ceni. "Te Selim Kaloshi i Sinës!"

Kur Elez Isufi shpëtoi nga rrethimi që i kishin bërë serbët në kullën e tij, ra poshtë në Dardhë, në shkulmin e dimrit, me gra dhe me fëmijë. Kullave të tij u doli tymi. Ka qenë shumë interesante se si ai shpëtoi nga serbët, se si u iku, "për duarsh", si thuhet, por këtu nuk ka vend për të treguar gjithçka. Familja e tij mbeti jashtë, në cikmën e dimrit të egër. Ai ishte Elez Isufi dhe kishte shumë miq e dashamirë, por nuk ishte kollaj të strehosh tetëdhjetë frymë për një dimër e për më shumë, derisa të bëheshin

Protagonistja jetësore, njeriu për të cilën shkruhej, rrezatonte dritë dhe mençuri. Në jetë njeriu varet nga këndi që e shikon. Shkrimtari e ka vënë atë në ato pozicione artistike ku ajo lëshon një dritë të butë dhe të këndshme dhe të shkakton shumë emocione njerëzore. Jeta e kësaj gruaje është shumë interesante, është ndër më të rrallat gra shqiptare, ani pse një grua që ka jetuar gjithnjë në zonat më malore të Dibrës, siç janë Sllova dhe Sina.

prapë nga themelet kullat në Sllovë. Nuk dihej sa vjet duheshin për t'i ndërtuar prapë. Pastaj, a do ta lejonte serbi një gjë të tillë, se ja, ai ishte maleve. Ndërsa fjalëtorët e tij po ktheheshin të mërzitur, sepse miku tek i cili i kishte adresuar Elez Isufi, nuk e kishte mbajtur barrën e rëndë, u doli në rrugë një djalë i ri, njëzetvjeçar, që i pyet: "Çfarë halli u paska nxjerrë në këtë shkulm dimri?". Ata ia tregojnë. Selim Kaloshi, pa u menduar fare, u thotë: "T'i bani selam Elez Isufit, që, me bukë e me groshë, siç ha vetë e robt' e mi, e mbaj familjen e tij jo nji dimën, por disa dimna". Dhe Elezi atij ia shkarkoi familjen në derë. Midis njerëzve të shtëpisë ishte edhe Hidja, atëherë katërmbëdhjetë vjeç, që sapo kishte "lulëzuar". Sa bukur i jep shkrimtari Martini këto marrëdhënie! Ai zgjon parandjenja njerëzore. Për këtë arsye, Elez Isufi e bëri dhëndër Selim Kaloshin e Sinës.

Ngjarjet rrjedhin dhe erdhi lufta nacionalçlirimtare. Ndretë u bënë me komunizmin. Vatra e komunizmit në Dibër ishte Ndreu. Dali Ndreu, djali i Isuf Xhelilit, u bë gjeneral, Esat Ndreu, kolonel; të gjithë Ndretë mendonin se i pret një e ardhme e ndritur: kishin qenë dhe do të ishin. Kishin qenë të fortë dhe pasanikë, do të bëheshin më të fortë dhe më pasanikë. Por Hidja e kishte zemrën akull. Ajo nuk u besonte komunistëve. Nuk mund të donin komunistët pasardhësit e Elez Isufit, i cili ishte shpallur "gjenerali me shajak" nga populli i Dibrës pikërisht për luftërat heroike që kishte bërë kundër forcave serbe dhe jugosllave. Zemra e Hides ishte e ndjeshme, intuita e saj ishte e jashtëzakonshme. Kur Dali Ndreu kaloi me brigadën e tij nga Sina, në dimrin e vitit 1943, gjeti rastin të shkonte te Hidja dhe të bisedonte me të vetëm për vetëm. Kur po e përcillte, Hidja i tha: "Or Dali, nuk asht rruga jote kjo." "Si nuk qenka rruga ime, oj Hide. Jam gjeneral. Kam luftue për këtë ditë". "Lufto sa të duesh, or Dali, je i biri i Sufë Xhelilit, që ka vrarë me qindra serbë. Nuk mund të ulet serbi në një sofër me ty!". Por Daliu nuk e dëgjoi dhe e gjeti ajo që e gjeti: Enveri e pushkatoi me gjithë grua, e cila qe shtatzënë.

Cen Elezi u kujtua vonë që ishte i biri i Elez Isufit. Doli në mal së bashku me djemtë dhe nipat. Po ku të shkonte? Ishte i rrethuar nga të katër anët. Komunistët, megjithëse e ndiqnin natë-ditë për ta futur në dorë, nuk ia arritën: ishte dhelpër dhe luan Ceni. Një natë para se ta ndante mendjen për ta lënë atdhenë, ishte mik te Hidja. Kjo i tha:

- Or Cen, e shikoj se e ke nda mendjen me hikun, por nga do të dalësh?

- Nga dilet, oj Hide. Nga Korabi.

- Nuk ka dalje nga Korabi për të birin e Elez Isufit.

- Jam marrë vesh, oj Hide. Mos kij merak. Nuk janë ma ato kohna. Tani jugosllavët janë prishur me Enverin dhe mua do më pranojnë si kundërshtar të tij.

Vërtet Ceni kishte dërguar njerëz në Jugosllavi, kishin rënë dakord që ai të dilte matanë dhe të trajtohej si refugjat politik, si kundërshtar i rreptë i Enver Hoxhës ndaj të cilit, me gjithë djem e nipa, kishte vite që po luftonte.

- Nuk ka besë serbi, o Cen, - i tha Hidja.

Po Ceni i zuri besë serbit dhe tani dihet se atë e lanë të vdiste nga uria në kalanë e Shkupit.

Në këtë monografi Hidja jepet në shumë plane, ndësa Selimi, bashkëshorti i saj jepet me shumë në procesin e gjykimit që iu bë atij.

I doli borxhit Hidja edhe të shoqit, Selimit. Atë e arrestuan dhe e dërguan në Peshkopi, ku e mbajtën gjashtë muaj në hetuesi. E lëshuan për mungesë provash, se Selimi, në fakt, nuk kishte bërë asgjë kundër partizanëve. Hidja i tha:

- Mos u beso komunistëve se do të vijnë prapë të të marrin.

- Ishte akuzë e rreme, oj Hide. Më kishin ngatërrue me Selim Kaloshin e Kandrit, prandaj më lëshuen.

Selim Kaloshi i Kandrit kishte qenë me Halil Alinë në Gjorm të Vlorës gjatë ekspeditës së dhjetorit 1942 – janarit 1943. Ai kishte vdekur nga vdekje e natyrshme, pak para se të çlirohej vendi nga partizanët. Tani ndaj tij nuk kishin si të hakmerreshin dhe ja ku ishte ky Selimi tjetër. Por si mund të ngatërroheshin dy Selimat, pse kishin të përbashkët vetëm mbiemrin, si mund të ngatërroheshin ata që i njihte gjithë Dibra? E tregonin dallimin edhe pasaportat dhe plot dokumente të tjera. Po Selim Sul Kaloshin e kapën dhe i bënë po atë akuzë: "Ke qenë në Vlorë me Halil Alinë!".

"Do t'ju nxjerr dëshmitarë krejt Dibrën që jam Selim Sul Kaloshi nga Sina dhe jo Selim Xhetan Kaloshi nga Kandri, që ka vdekur vetiu. Do t'ju tregoj edhe varrin e tij. Kjo është një akuzë krejt e rremë dhe pa kuptim."

Po anëtarët e gjyqit dhe të gjithë ata që e kishin shkruar skenarin, e dinin të vërtetën: e dinin që ai ishte Selim Sul Kaloshi i Sinës. Ai i si i tillë do të dënohej dhe do të pushkatohej, nuk kishte fare rëndësi pse nuk kishte qenë në Vlorë. Akuza është tjetër gjë: në akuzë ashtu do të shkruhej se pushkatohej pse ka qenë në Gjorm të Vlorës.

Pastaj filluan dënimet dhe pushkatimet me radhë të të gjithë Kaloshëve dhe Ndreve. Esat Ndreun e kishin zhveshur dhe e kishin internuar si gjithë Ndretë e tjerë në Vlorë. Ja si e kujton Esati Hiden:

"Hidja nuk ishte prej atyne njerëzve që, pse na kishte paralajmërue të mos u zinim besë komunistëve, të na thoshte: "Hë, u doli fjala ime!" Ishte Hidja që na u ndodh të gjithëve. Ishte Hidja ajo që vinte dhe na shikonte atje, në skëterrën ku na kishte katandisur Enveri. Më kujtohet vitit 1960. Hidja erdhi në Vlorë dhe na gjeti të rrasur në disa barraka. Sa erdhi Hidja e derisa shkoi, na grumbulloi bashkë dhe kemi ndejt rreth Hides si zogjtë nën fletët e klloçkës. Edhe në atë skëterrë njerëzore për ne ishte kënaqësi e madhe kur vinte nata dhe grumbulloheshim të gjithë rreth zjarrit me burra, me gra, me fëmijë dhe dëgjonim zanin e ambël dhe fjalën melhem të Hides, që na jepte zemër dhe na lutej të kishim besim te Zoti."

Një natë para se ajo të ikte për në Dibër, Esati e pyeti:

- Oj Hide, çfarë ke thanë, të ka dalë deri më tani. Tani na thuej hapun: a do të marrë fund ndonjiherë kjo e keqe që na ka gjetun? A do të ketë edhe për ne ditë lirie?A do të dalim gjallë prej ferrit komunist apo do të shuhemi këtu?

- Do të dilni, o Esat, do të dilni. Zoti kërkujt nuk ia ka lanë përherë, nuk do t'ia lajë as Enver Hoxhës. Të rinjtë kanë me e mbrritun atë ditë, po ene ne të vjetrit do ta mbërrijmë.

- Domethanë qenka afër ajo ditë, oj Hide!

- Afër, o Esat, por durim e forcë me besue, me jetue.

...

Fort afër ajo ditë nuk qe, se u deshën të kalojnë edhe tridhjetë vjet që të shembej diktatura dhe të vinte Liria. Për fat të keq, Hidja nuk e mbërriti vetë atë ditë. Vdiq në vitin 1989, pak muaj para se të vinte Liria!

Për Hiden këto janë fare pak fjalë në krahasim me bëmat e saj. Në qoftë se ju, lexues të dashur, doni të lexoni me të vërtetë një libër që do t'u japë kënaqësi dhe prej të cilit do të mësoni, ky është "Tempulli i dashurisë" i autorit Xhafer Martini.

Manushaqe Shehu, e vetmja grua shqiptare Gjeneral Brigade në drejtimin e FA-së

Nga **HALIL RAMA**

Gjeneral Brigade Manushaqe Shehu, është e vetmja grua shqiptare që mban këtë gradë. Numri dy i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Shqipërisë (Nga data 16 janar 2018 e në vijim kryen detyrën e Zëvendësshefit të SHP të FA) vjen në këtë funksion mjaftë të rëndësishëm pas një karriere të shkëlqyer në të gjitha nivelet e Ushtrisë Shqiptare.

Veçanërisht, dibranët krenohet me profilin e vajzës së tyre, doktore e shkencave, gjeneral dhe juriste. Mbi të gjitha tek ajo spikasin vlerat njerëzore. Personaliteti dhe karakteri i saj në asnjë rast nuk devijoi, por u shpalos me dinjitet për më shumë se tri dekada në funksion të zhvillimit dhe modernizimit të Forcave tona të Armatosura. Ishte nga të parët që i fali shpirtin dhe zemrën ëndrrës së dëshiruar në vite. Në këtë përditshmëri ajo mbetet një nga figurat më interesante si përfaqësuese e elitës intelektuale shqiptare.

Si njohëse në mënyrë perfekte e dy gjuhëve të huaja (anglisht dhe italisht), dr. Manushaqe Shehu, ka përfunduar kursin e CIMIC në Qendrën P&P, Ankara, Turqi (mars - prill 2013), Kursin Gender Perspective in Peasekeeping Operations në Zagreb, Kroaci,(qershor 2014), studimet për CIMIC&CIMI Oberamengau, Gjermani (shtator - tetor 2015), Kursin "Lufta kundër trafikimit të qenieve njerëzore" në Qendrën P&P, Ankara, Turqi (maj 2016), Kursin e Lidershipit Strategjik, Budva, Mal i Zi (shtator 2016), Kursin e Sigurisë në "Qendra Marshall", Garmish, Gjermani (korrik - shtator 2017) si dhe kursin "Billding Integrity" në Mbretërinë e Bashkuar (Tetor 2017). Në muajin gusht 2018 në mbrojtje të temës "Lidershipi dhe ndikimi i tij në menaxhimin e mjedisit të sigurisë. Rasti i Ballkanit e më gjerë", fiton gradën shkencore "Doktor". Ajo ka botuar një sërë artikujsh shkencorë dhe joshkencor brenda e jashtë vendit, në Revista Ushtarake, në shtypin ushtarak e civil. Po ashtu ka marrë pjesë në disa aktivitete ushtarake ndërkombëtare në vendet anëtare të NATO-s dhe ato partnere të saj.

Dhe jo vetëm kaq, si intelektuale bashkëkohore demokracinë e konsideronte sfidë



Është dekoruar me urdhra e medalje të ndryshme nga Ministri i Mbrojtjes dhe Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, si dhe medalje të tjera e Çertifikata si "Sportiste e dalluar", "Në ndihmë të popullsisë në donacione të ndryshme", "Aktiviste e zbatimit të rezolutës 1325".

Gjeneral Brigade Manushaqe Shehu, është e vetmja grua shqiptare që mban këtë gradë.

ndaj sistemit që u shemb; sfidë në dinjitet, në vlerë, në përpjekje, në arritje. Thelbi i mendimit dhe veprimit të saj ishte vetëm konkurrenca në vlera. Ajo besoi dhe dëshmoi se njeriun në jetë e mban vetëm dija. Një miqësi me dijen nuk ka moshë, por mbetet e përjetshme. E qetë, e pjekur, shumë e kulturuar nuk pajtohej me asnjë devijim nga parimet e virtytshme dhe njerëzore, por mbante qëndrim. Shpërthyese dhe autoritare në ndëshkimin e saj individual, sepse përherë qëndronte në vendin e nderit, sinqeritetit dhe dinjitetit. Kuptohet ajo ishte dhe është individ dhe jo institucion, por idetë dhe praktika e saj mund t'i shërbenin dhe i shërbejnë shumë një institucioni, një misioni. Këto cilësi i manifestoi dukshëm si drejtuese në disa nivele të Ushtrisë Shqiptare, deri në majën e piramidës së saj, si Zëvendësshefe e SHP të FA të RSH-së.

KUSH ËSHTË MANUSHAQE SHEHU

Ka lindur në Peshkopi më 5 nëntor të vitit 1965. Pas përfundimit të studimeve në Akademinë e Lartë të Oficerëve në Tiranë në vitin 1984 - 1988, emërohet Shefe e Logjistikës në Brigadën 3900, Peshkopi. Gjatë viteve 1989 - 1994, përfundon Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Shkodrës. Në vitin 1991 merr gradën Kapiten i Parë. Nga viti 1989 - 1996, kryen disa detyra të ndryshme në Logjistikë si itendente batalioni, shefe e shërbimeve të ndryshme logjistike për ushqimin, veshmbathjen, karburantin e kazermimin në brigadë, deri shefe e Logjistikës e Divizionit 1100, Shkodër. Në vitin 1996 emërohet Specialiste e Kontrollit Financiar dhe Rezervave të Paprekshme në Ministrinë e Mbrojtjes. Këtë detyrë e mban deri në mars të vitit 2000. Gjatë viteve 2000 - 2002 punon në ekipin amerikan të Departamentit të Mbrojtjes të SHBA, pranë Ministrisë së Mbrojtjes, si përkthyese, njëkohësisht kryen studime pasuniversitare (Kursin Themelor të Oficerit në SHPFA dhe Kursin e Funksioneve) në Akademinë e Mbrojtjes, Tiranë.

Në vitin 2003 merr gradën Major dhe emërohet Shefe e Shërbimit të Ushqimit në FA, detyrë që e mban deri në vitin 2004. Gjatë kësaj periudhe, ka qenë nismëtare e disa projekteve të ristrukturimit të FA dhe anëtare e Bordit të Kompanisë Amerikane SAIC "për ndryshimin e strukturave të FA", si dhe anëtare e bordeve drejtuese të ndryshimit të disa rregulloreve të ndryshme për Logjistikën në FA. Drejtuese e Bordit të Ndryshimit të Normave të Ushqimit dhe Veshmbathjes e Kazermimit në FA. Në vitet 2004 - 2005 përfundon ADAMS P&P (shkollë logjistike) në Tur, Francë dhe Akademinë e Shtabit të Përgjithshëm "Spiro Moisiu", Tiranë. Në vitin 2006 mer gradën Nënkolonel dhe emërohet Shefe e Furnizimit të FA dhe në vitin 2007, Shefe e Protokollit të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA.

Më 8 tetor 2007 emërohet Ndihmëse e Presidentit të Republikës për Çështjet Ushtarake dhe Integrimin Euroatlantik. Gjatë kësaj periudhe, përfundon studimet në Kolegjin e Lartë Rajonal të Sigurisë dhe të Mbrojtjes, Tiranë.

Në vitin 2010 përfundon Master Shkencor të Nivelit të Dytë (MND) në fushën Sigurisë Kombëtare dhe merr gradën "Kolonel".

Më 4 shkurt 2011 emërohet Këshilltare Ushtarake e Presidentit të Republikës.

Me 1 shtator 2012 emërohet Drejtoreshë e Bashkëpunimit Civil - Ushtarak në Ministrinë e Mbrojtjes.

PJESËMARRËSE NË STËRVITJE TË PËRBASHKËTA ME VENDE ANËTARE TË NATO-S

Gjeneral Brigade Manushaqe Shehu ka qenë pjesëmarrëse në stërvitje të përbashkëta me vende anëtare të NATO-s, aktiviste dhe drejtuese e nismave në ndihmë të grave ushtarake e civile të FA dhe të rajonit. Gjatë karrierës së saj, ka qenë nismëtare e një sërë projektesh të përbashkëta civilo-ushtarake kombëtare dhe ndërkombëtare, ku një vend të veçantë zënë projektet për barazinë gjinore, për të cilat ka marrë mirënjohje dhe falënderime nga organizatat kombëtare dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, por edhe nga shoqëria civile e strukturat e tjera të kontrollit civil në Forcat e Armatosura.

Më 1 nëntor 2016 emërohet Komandante e Akademisë së Nënoficerëve.

Më 14 nëntor 2016 gradohet "Gjeneral Brigade", e para ushtarake femër në historinë e Republikës së Shqipërisë që merr këtë gradë.

Më 1 dhjetor 2016 emërohet në detyrën e Komandantit të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes.

Gjeneral Brigade Manushaqe Shehu është e martuar dhe ka dy fëmijë, një vajzë e një djalë.

Shpërthyese dhe autoritare në ndëshkimin e saj individual, sepse përherë qëndronte në vendin e nderit, sinqeritetit dhe dinjitetit. Kuptohet ajo ishte dhe është individ dhe jo institucion, por idetë dhe praktika e saj mund t'i shërbenin dhe i shërbejnë shumë një institucioni, një misioni. Këto cilësi i manifestoi dukshëm si drejtuese në disa nivele të Ushtrisë Shqiptare, deri në majën e piramidës së saj, si Zëvendësshefe e SHP të FA të RSH-së.



Bëj pajtimin tënd me

PayPal

përmes emailit
<rrugaearberit@gmail.com>

Një pajtim vjetor kushton:
Në Shqipëri: 600 lekë.
Në Europë: 10 Euro.
Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.

Pajtimi në Europë dhe SHBA
është vetëm në versionin PDF.

Dy martirë të lirisë - Ali Pustina i Dibrës së Madhe dhe Haxhi Mehmet Alcani i Çermenikës

Nga **AVNI ALCANI**

Ali Pustina nga Dibra e Madhe ka qenë i njohur si organizator dhepjesëmarrës i kryengritjeveantiosmane dhe antiserbe të zhvilluara në fillim të shekullit të 20-të në trevat e Dibrës, Çermenikës dhe Gollobordës.Aliu ka lindur në vitin1885 në familjen e njohur Pustina të parisë së Dibrës së Madhe.Babai i tij, Nuredin (Nurçe) Pustina ishtenjë figurë e njohur dhe prijësi kryengritjeve antiosmane në trevat e Dibrës dhe më gjërë.

Ali Pustina ishte antar i Klubit atdhetar "Bashkimi Dibran",i themeluar në Dibër më 26 dhjetor 1908, i cili synonte mbështetjen dhe përhapjen e kulturës, gjuhës shqipe, si dhe organizimin e një kryengritje të armatosur antiosmane, me qëllim zgjimin e ndjenjave kombëtare, mbrojtjen e gjuhës dhe kulturës shqiptare, si rezistencë ndaj pushtimit të gjatë shumëshekullor otoman.(H. Stërmilli: *"Dibra në prag të historisë"*, Tiranë 1940).

Në vitin 1908, gjenerali turk Durgut Pasha, ishte dërguar në Shqipëri për çarmatimin e kryengritësve dibranë. Me të mbërritur në Dibërtë Madhe, Pashai turkurdhëroi menjëherë burgimin e parisë sëqytetit. Një nga të ndaluarit ishte Ali Pustina, i cili ishte iakuzuar nga turqit se bënte propagandë kombëtare, përhapte libra shqip dhe armatoste popullinme armë(T. Toçi: Revista *"Shqiponja Arbnore"*, 1943).Pas arrestimit, Aliu u dënua me vdekje.

Terenc Toçi(1880 - 1945), shkrimtar dhe publicist i njohur me origjinë arbëreshedheish-Sekretar i Përgjithshëm i Kryeministrisë në periudhën e Monarkisë së Mbretit Zog I, nërevistën e botuar prej tij,"Shqiponja Arbnore", ka përshkruar një episod interesant, i ndodhur mesAli Pustinës dhe Durgut Pashës,që flet për zgjuarsinë,qëndrimin heroik dhe karakterin krenar tëdibranit trim:*"Durguti*, - shkruan Toçi, - *para se të vërtetonte dënimin e të urdhënonte vdekjen e Pustinës, e thirri të dënuarin i cili ishte mveshun me teshat kombëtare dhe mbante mbi kokë fesin e bardhë shtrembtas, gati tuj mbulue njërin sy. Ay e kqyri pak gati me nënqeshje, por mandej ia plasi: "E qysh guxon ti or dreq, me u paraqit para mejet me ksulën mbi sy?" Pustina me një gjak të ftohtë të çuditshëm u gjegj: "A keni punë me mue, a me ksulën time". E tuj kenë se Pasha i idhnuem i urdhnoj rreptësisht me e hjek kësulën, i dënuari ja priti: "Asht zakon i shqiptarëve me e mbajt në këtë mënyrë kësulën, e prandaj kjo kësulë ka me ndërrue vënd kur ka me u rrzue koka ime". Durgutit… i bani përshtypje tërheqëse guximi* përbuzës i një njeriu që ishte mbi prakun e vdekjes, dijti pastaj me e mbajtë hidhërimin, i ra me dorën e djathtë mbi shpatulla Pustinës dhe i tha: *"Mbaje si të duash, or arnaut, kësulën tënde. Sjellja jote është e një njeriu të egër, por tregon trimni, prandaj un po të fal jetën e të çoj në Anadoll, n'internim të përjetshëm".*(Toçi, 1943).Dyditë pasi Pustina ishte nisurnë internim nën një ruajtje të fortë, shkruan Toçi. Në rrugën ndërmjet Strugës e Dibrës së Madhe, me një *"dhelpëni malsorësh"*,Aliu u iku ushtarëve dhe doli në mal. Pas kësaj Durgut Pasha ia dogji shtëpinë dhe ia internoi familjen në Manastir(Toçi, 1943).Pas arratisjes nga taborri i Turgut Pashës, Aliu strehohet në Neshtë, në shtëpinëe mikun e tij Haxhi Mehmet efendiut, ku qëndroi rreth 4-5 vjet (Almeta, 2004).

Në qytetin e Dibrës së Madhe ushtronte detyrën e tij si klerik i fesë myslimane (hoxhë) Haxhi Mehmet Alcani (1860-1915) nga Neshta e Çermenikës, Ali Pustina ishte njohur me klerikun Haxhi Mehmet Alcani, me të cilin kishin qenë të lidhur me një miqësi të ngushtë familjare.Haxhi Mehmet efendiu zhvillonte në fshehtësi një aktivitet të rëndësishëm patriotik.Ai ishte antar i Klubit patriotik "Besa" të Dibrës së Madhe dhe antar i Komitetit të Fshehtë të këtij qyteti.Në vitin 1909 Nuredin Pustina me djalin dhe të afërmit e fisit të tij, Sefedin Pustina, Shaqir Pustina, Ali Nuredin Pustina, Ibrahim Pustina, si dhe miku i familjes, Haxhi Mehmet efendiu, zgjidhen delegatë në Kongresin e Dibrës, të cilin atdhetarët shqiptarë e shndëruan në një arenë për mbrojtjen e të drejtave kombëtare të popullit shqiptar dhe të luftës kundër reaksionit xhonturk (F. Daci: *Pesë vilajetet drejt Dibrës së Madhe të Kongresit"*, Gazeta "Republika", datë 15.05.2009; Xh. Almeta: *"Çermenika-1. Përmbledhje studimesh"*, 2004, faqe 35-36).

Në prag të Luftës së Parë Botorore (1912), kur disa krahina të Shqipërisë verilindore po kërcënoheshin të pushtoheshin nga ushtria serbe,Ali Pustina dhe Mehmet efendiu organizuan së bashku në krahinat e Çermenikës dhe Gollobordës rezistencën antiserbe. Me inisiativën e Haxhi Mehmetit u organizua në Lunik,në shtëpinë e Tales, një takim shumë i rëndësishëm, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të disa fshatrave të Çermenikës dhe Dibrës, si H. Mehmet Alcani (Neshtë), Ali Pustina (Dibër), Destan Leka e Murat Kaca (Zdrajsh), Mustafa Shera e Xhelë Gjata (Prevall), Selman Albrahimi (Lunik), Hoxhë Moglica e Ethem Hasa (Llangë-Dibër) etj., meqëllimi shfuqizimine administratës turke në Shqipëri dhe organizimin e rezistencës luftarake kundër pushtimit serb (Alcani, Cysa: *"Neshta e Çermenikës"*, 2018, faqe 58).

Mbi 20 mijë forca serbe, nën komandën e gjeneralit Matoviç, u futën nëpërmjet trevave të Dibrës dhe Strugës për në territoret e Shqipërisë verilindore dhe qendrore. Haxhi Mehmet Alcani dhe Ali Pustina u bënë thirrje burrave të Çermenikës, Martaneshit dhe Gollobordës përmbrojtjen e trojeve të tyre dhe zhvillimin e luftëssë armatosur kundër pushtuesit serb. Nga Çermenika u mobilizuan mbi 300 burra të armatosur, të cilët u nisën në drejtim të Përrenjasit e Qukësit, për t'i dalë përpara ushtrisë serbe(Alcani, Cysa: 2018).

Ali Pustina kishte organizuar malësorët e Gollobordëskundër serbëve.Në vitin 1915, gjatë luftimevenë fshatin Okshtun të krahinës së Gollobordës,Ali Pustinau vra.Në lidhje me vrasjen e tij, Luan Pustina, nipi i Aliut, shkruan: *"Ali Pustinën e vranë në pabesi ushtarët serbë*, të cilët hapën fjalë se do ta çonin për ta gjykuar për kryengritjet që kishte bërë kundër Qeverisë serbe. Rrugës, në të dalë të fshatit, ata e vranë dhe e lanë ashtu të shtrirë të pakallur në dhe.Pasi lajmi i vrasjes së tij mori dhenë, erdhën fshatarët e Okshtunit të cilët e morën kufomën e tij dhe e varrosën aty ku u vra, pak hapa më poshtë rrugës këmbësore që të shpie në Okshtunin e Madh".Lajmi i vdekjes së Aliut, shkruan nipi Pustina, u çua që atë ditë në qytetin e Dibrës së Madhe, por autoritetet serbe nuk e lejuan familjen e tij që të hapte mortin në shtëpinë e tyre. Pas këtij urdhëri familja dhe të afërmit u mblodhën fshehurazi dhe e qanë atë në fshatin Kllopçisht, por dhe aty gratë nuk mundën ta qanin dot sipas zakonit,pasi ishin nën survejimin e autoriteteve serbe.*"Pasi u krye ceremonia e varrimit të Aliut*, - shkruan L. Pustina, - *okshtunasi Ram Hoxha, i rregulloi varrin dhe mbi të shkroi një epitaf*, në të cilin thuhet: *"Jam Ali Pustina nga Dibra e Madhe. Vëllezër o trima, kam një lutje të madhe, këtej kur të kaloni, ju lutem udhëtar, vëllezër o shqiptar, shpirtin të ma gëzoni, fatiha këndoni, Barbarit të Serbisë mallkime t'i thoni"*.

Fshati Okshtun e quante varrin e Aliut si"varr të mirë" dhe fshatarët shkonin atje për pelegrinazh.Për të përjetësuar emrin e A. Pustinësnë kujtesën e banorëve të asaj treve, Hysen Kodra (babai i dëshmorit Siri Kodra) i vuri një shkolle fshati në krahinën e Gollobordësemrin "Ali Pustina",i cili ishte njëvlerësimilartë që banorët e Okshtunit të krahinës së Gollobordës i bënë Ali Pustinës. Pas vdekjes së Ali Pustinës dhe pushtimit të qytetit të Dibrës së Madhe nga ushtria serbe, familja Pustina, për t'i shpëtuar përndjekjeve të regjimit serb, u shpërngulën nga Dibra dhe u vendosën në qytetin e Tiranës, ku jetojnë ende edhe sot e kësaj dite.

Në maj të vitit 1915, Haxhi Mehmeti u gjend përkrah luftëtarëve çermenikas, martaneshas, shëngjergjas dhe stërblevas. Ai mori pjesë me armë në dorë në luftimet kundër serbëve në Qafën e Prevallit.Ata u ndeshën trup me trup me armiqtë, në një betejë të përgjakshme e të pabarabartë. Gjatë luftimeveHaxhi Mehmeti u plagos rëndë. Ai kapet rob nga forcat serbe, të cilët e dërgojnë në shtabin e tyre.Ushtarakët e lartë serbë i kërkuan Haxhi Mehmetit t'iu bënte thirrje çermenikasve për ta pushuar luftën, që serbët t'a kishin më të lehtë të depërtonin në Elbasan dhe Tiranë.Haxhi Mehmeti nuk pranoi.Serbët e torturuan në mënyrë çnjerëzore, deri sa vdiq (Almeta,2004). Banorët e fshatrave Prevall dhe Lunik e varrosën në "Qaf'të Pravallit" dhe ai vend edhe sot quhet "Vorri i Hoxhës". Pasardhësit e H. Mehmet Alcanit, pas kërkimeve të shumta ndër vite, identifikuan vendin ku ishte varrosur gjyshi i tyre.

Komisioni Qendror i Statusit të Dëshmorëve të Atdheut, me Vendimin Nr. 662, datë 27.06.2013, e shpalli Mehmet Sali Alcanin "Dëshmor i Atdheut".Më 30 maj 2019, Qarku i Elbasanit dhe Bashkia e Librazhdit,organizuan ceremoninë e rivarrimit të eshtrave të Deshmorit të Atdheut, Haxhi Mehmet Alcani, të cilat u vendosën për t'u prehur përjetësisht në Varrezat e Dëshmorëve të qytetit të Librazhdit.

Kur do të shpallet Dëshmor i Atdheut martiri dibran i Lirisë Ali Pustina?



Ali Pustina



Haxhi Mehmet Alcani



Ali Pustina dhe Haxhi Mehmet Alcani



Delegatë të Kongresit të Dibrës (1909).

Ndrec Molla – një jetë në shërbim të popullit



Kur gjendesh në rrethin e Mirditës dhe kërkon të njohësh e të mësosh nga historia e lashtë e në vijimësi, bashkëbiseduesi yt menjëherë, në krye rendit fshatin Malaj. Ky fshat me histori të lashtë e sidomos për kulturën e hershme mesjetare shqiptare ka shërbyer si një pikë referimi ku mbështetet edhe historia e arkeologjisë kombëtare shqiptare. Edhe në periudhat e mëvonshme të mesjetës, deri në ditët tona, ky fshat flet për shumë bëma të lavdishme dhe ka rezervuar pa ndërprerje atdhetarizëm, patriotizëm dhe veprimtari dobiprurëse, për mbarë shoqërinë. Çdo individ, familje, fis e fshat ka historinë e bukur të tij dhe të gjithë së bashku plotësojnë tabllonë e një kulture e historie të lavdishme.

Në këto grupime bën pjesë edhe familja e Preng Ndrec Mollës, e dëgjuar në krahinën e Mirditës. Nga gjiri i saj doli edhe biri i nderuar i Prengës, Ndrec Molla, i cili në vitet e punës e të jetës së tij, ende edhe sot ka lënë një emër për t'u respektuar, për nga kontributet e tij në dobi të zhvillimeve social-ekonomike, kulturore dhe shoqërore. Ndreca u lind më 13 korrik 1933 dhe qe i dyti në radhë, pas vëllait Ndues dhe në vijim erdhën tri motrat radhazi, respektivisht Marta, Prena dhe Dava. Ikja e shpejtë nga jeta e të vëllait, Ndueja 38-vjeçar, për Ndrecën solli përgjegjësinë ndaj familjes edhe si kryefamiljar që i përballoi e i zgjidhi me sukses. Mësimet fillore i kreu në fshatin e tij, Malaj, ndërsa shkollën 7-vjeçare (sot 9-vjeçare) i përfundoi në qytezën e bukur të Rubikut, po me rezultate shumë të mira. Babai, Prenga, dëshironte të arsimonte në nivelin më lart, djalin, por problemet ekonomike nuk ia mundësuan një gjë të tillë.

Pavarësisht kësaj, nevoja e vendit për kuadro dhe specialist të ndryshëm sa më të shumtë e më të shpejtë me cikle të shkurtra kualifikimi, bëri që Ndreca të ndjekë një kurs një vjeçar për infermier në Vlorë, të cilin e përfundoi në vitin 1951. Më pas e plotësoi me kualifikimin e mëtejshëm të tij në shkollën mjeksore 3-vjeçare në Shkodër, duke bërë që profesionalisht të aftësohej në këtë lloj shërbimi. Detyra e infermierit, Ndrecës i dha mundësinë të shërbente në shumë fshatra të Matit e të Mirditës, respektivisht në spitalin e Rubikut, në ambulancën e Shën Palit, në Gjegjan të Pukës, në Perlat etj. Edhe shërbimin ushtarak të detyrueshëm e kreu po në detyrën e infermierit në rrethin e Elbasanit. Pas lirimit nga ushtria punoi po në detyrën e infermierit në disa vende si në Tiranë, në Lurë të Dibrës, në Mbas Dejë (Macukull) e Qafshtamë të Matit, në Orosh e Bulshar të Mirditës. Në vitet 1965 – 1967, për dy vjet punoi në spitalin e Rrëshenit në repartin e pediatrisë, kirurgjisë dhe pathollogjisë. Ndërsa periudha 1967 – 1993, për 26 vjet qe më e bukura e jetës së tij, sepse iu shërbeu bashkëfshatarëve të tij në fshatin Malaj të Mirditës, ku aty dhe doli në pension pleqërie. Këto lëvizje pune, në shumë vende i dhanë Ndrecës një avantazh, ngaqë u njoh me shumë njerëz shumë të mirë, por dhe në nevojë, që iu shërbeu me profesionalizëm e me dëshirë e devocion të lartë, nga ku në marrdhënie të sinqerta me to, mori një kulturë më të gjerë qytetare, të cilën njëkohësisht e rrezatoi edhe në përmbajtjen e shërbimit profesional të tij, saqë në opinionin e gjerë thirrej: "Doktor Ndreca". Por për shkak dhe të biografisë nga i ati, Prenga, i cili kishte qenë dhe kishte shërbyer në Oborrin Mbretëror si Adjutant, midis viteve 1932 – 1939, politikisht i rënduan shumë. Familjarisht nga viti 1939 deri në vitin 1945, qëndroi në Prizren. Vdekja e babait, Prengës në vitin 1947, me helmim nga organet e sigurimit të shtetit që e trondit shumë shpirtin e Ndrecës. Sikur të mos mjaftonte kjo, edhe e ëma e tij Dila, e bija e Ndue Nikollit nga Gëziqi i Mirditës, në vitin 1948 burgoset me akuzën se "iu kishte dhënë bukë të arratisurve të malit". Kjo akuzë i rëndoi edhe vëllait, Ndues, por dhe vetë Ndrecës, i ndodhi në vitin 1954, po me këtë akuzë si dhe nëna e tij. Këto akuza ranë pas një viti, nga ku nisi përsëri jeta e tij si më parë.

Gjatë kohës në punë e në jetë, për gati 42 vite, Ndrec Molla është karakterizuar nga disiplina e lartë dhe nga përkushtimi i madh në punë, nga sjellja e ndershme dhe me kulturë, nga humanizmi i pashoq i tij shumë dimensional. Kjo edhe për faktin se profesioni i tij ishte i lidhur me jetën e njerëzve kundër sëmundjeve vdekjeprurëse në ato vende ku ai shërbeu.

Jo vetëm kaq, Ndrec Molla ka qenë dhe është edhe një familjar e prind shembullor. Pasi krijoi familjen e tij, me zonjën Dila, e bija e Ndre Gjon Lekgegës nga fshati Perlat i Mirditës, lindën, rritën dhe edukuan mrekullisht shtatë djem, respektivisht, Prenga, Angjelini, Ndoi, Doda, Marini, Maksimi dhe Leoni, të cilët me punën e sjelljen e tyre gëzojnë dashurinë dhe respektin e komunitetit ku banojnë e ku punojnë, duke dhënë kontribute me rëndësi. Gjithashtu, Ndreca iu gëzohet edhe trembëdhjetë nipave dhe mbesave të cilët në veprimtarinë e tyre përpiqen që mësimet e gjyshit të tyre t'i bëjnë realitet.

Ndryshimet politike në vend, pas viteve '90-të të shekullit XX përfshiu edhe veprimtarinë e Ndrecës, për të ndërtuar një demokraci të vërtetë, që e ënderronte prej kohësh. Në vitin 2014, për arsye familjare e shëndetësore, së bashku me bashkeshorten, emigruan në Lion të Francë tek djali i tyre Leoni , ku atje në saj të shërbimit të duhur mjeksor, shëndeti i Ndrecës u përmirësua shumë, duke u kthyer në normalitet. Këtu në emigrim në Francë, Ndreca, duke patur dhe prirje intelektuale në fushën studimore, shkroi dhe një libër me 419 faqe, me shumë vlerë, me titull "Udha e Brezave". Lexuesi nga ky libër gjen histori, kulturë, kronika, fjalë të urta të mençurisë popullore, personazhe politike e shtetërore, aspekte të punës e të jetës ndërtimtare, si dhe shumë evente popullore, që lidhen me traditat e viseve ku ka punuar e jetuar. Edhe kur Ndreca po mbush 86-vjeç, ai ndihet krenar për kontributet që ka dhënë, dhe i gatshëm për të ndërmarrë iniciativa të reja në fushën studimore, shkencore, si dhe vazhdimisht përcjell mesazhe pune dhe edukimi e sjellje qytetare për bashkëkombasit tanë.

Për punën e veprimtarinë për më shumë se katër dekada, por edhe gjatë kohës pas daljes në pension, Shoqata e Bashkimit të Përgjithshëm të Pensionistëve të Shqipërisë, dega Mat, i ka akorduar, Ndrec Mollës, Çertifikatën e Mirënjohjes me motivacionin "Për kontribut të çmuar shumëvjeçar në shërbimin shëndetësor; për figurë të pastër morale, shoqërore dhe për sjellje të dënjë qytetare në krahinën e Matit dhe më gjerë". Të tillë njerëz, për shoqërinë tonë janë dhe mbeten emblem për t'u respektuar e për t'u mbajtur mend, për të mos u harruar përjetësisht.

Ju faleminderit, Ndrec Molla për të gjithë kontributet që ke dhënë gjatë punës e veprimtarisë tuaj në dobi të shoqërisë tonë shqiptare.

SEFER DUKA, RENATO TOTRAKU

Haxhi Mamica, një aset i çmuar për komunitetin

Nga **SEFER DUKA**



Fshati Zall- Prell, pjesë përbërëse e Njësisë Administrative Rukaj, në Bashkinë e Matit, ka një histori të lavdishme e kulturë të gjerë qytetarie, të trashëguar ndër breza. Janë të shumtë bijtë e tij që kanë lënë emër të mirë, që kanë punuar me devocion e kanë dhënë kontribute të rëndësishme e të shumta, ndër të cilët bën pjesë edhe Haxhi Mamica.

Ardhja e tij në jetë më 10 janar të vitit 1942 bëri që në shtëpinë e Rustem Mamicës të shpërthejë gëzimi e hareja, sepse shtimi i familjes me një djalë ishte një ogur i mirë, ishte një shpresë dhe garanci më shumë për një ekonomi më të mirë dhe një siguri më e madhe për mbrojtje. Kur vinte në jetë një djalë, ai konsiderohej shtylla e shtëpisë. Haxhiu, si djali i dytë në radhë i kësaj familjeje, pas Xhelalit, por edhe i dy motrave (Xharija dhe Vazylja), tashmë me statusin e "sugjarit" (i vogli i shtëpisë) iu gëzohej më shumë "privilegjeve" të prindërve, me përkëdheljet e shumta të tyre, por dhe i pjesëtarëve të tjerë të familjes. Babai, Rustemi, por edhe nëna Fatime (e bija e denjë e Shahin Selës nga lagjia Valxhi të fshatit Macukull) për Haxhiun tregonin kujdes të veçantë, si për ushqimin, veshjen, shëndetin dhe interesimin edhe për shkollimin e tij.

Haxhiu, pasi përfundoi shkollën fillore në fshatin e lindjes Prell, atë 7-vjeçare (sot 9-vjeçare) i përfundoi në fshatin Bruç, me rezultate shumë të mira. Kështu iu mundësua vijimi i shkollës së mesme në Politeknikum Mjekësor të Tiranës në specialitetin e stomatologut, mësime që i nisi në vitin 1960 dhe i përfundoi në vitin 1964, gjithashtu po me rezultate shumë të mira, duke marrë dhe titullin e profesionit si Stomatolog. Sapo përfundoi këtë shkollë filloi punë si dentist për disa muaj deri më 04.09.1964, sepse mobilizohet për kryerjen e shërbimit të detyrueshëm ushtarak, për tri vjet, detyrë të cilën e përfundoi në repartin ushtarak në Rinas të Tiranës. Gjatë kësaj kohe në repart kreu detyrën e stomatologut dhe të ndihmës mjekut në shërbim të efektivit të repartit ushtarak, ku bënte pjesë. Fill, pas lirimit nga ushtria, nga viti 1967, përreth 23 vjet deri në vitin 1990 punoi në Qendrën Shëndetësore të ish-kooperativës bujqësore të Bazit në rrethin e Matit. Më pas u transferua po me të njëjtin profesion në qytetin e Burrelit, deri sa doli në pension pleqërie në vitin 2002.

Edhe pas daljes në pension, falë pasionit, por edhe gjendjes së mirë fizike, filloi dhe ende punon si privat, laborant stomatolog duke kryer punë cilësore në shërbim të banorëve të shumtë. Gjatë gjithë kohës në punë, është karakterizuar nga ndërgjegjja e disiplina e lartë nga përkushtimi i plotë për punë cilësore, është njeri i ndershëm e me karakter të fortë, gjithnjë një njeri human që të gjendet pranë në raste gëzimi e hidhërimi, një njeri me kontribute të rëndësishme. Gjatë kësaj kohe për punë të mirë e shembullore është stimuluar më Fletë-Nderi e Fletë-Lavdërimi nga institucionet e tij eprore.

Haxhiu, përveçse një specialist i dalluar, ka qenë dhe një aktivist i mirë shoqëror, ku ka qenë i angazhuar prej rreth 10-vjetësh me Organizatën e Bashkimeve Profesionale. Gjithashtu Haxhiu është dhe një familjar e prind shembullor. Me krijimin e familjes me bashkëshorten e tij, Lavdijen, lindën, rritën dhe edukuan tre fëmijë, respektivisht djemtë Edliri e Genti dhe vajzën Majlinda, të gjithë sot kanë kontribute me vlerë atje ku punojnë e banojnë, duke qenë shembullor.

Koha e gjatë në profesion prej 55 vitesh përbëjnë një kontribut me shumë vlerë në shërbim për komunitarët e tij, ku ka patur figurë të pastër morale dhe ndjenjë të lartë humane, që e bëjnë Haxhi Mamicën të jetë e të gjendet gjithmonë midis të respektuarve dhe të kërkuarve, si model shembullor për të gjithë. Gjithnjë ka qenë i urtë, i sjellshëm dhe shumë komunikues me shokët e kolegët e tij, cilësi këto që tregojnë se të tillë njerëz kërkon sot shoqëria jonë demokratike, madje ato do të shërbejnë dhe si një pikë referimi për të tjerët nga ku prej tij do të merret çdo gjë veç e mirë për të gjithë. Kolegët, mjekët dentist të njohur në Mat, që kanë punuar apo njohur nga afër Haxhi Mamicën e vlerësojnë në mënyrë superlative si njeri, si profesionist dhe si veprimtar shoqëror i dalluar. Edhe sot, kur i ka mbushur të 77 vitet e jetës së tij, Haxhiu punon si një 30-40 vjeçar, duke dëshmuar se edukimi i shëndoshë që ai ka marrë, edhe pasioni për profesionin që e karakterizon, dashuria e respekti që ka për njerëzit në përgjithësi e ato në nevojë në veçanti, e bëjnë këtë personazh të respektueshëm jo vetëm për ato që e kanë njohur nga afër në punë e në jetë, por dhe nga ato që kanë dëgjuar apo lexuar për të dhe do ta mbajnë në kujtesë si modelin e duhur të shoqërisë tonë.

Dëshironi të **BOTONI PAK KOPJE**

LIBRI, por nuk mundeni sepse shtypshkronjat ju kërkojnë të paguani për një tirazh të madh...
Tani nuk është nevoja të prisni...

JU OFROJMË BOTIME NGA
1 KOPJE E VETME!

Njëlloj si në shtypshkronjë... Çmime të favorshme dhe shpejtësi!
Telefono: **068 65 08 441** ose shkruaj email: **mbbotime@gmail.com**

homazh

Lamtumirë doktoreshë Sheza!

Para pak ditësh, më 19 qershor, u nda nga jeta Sheza Balliu (Alushani), një grua fisnike, qytetare e denjë, nënë krenare, një mjeke humane, veprimtare e shquar për emancipimin e gruas shqiptare.

Lindi më 1 nëntor të vitit 1944 në fshatin Gjerbës të Skraparit, në një familje patriote të Alushanëve, të njohur në luftën për liri e pavarësi brez pas brezi në Malësinë e Skraparit.

Babai i saj Ismaili luftoi dhe mori pjesë aktive në luftën antifashiste nacionalçlirimtare. Pas çlirimit të vendit, si pjesëtar i forcave ushtarake të ndjekjes në vitin 1947, u vra duke dhënë jetën në mbrojtje të fitoreve të lirisë dhe pavarësisë, shpallur "Dëshmor i Atdheut".

Nëna e saj, Rrahime Qazim Fusha, rridhte nga një familje me tradita atdhetare, bujare dhe mikpritëse. Vajzës së vogël jetime i munguan vetëm fizikisht prindërit. Atë e rritën Isufi së bashku me vëllezërit, duke i krijuar atë ngrohtësi e kujdes familjar për t'u admiruar. Sheza pas përfundimit të shkollës fillore e shtatëvjeçare në vitet 1958-1962 vazhdon shkollën e mesme mjekësore në Tiranë, ku u dallua si nxënëse model në sjellje dhe mësime, në marrëdhënie me shokët e shoqet, personelin mësimdhënës, por edhe me qytetarët e Tiranës.

Në vitin 1962 filloi studimet në Universitetin e Tiranës në degën e Mjekësisë së përgjithshme. Gjatë studimeve ajo u njoh dhe u lidh për jetë me studentin dibran Tush Balliu nga Bllaca e Grykës së Vogël, duke krijuar kështu një familje të re.

Kjo lidhje e zgjeroi rrethin miqësor të Dibrës me Skraparin, duke kontribuar në forcimin e lidhjeve shpirtërore e humane midis trevave të Shqipërisë.

Sheza shumë shpejt u ambientua me zakonet e traditat e Dibrës (ato për fat të mirë nuk ndryshojnë me ato të Skraparit), me njerëzit dhe qytetarët, krijoi njohje e miqësi të reja me dibranët në punë si mjeke në qytetin e Peshkopisë. Ajo u bë e afërt jo vetëm me pacientët, por me gjithë kategoritë e moshave që kontaktonte gjatë realizimit të misionit si humaniste në shërbimin ndaj njerëzve.

Peshkopia ishte një strehëz e ngrohtë për njerëzit e mirë e me zemër të madhe siç ishin Tushi me Shezën. Si familje ato me të vërtetë rrezatonin kulturë dhe qytetari.

Komuniteti i mjekëve u besoi detyra të rëndësishme, atë të drejtuesit në institucionet mjekësore. Tushi për shumë vite drejtoi seksionin e shëndetësisë së rrethit, ndërsa Sheza, pasi përfundoi specializimin si neurologe, shërbeu edhe si drejtoreshë e spitalit të Peshkopisë (1983-1990).

Në vitin 1974, vajza e Skraparit, nuse dhe mjeke në Dibër zgjidhet deputete në Kuvendin e Shqipërisë, detyrë me përgjegjësi, që e justifikoi plotësisht besimin e popullit të Dibrës për tre legjislatura (1974-1990).

Fryt i kësaj familje janë dy vajzat, Anila dhe Erisi. Anila mbaroi fakultetin e Gjuhëve të huaja (frëngjisht), ndërsa Erisi Universitetin e Tiranës, Fakultetin juridik. Të dyja vajzat ekselente në studime, modele në punë e familje.

Sheza Balliu ishte një veprimtare e gruas në rrethin e Dibrës, luftoi për më shumë se 40 vjet për emancipimin e saj, kundër konservatorizmit, për ngritjen e kulturës nëpërmjet shkollës, rritjes së kualifikimit, bashkë me pjesëmarrjen e saj në sferën prodhuese e atë shoqërore.

Si përfaqësuese e popullit, ajo njihej nga i madh dhe i vogël në zonën zgjedhore,



gjithmonë pranë problemeve e shqetësimeve të qytetarëve.

E njihnin për principet dhe virtytet, për karakterin e fortë, për korrektësinë, objektivitetin, për humanizmin dhe solidaritetin. E qetë, gjithnjë e qeshur, fitoi besimin dhe respektin e njerëzve, shokëve, miqve, kolegëve të punës, familjes, të afërmve e shumë dashamirësve me të cilët pati marrëdhënie në jetën e përditshme.

Asnjëherë, edhe pse larg, nuk e harroj vendlindjen. Të gjithë e duam vendlindjen e kanë detyrime ndaj saj, por ajo ndiente një nostalgji të veçantë. Këtë e shprehte shpesh herë. Në të vërtetë, ajo kishte një dashuri të pakufishme ndaj xhaxhallarëve. Ishte mirënjohëse për gjithçka kishin bërë për rritjen dhe edukimin e saj. Përpiqej të mbante e forconte gjithnjë lidhjet me ato njerëz të dashur e humanë, që gjithsesi për ditët e sotme do të ishte një model për dashurinë e harmoninë midis qytetarëve në familje e shoqëri.

Ishte kjo arsyeja që me fillimet e viteve të demokracisë, për të qenë më afër me njerëzit e saj të gjakut, erdhi në Tiranë. Punoi si mjeke psikiatre në Poliklinikën nr. 3 (Iraniane) në vitet 1990-2000, ndërsa Tushi në Spitalin Ushtarak.

Si gjithnjë, derisa doli në pension, Sheza u shqua për aftësi profesionale në punë si neurologe në shërbim të njerëzve, për edukatë e kulturë në marrëdhënie të mira shoqërore e miqësore me kolegët. Përvojën dhe eksperiencën e saj shumëvjeçare ua dha mjekëve më të rinj , prandaj ishte komode e ndiente kënaqësi të veçantë. Sheza ishte një grua me vullnet të fortë, kishte durim, ishte këmbëngulëse në vendimet që merrte.

Vepra, mundi, fisnikëria, madhështia e saj shpirtërore dhe intelektuale do të mbetet krenari për vajzat, mbesat dhe nipërit e saj. Dashuria dhe kujdesi për gjyshen do të rrezatojnë e do të ndikojnë si një shembull i përkryer në jetën e tyre.

Çdo njeri që lind, një ditë do të vdesë. E rëndësishme është që jetën ta ndërtosh me punë, djersë, dinjitet e t'u lësh një emër të mirë pasardhësve. Këtë detyrë Sheza Balliu (Alushani) e përmbushi me sukses, prandaj kujtimi dhe vepra e saj do të ruhet e kujtohet brez pas brezi në Skrapar, Dibër, Tiranë, në të gjitha vendet ku punoi e jetoi familjarisht.

Lamtumirë doktoreshë Sheza!

U prehsh në paqe!

Nazmi Koçi, Xhelil Gjoni, Rakip Dançe, Nesim Fusha, Dilaver Çorja, Uzire Kalia, Fatbardha Sinani, Idriz Kukeli, Zabit Lleshi, Xhevat Jella.

U nda nga jeta Shemsi Manjani

Komuniteti dibran në Tiranë bashkë me shumë të ardhur nga Homeshi, Dibra e Elbasani më 16 qershor përcollën për në banesën e fundit Shemsi Rakip Manjanin (Hoxha).

Lindi më 1934 në fshatin Homesh të rrethit të Dibrës në një familje me kontribute gjatë luftës nacionalçlirimtare dhe në atë të rindërtimit të vendit, zhvillimit të arsimit e mirëqenies.

Arsimin fillor e mbaroi në fshatin e lindjes. Shtatëvjeçaren në Peshkopi së bashku me shkollën e mesme pedagogjike (1949-1953). Në periudhën 1953-1957 përfundoi studimet në Universitetin Shtetëror të Tiranës, dega Gjuhë ruse, duke u kthyer përsëri në shkollën e mesme pedagogjike Peshkopi si mësues i rusishtes për një periudhë 10 vjeçare.

Në vitet 1963-1965 u emërua drejtor në shkollën pedagogjike, ndërsa në vitet 1965-1967 drejtor në shkollën e mesme të përgjithshme në Peshkopi.

Për një periudhe kohe nëntë vjeçare (1967-1976) Shemsi Manjani drejtoi seksionin e arsimit dhe kulturës të rrethit Dibër.

Me këmbëngulje e vullnet sipas përvojës të kombinuar me pasionin në fushën e mësuesisë i dhanë një hov të ri zhvillimit sasior e cilësor të arsimit parauniversitar në rrethin e Dibrës. U zgjerua arsimi 8 vjeçar, ai i mesëm i përgjithshëm dhe profesional. U rrit ndjeshëm numri i shkollave, nxënësve dhe mësuesve, bashkë me kualifikimin e tyre. Shkolla dhe kultura njohën zhvillime të reja duke e radhitur Dibrën ndër rrethet e dalluara në shkallë Republike.

Sporti u shtri shumë edhe në fshat, suksese të rëndësishme u shënuan me ekipet cilësore të rëndësishme si alpinizmi, qitja, radioamatorizmi, volejbolli (vajza), shahu etj. Si anëtar i Komitetit Ekzekutiv i zgjedhur nga populli ndihmoi në forcimin e këshillave, pushtetit lokal, për të qenë sa më afër halleve dhe problemeve të njerëzve në fshat e qytet.

Në vitin 1976 filloi punë si mësues në shkollën e Muhurrit, për të ardhur në vitin 1980 përsëri në Peshkopi, por tani si kryeredaktor i gazetës lokale "Ushtima e Maleve".

Në gazetë solli vrullin dhe frymën e kolektivitetit, duke i ndihmuar dhe zgjeruar rrethin e bashkëpunëtorëve dhe korrespondentëve vullnetarë në skajet më të largëta të rrethit.

Përvoja e mirë e shumë brigadave, kolektivave, në krom, bujqësi, ndërmarrjet ekonomike, pasqyruar në shtyp e rritën nivelin e gazetës, duke e bërë atë më të dashur e mjaft të kërkuar prej një mase të madhe nga punonjësit e intelektualët e Dibrës. Vetë Shemsiu ishte aktiv në përgatitjen e reportazheve, artikujve problemorë dhe me karakter edukativ, një shembull i mirë për gazetarët e "Ushtimës".

Ka pasqyruar gjithnjë në faqet e shtypit të shkruar dhe në media, zakonet, traditat, historinë resurset ekonomike e turistike të Dibrës e sidomos të vendlindjes së tij, Homeshit e Grykës së Vogël. Ka qenë gjithmonë i angazhuar në veprimtari lokale, sesione shkencore për arsimin, kulturën e sportin, në mënyrë të veçantë për shkollën pedagogjike ku kaloi dhe vitet më të bukura të jetës së tij si nxënës, por edhe si drejtues.

Në 1985-1987 erdhi si mësues në Tomin, ndërsa 1987-1989 e mbylli karrierën e tij të mësuesisë në shkollën e mesme bujqësore.

Shemsi Manjani u martua me Nevrez Shëngjergjin nga Elbasani, diplomuar për Histori-gjeografi. Punoi në arsim në Dibër



Shemsi Manjani ka pasqyruar gjithnjë në faqet e shtypit të shkruar dhe në media, zakonet, traditat, historinë resurset ekonomike e turistike të Dibrës e sidomos të vendlindjes së tij, Homeshit e Grykës së Vogël. Ka qenë gjithmonë i angazhuar në veprimtari lokale, sesione shkencore për arsimin, kulturën e sportin, në mënyrë të veçantë për shkollën pedagogjike ku kaloi dhe vitet më të bukura të jetës së tij si nxënës, por edhe si drejtues.

rreth 30 vjet, ndër mësueset më të dalluara, dekoruar me Urdhërin "Naim Frashëri", Klasi i I. "Qytetare Nderi" e Peshkopisë. Djali, Sokoli mbaroi Universitetin e Tiranës, dega Stomatologji, ndërsa vajza, Teuta, Kimi industriale.

Brezi i ri i viteve '50 të shekullit të kaluar do ta kujtojnë Shemsi Manjanin si futbollist të "Korabit", ndër lojtarët më të mirë të ekipit. Atëherë ekipi i "Korabit" në sajë të futbollistëve të talentuar si: Lutfi, Riza e Shemsi Manjani qëndroi në kategorinë e parë. Ishin vitet më të suksesshme në futboll të klubit "Korabi", një shembull i mirë për brezat e rinj të sportit në rrethin e Dibrës.

Familja e tij i ka dhënë shumë sportit në rrethin e Dibrës. Teuta ushtroi sportin e shahut dhe për dy vjet u shpall kampione kombëtare për femra. Bajrami, vëllai i tij punoi në shkollën e Shupenzës me ekipet sportive të fëmijëve për një kohë të gjatë. Shemsiu, edhe pas daljes në pension, përfaqësoi "Korabin" në ndeshje ndërkombëtare ping pongu në Maqedoni, Bullgari, Kosovë etj.


Gjithnjë aktiv, punëtor dhe i palodhur si veprimtar në Shoqatën e Intelektualëve Dibranë dhe bashkëpunëtor i gazetës "Rruga e Arbërit".

Pas viteve 1995 erdhi familjarisht në Tiranë. Shemsi Manjani ishte dhe mbeti një ndër kuadrot me autoritet dhe integritet për rrethin e Dibrës. I tillë do të mbetet gjithnjë për miqtë, shokët, të afërmit, mësuesit, për të gjithë ata që e njohën në Dibër, Tiranë, Elbasan etj.

I përjetshëm qoftë kujtimi i tij!

Osman Turja, Jovan Bardhi, Elmas Lala, Ramiz Lela, Beqir Shehu, Xhevahir Hoxha, Bashkim Lleshi, Reme Daci, Menduh Dema, Shehat Cami.





Super oferta nga 26 qershor - 30 korrik

DONNA CHIARA
MAKARONA
500 GR



BIG OFERTA 55 LEKË

SANIA
PASAM KOSHERE
200 ML



BIG OFERTA 55 LEKË

BIG MARKET
SHEQER
1KG



BIG OFERTA 59 LEKË

3+1 FALAS!

FLORIOL
3 VAJ 1L + CANTE FALAS



BIG OFERTA 389 LEKË

1+1 FALAS!

ACID *MURIATIK 1L*
+ EPTA *BLUE 1L*



BIG OFERTA 90 LEKË

BINGO
3KG



BIG OFERTA 349 LEKË

KING
ORIZ KOKERRGJATE
1KG



BIG OFERTA 69 LEKË

BEL MARE
SARDELE
125 GR



BIG OFERTA 59 LEKË

JAFFA
LENG FRUTOSH
2L



BIG OFERTA 155 LEKË

PEJA
BIRRE
500 ML



BIG OFERTA 65 LEKË

ALBA
LAVATRICE
4L



BIG OFERTA 339 LEKË

ARIEL
XXL
80 LARJE



BIG OFERTA 1550 LEKË

ATLAS
MIELL
1KG



BIG OFERTA 45 LEKË

1+1 FALAS!

ALOR
VAJ 1L
+ VAJ 500 ML



BIG OFERTA 299 LEKË

2+1 FALAS!

KENT
TABLETA 6-SHE
3 PAKO



BIG OFERTA 100 LEKË

1+1 FALAS!

TABAKA E VOGEL
+ TAS SALLATE



BIG OFERTA 175 LEKË

1+1 FALAS!

HEAD & SHOULDERS *SHAMPO*
+ OLD SPICE *SHAMPO*



BIG OFERTA 349 LEKË

MEGLIO
SGRASSATORE



BIG OFERTA 249 LEKË

2+1 FALAS!

KOVE
+ SHTUPE
+ LECKE



BIG OFERTA 299 LEKË

BORA
LETER NGJYRUE



BIG OFERTA 149 LEKË

MOLFIX
PELENA



BIG OFERTA 970 LEKË

STRABILIA
500 ML



BIG OFERTA 129 LEKË

1+1 FALAS!

BIOAKTIV
+ LIKVI *500 ML*



BIG OFERTA 349 LEKË

1+1 FALAS!

DIP *33 LARJE*
+ ACE *1 LIT*



BIG OFERTA 429 LEKË

cyan magenta yelloë black